



---

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**INSTITUCIONI I PREFEKTIT TE QARKUT SHKODER**



**RAPORT**

**PËR VEPRIMTARINË E KRYER NGA INSTITUCIONI GJATË VITIT 2021**

## RAPORT

### **Për veprimtarinë e kryer nga Insitucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2021**

Qellimi i raportit është të ofrojë një përmbledhje të veprimtarisë së kryer për vitin 2020, përgjegjësi e drejtuesve të Institucionit, në përputhje me kerkesat e Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e Qarkut*”


**Hartuar nga:** Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara

**Adresa:** Rruga “28 Nëntori” Shkodër, tel/faks. 00355 2224 2705, e-mail: [prefekti.shkoder@mb.gov.al](mailto:prefekti.shkoder@mb.gov.al)

Shkoder, Janar 2022

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Keshillit të Ministrave (*Arritja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike me rezultate konkrete në punësim dhe në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve; Program që ka në bazë përpjekjet për rritjen e stabilitetit makroekonomik si një parakusht i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike*), në nivel qarku

## QARKU SHKODËR,



- Sipërfaqja territoriale 3,368.83 km<sup>2</sup>; Pyje e kullota 212,019 Ha; Tokë bujqësore 46,115 Ha (Tokë arë 42,522 Ha, Drufrutor 3,593 Ha);
- Përbëhet nga 5 bashki (1. Malësi e Madhe, 2. Shkodër, 3. Vau i Dejës, 4. Pukë dhe 5. Fushë Arrëz), bashki të cilat janë të ndara sipas 33 Nj.A dhe 272 fshatrave, sipas ndarjes administrative
- Popullsia në fillim të vitit 2021 ka qenë 344,059 banorë, me një pakësim nga viti i kaluar prej 196 banor, ose 0.06 %;
- Numri i të punësuarve në sektorin publik e privat në fund të vitit është 31,149 vetë;
- Shërbimi shëndetësor ofrohet nga 36 Qendra Shëndetësore, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore (Në Bashkinë M.Madhe 6, Shkodër 14, Vau i Dejës 5, Pukë 6 dhe Fushë Arrëz 5), si dhe shërbimi spitalor në Spitalin Rajonal Shkodër dhe spitalin M.Madhe e Pukë;
- Në arsimin parauniversitar vazhdojnë mësimin, gjatë këtij viti arsimor, në 204 institucionet arsimore publike e private, 25,530 nxënës, nga të cilët në (Në arsimin 9-vjeçar 18,022 nxënës, nga të cilët në klasën e I-rë 1,945 nxënës dhe në arsimin e mesëm 7,508 nxënës, përfshi arsimin e mesëm profesional në 4 shkolla me 1,572 nxënës), me një diferencë më pak, krahasuar me vitin e kaluar arsimor (2020-2021) për 1,234 nxënës, ose 4.6 %

## Përmbajtja

I.	Hyrje.....	6
II.	Përmbledhje .....	7
III.	Realizimi i detyrave dhe prioriteteve, në lidhje me programin e qeverisë.....	13
III.1.	Programimi dhe realizimi i të ardhurave.....	13
III.2.	Realizimi i Investimeve.....	14
IV.	Marrëdhëniet e Prefektit me Administratën e shtetit (Adm. Qendrore, Ministritë, Institucionet qendrore në nivel vendor-Degët Territoriale).....	18
IV.1.	Institucionet në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre.....	19
IV.2.	Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim.....	37
IV.3.	Problemet e konstatuar nga analizat mujore të punës së institucioneve qendrore në nivel vendor.....	40
IV.4.	Grupet e punës ndërinstucionale (task-forcat).....	40
IV.4.1.	Task Forca Vendore antikanabis.....	41
IV.4.2.	Zbati i i masave,lidhur me çeshtjet e luftës kundër trafikimit të personave.....	44
IV.4.3.	Zbatimi i Protokollit të masave antocovid .....	46
IV.5.	Masat e marra për përbalimin e situatave nga emergjencat.....	46
V.	Marrëdhëniet e Prefektit me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë).....	51
V.1.	Kryerja e funksioneve të transferuara njësite të vetëqeverisjes vendore.....	51
V.2.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistenca juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.....	56
V.3.	Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor.....	58
VI.	Funksionet e deleguara, kryerja e veprimtarisë nga institucionet të cilave u janë deleguar funksionet nga institucionet qendrore.....	58
VI.1.	Shërbimet sociale .....	58
VI.2.	Zhvillimi i territorit.....	60
VI.3.	Zhvillimi i turizmit.....	60
VI.4.	Shërbimi i Gjëndjes Civile.....	65
VII.	Organizimi dhe veprimtaria e administratës së Prefektit.....	66
VII.1.	Organizimi.....	66
VII.2.	Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre.....	68
VII.3.	Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë.....	68
VII.4.	Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve.....	70
VII.5.	Veprimtaria e N/Prefektit.....	71
VIII.	Veprimtari të tjera të Prefektit.....	71
IX.	Objektivat për vitin 2022.....	72

## RAPORT

### Për veprimtarinë e kryer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2021

#### I. HYRJE

Raporti, i cili paraqet veprimtarinë dhe performancën e Institucionit është në pajtueshmëri me kërkesën për rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administratës publike

Raporti pasqyron realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin qeverisës. Në raportin pasqyrohet programimi dhe realizimi i të ardhurave dhe investimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut dhe Bashkitë, brenda territorit të qarkut), si dhe nga institucionet qendrore në nivel vendor; Treguesit e punës; marrëdhëniet e Prefektit me administratën qendrore dhe rajonale, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë); Bashkëpunimi dhe koordinimi punës për realizimin e detyrave të ngarkuara; Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të nxjerra nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore; Problemet e rendit e sigurisë publike; Veprimtaria e kryer në parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Veprimtaria në çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, si dhe rekomandimet për përmirësimin e punës në vazhdim; Kryerja e funksioneve të transferuara nga Institucionet qendrore njësive të vetëqeverisjes vendore (Shërbimi Mbrojtjes nga Zjarri, administrimi i pyjeve, sistemi i ujitjes dhe kullimit, menaxhimi i rrjetit të rrugëve rurale, sistemi i arsimit parashkollor). Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të turizmit; Përballimit të situatave të emergjencave civile dhe mbrojtjes civile, përfshirë zbatimin e masave për përballimin e situatës së pandemisë, shaktuar nga COVID19; Kryerjes së funksioneve të deleguara; Po kështu në raport trajtohen problemet e ndjekjes dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të ndryshme të qytetarëve; Urdhrat e nxjerra nga ana e Prefektit dhe zbatimi i tyre; Problemet e konstatuara gjatë analizave vjetore të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, etj.

Për hartimin e raportit përveç të dhënave të institucionit dhe të dhënave monitoruese, janë përdorur edhe të dhënat e institucioneve vendore, si dhe të dhënat e njësive të vetëqeverisjes vendore

## II. PËRMBLEDHJE

- Viti 2021, ashtu si për të gjithë vendin, ishte një vit ku veprimtaria e institucioneve vendore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore ishte e kushtëzuar nga pandemia e shkaktuar nga Sars Cov2; me ndikim në realizimin e objektivave dhe zhvillimin ekonomik të qarkut. Rimëkëmbja e ekonomisë e cila filloi që në tremujorin e fundit të vitit 2020, u përshpejtue gjatë këtij viti, duke iu rikthyer afërsisht nivelit të vitit 2019, kjo falë masave të marra nga qeveria shqipëtare për zhvillimin e turizmit (sektori i turizmit, ka patur rritje krahasuar me vitin e kaluar, duke iu kthyer trendit rritës të sezoneve para pandemisë, shkaktuar nga covid 19) dhe rritjen e investimeve (të cilat janë mbështetur në një sektor financiar të qendrueshëm dhe me likuiditet), por edhe si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të punës në mes institucioneve vendore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga Prefekti i Qarkut, si dhe rritjes së nivelit të profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administrates publike

- Nga ana e Prefektit ne permbushje te misionit dhe ushtrimit te pergjegjesive është bashkëpunuar dhe koordinuar veprimtaria e institucioneve vendore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e detyrimeve ligjore, sipas kompetencave dhe fushave të përgjegjësisë;

- Janë organizuar takime të vazhdueshme periodike dhe sipas rasteve, për analizimin e veprimtarisë, problemeve të hasura, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e detyrave të ngarkuara, duke përcaktuar dhe marrjen e masave, për zgjidhjen e tyre (Menaxhimin e mbetjeve, Funksionimin e tregjeve; Dëmtimet në pyje, etj)

- Janë organizuar takime, lidhur me analizimin dhe ecurinë e zbatimit të detyrave, siç është rasti i takimeve të vazhdueshme për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në parandalimin dhe eliminimin e kultivimit të bimëve narkotike; Në Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Për çështjet e rendit dhe sigurisë publike; Për mbarëvajtjen e sezonit turistik; Situatën emergjente të krijuar nga reshjet, përmytjet, zjarret, infeksioni COVID 19; Për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në sistemin arsimor parauniversitar, përfshi sigurimin e ngrohjes në shkolla; Për problemet e pronësisë mbi tokën bujqësore; etj.

- Janë organizuar, sipas njësisive të vetëqeverisjes vendore takime me drejtues të ketyre njësisive dhe të institucioneve vendore, për zbatimin e detyrave të përbashkëta

- Janë organizuar takime në institucionet vendore (Degët Territoriale), lidhur veprimtarinë e ushtruar, gjatë periudhave të ndryshme të vitit, duke u përqendruar tek institucionet e ofrimit të shërbimeve dhe inspektoratet shtetërore

- *Të ardhurat e realizuara në nivel qarku*

- Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 6,103,445 mijë lekë, ose 105.5 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 319,445 mijë lekë (tejkalim i cili ka ardhur nga tejkalimi i të ardhurave nga kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore për 261,040 mijë lekë; Tatimi mbi të ardhurat personale për 138,227 mijë lekë). Realizimi i të ardhurave gjatë vitit ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar me 617,905 mijë lekë, por edhe me krahasuar me vitin 2019 me 111,288 mijë lekë. Po kështu janë realizuar të ardhura nga DRSSH, kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore (nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe nga sigurimi vullnetar) me vlerë 198,803 mijë lekë, ose 109.2 % e të të ardhura të programuara

- Janë realizuar të ardhura nga Dogana, me një vlerë prej 3,759 mijë lekë, ose

118.3 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 580,564 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje jo vetëm me vitin e kaluar prej 783,384 mijë lekë, por edhe krahasuar me vitin 2019 (para pandemisë) me 413,681 mijë lekë

- Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë realizuar të ardhura me një vlerë prej 253,459 mijë lekë

- Të ardhurat nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshilli i qarkut dhe bashkitë) janë realizuar me një vlerë prej 941,939 mijë lekë, ose 75.6 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 303,496 mijë lekë, por megjithë mosrealizimin e të ardhurave të programuara, krahasuar jo vetëm me vitin e kaluar por edhe me vitin 2019 (para pandemisë) realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje respektivisht me 71,366 mijë lekë dhe 39,399 mijë lekë

- *Investimet*

Janë kryer shpenzime për investime gjatë vitit 2020 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (me të ardhurat e veta dhe me fondet e buxhetit) me vlerë 1,025,512 mijë lekë (përfshi investimet në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm me vlerë 334,300 mijë lek), në (Këshilli i Qarkut 4,401 mijë lekë, Bashkia Malësi e Madhe 311,307 mijë lekë, Bashkia Shkodër 439,660 mijë lekë, Bashkia Vau i Dejës 80,741 mijë lekë, Bashkia Pukë 174,845 mijë lekë dhe Bashkia Fushë Arrëz 14,558 mijë lekë), ose 83.7 % e shpenzimeve të programuara (nga 1,686 mijë lekë shpenzime për investime të kryera gjatë vitit të kaluar 2020). Në 4 bashkitë e qarkut, janë kryer investime nepermjet FShZh (investime, të filluara gjatë vitit 2019-2021 dhe me afat përfundimi gjatë vitit 2021-2022) në 7 projekte me vlerë totale 867,564 mijë lekë. Në sektorin e energjisë janë kryer investime (me fondet nga të ardhurat e Sh.A KESH dhe OSSH) me vlerë mbi 720,000 mijë lekë, investime të cilat, falë edhe masave të marra dhe bashkëpunimit me institucionet dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me strukturat e policisë vendore, kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve. Janë kryer investime, me fondet e buxhetit, për përmirësimin e sistemit të ujitjes e kullimit dhe mbrojtjen nga gërryerjet e lumenjve me vlerë mbi 86,000 mijë lekë. Po kshtu janë kryer investime në territorin e bashkisë Shkodër, me fondet e buxhetit, nga ARRSH, në objektin “Ndërtim Rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1, Loti 2 dhe shtesë punimesh”, objekt i filluar në vitin 2011 me një vlerë 1,892,721 mijë lekë (progressive deri në fund të vitit 2021)

- Janë në proces realizimi investime në infrastrukturë rrugore dhe në sektorin e ujit të pishëm në bashkitë Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz, me vlerë mbi 310,000 mijë lekë; Në njësitë e vetëqeverisjes vendore investime nepermjet FShZh (me afat zbatimi 2021-2025) 1,658,446 mijë lekë, në 5 projekte në të cilat janë kryer procedurat e prokurimit dhe lidhja e kontratave

- Janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor (Janë kryer punime rikonstruksioni, ndërtim i ambienteve të reja sportive; Punime mirëmbajtje, bojatisje të ambienteve të brendshme e të jashtme; përfshi edhe masat anticovid 19; Nuk ka nxënës të cilët kanë braktisë shkollën, për shkak të gjakmarrjes);

- Numri i të punësuarve (numri i personave, për të cilët është llogaritur dhe derdhur kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore) gjatë vitit ka qenë 31,149 vetë, me një diferencë, më tepër nga viti i kaluar prej 756 persona (gjatë vitit të kaluar numri i të punësuarve ka qenë 30,693 vetë). Është pakësuar numri i punëkërkuarve të papunë të regjistruar, krahasuar me vitin e kaluar me 261 persona, ose 7.1 % (Në fund të vitit janë të regjistruar 3,397 persona



nga 3,658 persona, që ishte në fund të vitit të kaluar)

- Me fondet e buxhetit janë trajtuar me ndihmë ekonomike gjatë vitit 55,138 familje (mesatarisht 4,595 familje/muaj), me një rritje nga viti i kaluar prej 932 familje (mesatarisht 78 familje/muaj). Janë trajtuar nga skema e ndihmës me fondet e kushtëzuara të buxhetit për bashkitë (deri 6 %) 461 familje/muaj, me një rënie prej 18 familje, krahasuar me vitin e kaluar. Me qëllim zbutjeje e efekteve të shkaktuar nga COVID 19 është dyfishuar masa e ndihmës ekonomike për 4,734 familje. Me fondet e buxhetit për pagesë paaftësie janë trajtuar 11,200 persona (Persona me aftësi të kufizuar dhe kujdestar të tyre 6,672 dhe 4,528 invalidë të punës), ose 410 persona më pak krahasuar me vitin e kaluar

Si rezultat i masave të marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, nepermjet inspektimeve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe verifikimeve në familje, për numrin e rasteve të trajtuara në shkelje të ligjit, ka një administrim dhe mirë menaxhim të fondeve të buxhetit për shtresat në nevojë.

- Situatat e emergjencave të krijuara gjatë gjithë vitit në territorin e qarkut (përfshi përmytjet në zonën e Nën Shkodrës gjatë periudhës Dhjetor 2020-Mars 2021, shfaqjen dhe përhapjen e vatrave të zjarrit gjatë stinës verore, pandeminë e shkaktuar nga Covid 19, etj.) , si rezultat i mbështetje së qeverisë shqiptare, si dhe ndërtimit të një sistemi bashkëpunimi shume efikas me të gjithë institucionet në nivel qendror dhe lokal, te mirorganizuar te informimit me sektoret e emergjencave civile ne të gjitha bashkitë, komunikimi e raportimi periodikisht, në menyrë të vazhdueshme, janë përballuar me sukses (Nga përmytjet në zonën e nënshkodrës është përmytur një sip. toke prej 8,870 Ha, janë përmytur dhe me prezencë uji rreth 920 shtëpi, me rreth 5 mijë banorë, të cilët janë mbështetur me 1,062 pako ushqimore, mbi 12 mijë lit. Ujë të pijshëm dhe për blegëtorinë mbi 400 ton bazë ushqimore. Gjatë vitit janë shfaqur zjarre në 727 raste dhe vatra, nga 969 vatra të shfaqura gjatë vitit të kaluar, duke përshkuar një sip. totale 2,517 Ha dhe djegur 175 Ha))

- Kriminaliteti gjatë vitit 2017-2020 ka pësuar ulje, ndërsa viti 2021 krahasuar me vitin 2020 ka pësuar rritje me 245 vepra penale (Nga 1,754 vepra penale të evidentuara gjatë vitit 2020 në 1,999 këtë vit). Ndërsa shkalla e zbulueshmërisë është ulur 5 % krahasuar me vitin e kaluar (nga 93 % në 88 %)

- Në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2021, nga ana e Task Forcës Vendore Antikanabis është bashkëpunuar dhe koordinuar veprimtaria e institucioneve vendore, njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe strukturave të tjera pjesë përbërëse e Task Forcës, në mënyrë të veçantë e strukturave të policisë së shtetit, për parandalimin e kultivimit dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale

- Për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave është rritur niveli i bashkëpunimit te Komitetit Rajonal Antitrafik, strukturave të policisë së shtetit, njësitë të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit, në menyrë të veçantë sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, ku vetëm gjatë muajit Tetor janë zhvilluar mbi 80 aktivitete, me qëllim parandalimin e kësaj veprimtarie kriminale,

- Nga ana e Prefektit ne permbushje te misionit, ushtrimit te pergjegjesive dhe veprimtarise jane nxjerre 68 Urdhra; Jane zhvilluar mbi 60 takime si me grupin keshillues pranë

Prefektit, ashtu edhe me drejtues të institucioneve qendrore në nivel vendor, të njësive të vetëqeverisjes vendore, etj., për zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në planin e veprimit antikanabis, për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, problemet e emergjencave civile, menaxhimin e mbetjeve, mbarevajtjen e sezonit turistik, titujt e pronësive mbi token bujqesore, ligjshmerine e akteve të nxjerra nga njesite e vetëqeverisjes vendore, etj.; Jane shqyrtuar dhe vlerësuar, duke u kthyer përgjigje, 62 kërkesa dhe ankesa të ndryshme të qytetarve, subjekteve publike e private. Është vlerësuar, inventarizuar, fotokopjuar dokumentacioni, duke dorëzuar pranë Drejtorinë Vendore të AKSH, 450 dosje të ish KVTP

- Institucioni i Prefektit gjatë vitit ka qenë pjesë përbërse e grupit ndërinstitucional (Task Forcës), të ngritur, lidhur me: Kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2021”; Menaxhimin e mbetjeve dhe krijimin e një mjedisi të pastër; Menaxhimin e situatës së emergjencave të shkaktuar nga reshjet, përmytjet, zjarret, etj, përfshi menaxhimin e situatës së pandemisë të shkaktuar nga infeksioni SARS COV 2; Marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje

- Nga 269 akte të depozituara, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në Institucionin e Prefektit, për verifikim ligjshmërie, Prefekti ka vlerësuar se janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore 234 akte; Është shprehur negativisht, për shkak se kanë qenë jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, për 35 akte, nga të cilat janë rishqyrtuar 7 prej tyre dhe për rastet e tjera nuk është lejuar procedimi i mëtejshëm. Gjatë vitit është kryer procesi i verifikimit në vend i akteve normative në të gjitha NJQV, sipas Urdhërit të Prefektit, nga ku është konstatuar se është përmirësuar puna krahasuar me vitet e kaluara

### **Probleme të hasura, të cilat kanë ndikuar në ushtrimin e veprimtarisë dhe zbatimin e detyrimeve**

- Mungesa e akteve nënligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore
  - Përcaktimi i numrit të Nj.A mbi bazën e numrit të popullsisë
  - Përcaktimin e strukturës dhe numrit të punonjësve të administratës (përfshi edhe funksionet drejtuese), sipas kategorisë së bashkisë, mbi bazën e numrit të popullsisë
- Menaxhimi i mbetjeve mbetet akoma problem dhe një sfidë, veçanarisht për zonat periferike të qytetit Shkodër, përfshi edhe mosmiratimin e venddepozitimit të mbetjeve inerte (kjo për të gjitha bashkitë)
  - Ushtrimi i veprimtarisë së paligjshme të gjuetisë dhe peshkimit
  - Probleme në zhvillimin e turizmit
    - Masat kufizuese, shkaktuar nga pandemia Sars Cov 2
    - Menaxhimi i mbetjeve, ku më problematike është ndotja e liqenit të HEC Koman, e cila krijohet nga grumbullimi i mbetjeve të lumenjve dhe nga mjetet e transportit ujor, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e transportit në këtë liqen
    - Gjendja e infrastrukturës rrugore drejt destinacioneve turistike, përfshirë

segmentin Qafë Thore-Theth, i cili gjatë sezonit ka qenë në proces rikonstruksioni të plotë, çka ka krijuar probleme dhe vonesa dhe trafik në lëvizjen e turistëve drejt pikës turistike Theth, aq tërheqëse për turistët e huaj

- Administrimi dhe menaxhimi i territorit dhe hapësirave publike (zënia forcërisht dhe përdorimi në mënyrë të paligjshme i hapësirave publike, sipërfaqe të territorit të plazhit, nga subjekte dhe individë për qëllime biznesi dhe ndërhyrjet nga institucionet ligjzbatuese, gjatë sezonit, për kthimin e ligjshmërisë)

- Mos zbatimi i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren “*Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit plazhit*” (miratuar në VKM 171, datë 27.03.2019, me ndryshime), në stacionet e plazhit

i. Lidhja me vonesë e kontratave për përdorimin e hapësirës publike nga ana e njësisve vendore me subjektet që do të ushtrorjnë veprimtarinë e stacionit të plazhit. Nga të dhënat monitoruese ka rezultuar se gjatë sezonit, janë lidhur 63 kontrata me 57 subjektet private, për dhënien me qira të hapësirave publike (88 parcela me një sip. prej 73,647 m<sup>2</sup>), për ushtrim veprimtarie të stacionit të plazhit,

ii. Mungesa e rojeve bregdetare (vrotuesve të çertifikuar) dhe shërbimit të vrojtimit, kjo edhe si shkak i vonesave në nënshkrimin e marrveshjes së subjekteve të stacionit të plazhit me vrojtuesit, shoqëruar me çertifikatëpërkatësetkualifikimit)

iii. Mospërputhja, mbi vendosja dhe diferenca e sip. të stacionit të plazhit në terren me sip sipas hartave (të propozuara nga bashkia dhe të miratuara nga Komiteti i Menaxhimit të SezonitTuristik), duke sjellë probleme në ndarjen në terren pas nënshkrimit të kontratave,

iv. Ofrimi i standarteve në plazhet publike (sipas të dhënave gjatësezonit ka patur 105 stacione plazhi publik, nga 15 të planifikuara në fillim të sezonit), veçanërisht pjesa e kriterëve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastruktura e plazhit publik (Tabelizimi i të gjitha hapsirave publike, Ngritja e pikave të vrojtimit dhe pajisja e hapsirave publike me vrojtues të certifikuar; Sigurimi i pastrimit të hapsirave publike; Pajisja e hapsiravepublike me shërbime higjienike; Markimi i zonës së notimit)

v. Prezenca e shitësve ambulant në hapësirat në mes vijës ujore e stacioneve të plazhit

- Sigurimi i ngrohjes në disa shkolla, kryesisht në territorin e bashkisë Shkodër, me gaz të lëngshëm (me bombola gazi), ngrohje e cila përbën rrezik për shëndetin dhe jetën e nxënësve

- Mungesa e drejtuesve të disa institucioneve vendore në periudha të ndryshme gjatë vitit, ose zgjatja e periudhës së riorganizimit (në kuadrin e ristrukturimit të këtyre institucioneve)

- Mungesa e zyrave për ushtrimin normal të veprimtarisë së institucionit (Megjithëse aktualisht veprimtaria e Institucionit ushtrohet në ndërtesën që është në pronësi të bashkisë Shkodër, zyrat nuk janë të mjaftueshme)

### **Rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë**

Vetëqeverisja vendore

- Miratimi i akteve nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e njësisve të vetëqeverisjes vendore (përcaktimin e Nj.A dhe strukturës e numrit të punonjësve, përfshi drejtuesit, mbi bazën e numrit të popullsisë)

- Miratimi i akteve nënligjore për mbrojtjen civile
- Përcaktimi dhe miratimi i venddepozitimit të mbetjeve inerte, për të gjitha bashkitë

#### Zhvillimi i turizmit

- Rishikimi i Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” (miratuar me VKM Nr. 171, me ndryshime), me qëllim Eliminimin e mospërputhjeve të të dhënave të sipërfaqes sipas hartës, me ato në terren; Zvarritjeve në dorëzimin e parcela; Përfshirjen në listën e plazheve të miratuara (Shtojca 1 e Rregullores) të plazhit Rrjoll, Nj.A Velipojë, bashkia Shkoder; Garantimin e sigurisë së pushuesve në stacionet e plazhit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratave, duke i ngarkuar kontraktimin e shërbimit e vrojtimit për të gjithë territorin e plazhit, autoritetit shtetëror (Institucioniqendror/njësisë së vetëqeverisjes vendore) kundrejt një tarife, të qiramarrësit të hapësirës publike për ushtrimin e aktivitetit të stacionit të plazhit

- Monitorimi dhe ndërhyrjet, për paligjshmërinë e veprimeve të kryera nga persona/subjekte, në zonën bregdetare, të përfundojnë përpara fillimit të sezonit turistik veror 2022, kjo për të shmangur ndërhyrjet gjatë sezonit me ndikim negativ në zhvillimin e turizmit

- Procedura e aplikimit online, për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit për sezonin turistik veror 2022, të përfundojë brenda muajit Shkurt, duke eliminuar vonesat në lidhjen e kontratave-përfundimin e procedurës së lidhjes kontratave brenda muajit Mars (në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 4/4 të Rregullores)

#### Rendi dhe siguria publike

- Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit të veprimeve mes të gjithë aktorëve, marrëdhëniet direkte me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor (Degët Territoriale), duke krijuar struktura (grupe ndërinstitutionale) të veçanta bashkëpunimi, për shërbimet e ndërsjella të policisë vendore, policisë bashkiake dhe institucioneve qendrore në nivel vendor (duke analizuar periodikisht nivelin e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura) për kontrollin efektiv të territorit, me qëllim parandalimin e ndërtimeve pa leje; Krimeve mjedisore (ndotja e mjedisit nga mbetjet, prerja e paligjëshme dhe dëmtimi i pyjeve, etj); Kultivimit të bimëve narkotike e përdorimit të lëndëve narkotike jo vetëm në ambientet e shkollave dhe universitetit, por edhe jashtë këtyre ambienteve nga nxënësit dhe studentët, si kontingjenti më i rrisuar; Ndotjes akustike, me vemendje të shtuar ndotjen nga zhurma e automjeteve (ndërhyrjet dhe modifikimi i mjeteve, përfshi edhe motorët, të cilët gjenerojnë zhurma tej normave të lejuara dhe të bezdisshme për qytetarët); Aksidenteve rrugore e disiplinimin e trafikut rrugor, nëpërmjet shërbimeve të përbashkëta të struktura të policisë me ato të institucioneve përgjegjëse e të njësisive të vetëqeverisjes vendore (vendosjen e sinjalistikës rrugore dhe përcaktimin e vendqendrimeve të mjeteve të transportit të udhëtarëve)

### III. REALIZIMI I DETYRAVE DHE PRIORITETEVE, NË LIDHJE ME PROGRAMIN E QEVERISË

#### III.1. Programimi dhe realizimi i të ardhurave

##### III.1.a. Njësiti e vetëqeverisjes vendore

Janë realizuar të ardhura nga njësiti e vetëqeverisjes vendore me një vlerë prej 941,939 mijë lekë ( nga 870,573 mijë lekë të realizuara gjatë vitit të kaluar 2020) ose 75.6 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 303,496 mijë lekë, ku 81 % e mosrealizimit i përket bashkisë Shkodër e Vau i Dejës (Bashkia Shkodër me një mosrealizim 143,901 mijë leke, ose 47.4 % dhe Vau i Dejës me një mosrealizim prej 102,323 mijë lekë, ose 33.7 %).

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për vitin 2021 dhe 2020, paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Të ardhurat gjithësej				
		Viti 2021			Viti 2020	
		Program	Fakt	%	Fakt	%
1	Keshilli i Qarkut	3,240	1,232	38	1,049	43
2	Bashkia M. Madhe	104,415	76,430	73.2	75,464	73.7
3	Bashkia Shkoder	877,419	733,518	83.6	659,084	82.7
4	Bashkia Vau i Dejes	186,853	84,530	45.2	78,720	43.7
5	Bashkia Puke	44,081	31,194	70.8	40,787	96.2
6	Bashkia Fushe-Arrez	29,427	15,035	51.1	15,469	54.2
	<b>Totali</b>	<b>1,245,435</b>	<b>941,939</b>	<b>75.6</b>	<b>870,573</b>	<b>75.6</b>

Gjatë vitit megjithë mosrealizimin e të ardhurave të programuara, krahasuar jo vetëm me vitin e kaluar por edhe me vitin 2019 (para pandemisë) realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje respektivish me 71,366 mijë lekë dhe 39,399 mijë lekë (në vitin 2020 janë realizuar të ardhura me vlerë 870,573 mijë lekë dhe në vitin 2019 me vlerë 902,540 mijë lekë)

##### III.1.b. Të ardhura nga tatimet dhe kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore (Drejtoria Rajonale Tatimore)

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 6,103,445 mijë lekë, ose 105.5 % e të ardhurave të programuara, me një tejkallim prej 319,445 mijë lekë (tejkallim i cili ka ardhur nga tejkallimi i të ardhurave nga kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore për 261,040 mijë lekë; Tatimi mbi të ardhurat personale për 138,227 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave gjatë vitit ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar me 617,905 mijë lekë, por edhe me krahasuar me vitin 2019 me 111,288 mijë lekë (gjatë vitit 2019 janë realizur të ardhura me vlerë 5,992,157 mijë lekë)

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas zërave për vitin 2021 dhe 2020 paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2021			2020	
		Plan	Fakt	%	Fakt	%

1	Tatim mbi vlerën e shtuar	709,000	609,508	86	656,000	104
2	Ttim-fitimi	387,001	403,122	104.2	342,020	88
3	T/ardh. Pers.+ dënime admin	733,000	871,227	118.6	711,077	87
4	Taksa nacionale	35,000	38,549	110.1	28,596	95
	<b>Totali Tatime</b>	<b>1,864,001</b>	<b>1,922,406</b>	103.1	<b>1,737,693</b>	93
5	Kontribut sig.shoq. e shënd.	3,919,999	4,181,039	106.7	3,747,847	97
	<b>Gjithsej</b>	<b>5,784,000</b>	<b>6,103,445</b>	105.5	<b>5,485,540</b>	96

Janë arkëtuar të ardhura, kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe sigurim vullnetar me vlerë 198,803 mijë lekë (nga të vetëpunësuarit në bujqësi 179,464 mijë lekë dhe sig. vullnetar 19,339 mijë lekë) nga 182,000 mijë lekë të programuara, ose 109.2 %. Pra gjatë vitit, janë realizuar të ardhura, kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore gjithsej (nga DRT dhe DRSSh) me vlerë 4,379,842 mijë lekë, nga 4,101,999 mijë lekë të programuara, ose 106.8 %

### III.1.c. Të ardhura Doganore

Janë realizuar të ardhura nga Dogana, me një vlerë prej 3,759 mijë lekë, ose 118.3 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 580,564 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje jo vetëm me vitin e kaluar prej 783,384 mijë lekë, por edhe krahasuar me vitin 2019 (para pandemisë) me 413,681 mijë lekë (gjatë vitit 2019 janë realizuar të ardhura me vlerë 3,345,329 mijë lekë)

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2021 dhe 2020 paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr	Emertimi	Viti 2021			2020	
		Plan	Fakt	%	Fakt	%
1	Të ardhura	3,178,446	3,759,010	118.3	2,972,626	99

Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë realizuar të ardhura me një vlerë prej 253,459 mijë lekë

### III.2. Realizimi i Investimeve

#### III.2.a. Investimet, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Janë kryer shpenzime për investime gjatë vitit 2021 nga njësitet e vetëqeverisjes vendore (me të ardhurat e veta dhe me fondet e buxhetit) me vlerë 1,025,512 mijë lekë, nga 1,225,940 mijë lekë të programuara, ose 83.7 % e shpenzimeve të programuara (janë kryer shpenzime për investime për vitin 2020 me vlerë nga 1,148,760 mijë lekë dhe për vitin 2019 me vlerë 1,686,398), sipas njësive

*Në mijë lekë*

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Plan	Fakt
1	Këshilli i Qarkut	62,211	4,401
2	Bashkia Shkodër	548,895	439,660

3	Bashkia Malësi e Madhe	337,092	311,307
4	Bashkia Vau i Dejës	85,066	80,741
5	Bashkia Pukë	175,732	174,845
6	Bashkia Fushë Arëz	17,004	14,558
	<b>Shuma</b>	<b>1,225,940</b>	<b>1,025,512</b>

### III.2.b. Investime me fondet e qeverisë nga FShZh

Në 4 bashkitë e qarkut, janë kryer investime nepermjet FShZh (investime, të filluara gjatë vitit 2019 dhe me afat përfundimi gjatë vitit 2021-2022) në 6 projekte me vlerë totale 867,564 mijë lekë, nga 1,186,079 mijë lekë sipas vlerës së kontraktuar, sipas bashkive dhe projekteve:

Nr.	Bashkia	Objekti	Burimi i Financimit	Kontrata e sipërmarrjes			Statusi
				Vlera (në 000/lekë)	Afati i zbatimit		
					Fillimi	Përfundimi	
1	Shkoder	Rikonstruksion i rrugës Qafe Thore-Theth, Shkodër	Banka Boterore	699,684	03.09.2019	15.10.2021	Përfunduar
2	Shkoder	Permiresimi i shtresave rrugore ne aksin "Rruga e Kucit-Esat Myftiu-Ajasem" dhe "Rruga e Terzive-9 Nusët "	Qeveria Shqiptare	27,247	07.12.2021	07.03.2022	Përfunduar
3	Shkoder; M. Madhe	Ndërhyrje e integruar në përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe atr. turistik në zonën e Alpeve Shqiptare, Bashkia Shkodër(Theth, Theth Nderlysaj, Boge)	Qeveria Shqiptare	20,000	18.11.2021	18.11.2022	Në proces
4	V. Dejes; M. Madhe; Shkoder	Marrëveshje kuadër me objekt: "Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët	Qeveria Shqiptare	93,369			Përfunduar
5	Vau i Dejes	Permiresimi i shtresave rrugore Rruga nacionale Velipoje-Fshati Bend	Qeveria Shqiptare	14,584	13.10.2021	13.01.2022	Përfunduar

6	Malesia e Madhe	Permiresimi shtresave rrugore ne aksin "Omaraj-Gril"	Qeveria Shqiptare	12,620	22.09.2021	21.11.2021	Përfunduar
---	-----------------	--	-------------------	--------	------------	------------	------------

### III.2.c. Investime nga ARSH

Nga ana e ARRSH. Me fondet e buxhetit janë kryer shpenzime për ndërtimin e By Pass Perëndimor të qytetit Shkodër (Objekt në të cilin punimet kanë filluar në vitin 2011 dhe afat përfundimi në vitin 2022) me vlerë 1,892,721 mijë lekë

Nr.	Bashkia	Objekti	Burimi i Financimit	Kontrata e sipërmarrjes			Statusi
				Vlera (në 000/lekë)	Afati i zbatimit		
					Fillimi	Përfundimi	
1		By Pass Perëndimor (Loti 1)	Buxheti	1,447,446	2011	2022	Përfunduar 95.9 % e punimeve
2	Shkodër	By Pass Perëndimor (Loti 1)- shtesë punim.	Buxheti	281,743	2018	2022	Përfunduar 95 % e punimeve
3		By Pass Perëndimor (Loti 2)	Buxheti	430,566	2011	2021	Përfunduar 55 % e punimeve

### III.2.d. Investime në sektorin e ujit të pijshëm

Për përmirësimin e nivelit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga bashkitë me fondet e buxhetit janë kryer investime me vlerë 334,300 mijë lekë, nga të cilat në bashkinë Malësi e Madhe me vlerë 189,035 mijë lekë ("Furnizim me ujë i fshtrave Gradec e Pjetroschan 27,599 mijë lekë; Ndërtim ujësjellësi Bajzë 20,000 mijë lekë dhe Furnizim me ujë i zonës Koplik dhe koplik i Sipërm 140,200 mijë lekë, Ujësjellësi "Balshaj" 1,236 mijë lekë) dhe në bashkinë Vau i Dejës me vlerë 20,000 mijë lekë (Ndërtim ujësjellësi Vai i Dejës) dhe në bashkinë Pukë 125,265 mijë lekë (Ujësjellësi Luf 70,279 mijë lekë dhe Ujësjellësi Gjegjan 54,986 mijë lekë)

### III.2.e. Investime për zhvillimin bujqësor (sistemi i ujitjes dhe kullimit) dhe mbrojtje nga përmbytjet (argjinatura)

Janë kryer shpenzime për investime, rehabilitim e punime të domosdoshme, me fondet e buxhetit, për përmirësimin e sistemit të ujitjes e kullimit dhe mbrojtjen nga gërryerjet e lumenjve me vlerë 86,075 mijë lekë (Investime, për mbrojtjen nga lumi "Drin" perballe harkut te Berdices, Nj.A Berdicë e bashkisë Shkodër me vlerë 62,527 mijë lekë; Shpenzime për punime të domosdoshme në 5 vepra kullimi 894 mijë lekë dhe 2 vepra ujitjeje 754 mijë lekë; Shpenzime për punime reahabilituese e mirëmbajtje në veprat e ujitjes, kullimit dhe argjinatura 21,900 mijë lekë)

### III.2.f. Investime në sektorin e energjisë elektrike

Janë kryer investime në sektorin e energjisë elektrike me vlerë mbi 720,000 mijë lekë OSHEE Sh.A, me fondet nga të ardhurat e veta, në 17 projekte me vlerë mbi 550,000 mijë lekë ("Ndërtim kabinë shtyllore dhe rrjeti TM/TU në fiderin Vukpalaj, kabina Grabom N/St



Vukpalaj 35/6 KV”; “Rikonstruksion i kabinës murore Lëpushë, kabinës shtyllore Q.Brodoleco dhe rrjeti TM/TU, fshati Kelmënd, N/St. Vukpalaj”; “Rikonstruksion i kabinës murore dhe rrjetit TU Kalldrun 1, fshati Buzë Uji, N/St. Koplík”; “Rikonstruksion I rrjetit TU dhe Kab. Vrrithë 1 e 2, fshati Zagorë, N/St. Koplík”, “Rikonstruksion linje kabllore në fdrin 17 nga kabina V.Kadia 1 deri tek kab. Kullota me kabëll Al 3x1x185 mm<sup>2</sup>, N/St. Shkodra; “Rikonstruksion i rrjetit TU dhe kabinave murore qendër Drisht dhe shtyllore e re Kalaja e Drishtit, F-15 N/St. 110/35/20/6 KV Shkodra 1”; “Zhvillim i rrjetit TM/TU, Postribë, F-24, N/St. 110/20/6 KV Shkodra 1”; “Rikonstruksion i rrjetit TU dhe kabinës Qendër Shtoj F-1 Dobraq”; Rikonstruksion i rrjetit TM/TU Nënshatë 11 dhe ndërtim i kabinës shtyllore N[ënshatë 13, F—Hajmel, Vau i Dejës”; “Zhvillim i rrjetit TM 6 KV, kabina shtyllore Dheu i Lehtë 5, Fideri i lavatriç N/St. V.Dejës”; “Zhvillim i rrjetit TM 6 KV, kabinë shtyllore Ashtë 6, fideri F1, N/St 110/6 KV Bushat”; “Rikonstruksion i rrejtit TM/TU dhe kabinës shtyllore O.Meracaku, fideri 8 Velipojë”; “Zhvillim i rrjetit TU me kabëll ABC, i kabës shtyllore e re Velipojë 16, F-6, N/St Plazh Velipojë”; “Rikonstruksion nga ana ndërtimore e disa kabinave Tip BOX dhe Murature të fidrave 20 KV Shkodër”; “Rikonstruksion i kabinave rrjeti TU me ABC, në fidrin 1 Trush, N/St 35/6 KV Trush”; “Linjë TM/TU me kabëll XLPE, kabinë BOX Gjuraj 1 dhe kalim në 20 KV kab. Kopli i Sipërm 1”; “Kalimi në 20 KV i rrjetit TM/TU dhe rrjetit TU me ABC linja në zonën e Berdicës”; etj.) dhe KESH Sh.A, me fondet nga të ardhurat e veta, me vlerë mbi 170,000 mijë lekë (“rehabilitim i ndërtesës centralit në HEC Koman 46,274 mijë lekë; “Mbrojtje e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbijve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjeve e koluvioneve mbi rugën e digës HEC Koman” 86,992 mijë lekë “Blerje pjesë elektrike dhe elektronike, pjesë mekanike dhe matëse kontrolluese për njësinë e prodhimit HEC Koman” 30,025 mijë lekë, Rehabilitim i dëmtimeve të 5 turbinave-agregatëve të HEC Vau i Dejës” 9,989 mijë lekë dhe Riparim i guzhinetës drejtuese të poshtme dhe boshtit të turbinës së AG\$ në proces rehabilitimi në HEC Vau i Dejës”).

### **III.2.g. Investimet në proces realizimi**

Janë ne proces realizimimi investimet në njësitë e vetëqeverisjes vendore; Në bashkinë Malësi e Madhe me vlerë mbi 24,000 mijë lekë (Sistemim asfaltim rruga e Kronit Dedaj; Sistemim asfaltim rruga Zagorë-Goraj; Sistemim asfaltim rruga Kamicë-Flakë; Sistemim asfaltim rruga Linaj; Sistemim asfaltim rruga Çutaj, Bajzë; Rikualifikim i sheshit Dedaj); Në bashkinë Shkodër me vlerë rreth 222,000 mijë lekë (Rikonstruksion rrugët e brendshme Shiroke, Rruga e Shtregullave; Sistemim asfaltim rruga e “Drinit” Bahcallek; Rikonstruksion rruga “Muharrem Dragovoja”; ikonstruksion rruga “Ferrukej”; Rikonstruksion degezim rruga “Treni i Mallrave”; Rikonstruksion rruga “Asdreni”; Rikonstruksion vazhdimi i rruges “Bardhosh Dani” ne lidhje me rrugen “Rrojej”; Rikonstruksion i rruges “Milosao”; Rikonstruksion i rruges prane shkollës “ Ali Lacej”; Rikonstruksion rruga “Usta Meta”; Rikonstruksion degezim rruga “Besnik Ceka”; Rikonstruksion rruga (degezim) “At Zef Valentini”; Rikonstruksion rruga “Milan Shuflaj”; Rikonstruksion rruga “Qafa e Bishkazit”; Rikonstruksion rruga “Don Nikolle Kacorri”; Rikonstruksion i Bllokut te pallateve Rruga “Arkitekt Sinani”; Sistemim Asfaltim segmenti rrugor rruga “Skenderaj” dhe rruga “Haxhi Cafaj” Golem; Rehabilitim i qendres se fshatit Grude e re, rruga Kalimtari dhe rruga shkolla e re; Sistemim Asfaltim rruge te brendshme fshati Hot i Ri; Sistemim asfaltim rruga “Dani” ne Bardhaj; Sistemim, Asfaltim rruge te brendshme Dobrac (rruga Celiku, Dinaj, Haxhi Zeneli); Sistemim Asfaltim rruga “Maliq Idrizi” Shtoj i Ri, faza e

pare; Sistemim-Asfaltim i rruges Oblike-Pallate; Sisem Informacioni i Integruar per Menaxhimin Financiar te Bashkise Shkoder dhe Institucioneve te varesise; Sistemim Asfaltim rruga Qender Mes- Kullaj faza III; Rikonstruksion degezim Rruga “Besnik Ceka”; Sistemim Asfaltim rruga Dani ne Bardhaj; Sistemim Asfaltim rruga e Drinit Bahcallek; Rikonstruksion rruga Freskej; Sistemim Asfaltim Rruga e Geshtenjave Rrenc, Guri i Zi; Rikonstruksion Rruga “Ferrukej”; Rikonstruksion Rruga (degezim) “At Zef Valentini”; Sistemim asfaltim rruge te brendshme, fshati Sektor Velipoje; Sistemim asfaltim i rrugeve te Lagjeve, fshatit Juban(Rruga Rragame); Rikonstruksion Rruga “Daniel Mozali” loti II; Rikonstruksion rruga e Korpusit; Rikonstruksion vazhdimi i rruges “Ajase”; Rikonstruksion rruga “Mehmet Shpendi”; Rikonstruksion Rruga e Dalmaces; Rikonstruksion rruga “Gjino Berri”; Rikonstruksion rruga “Don Nikolle Kacori”; Rikualifikim urban blloqe banimi rruga e “korpusit”; Rikualifikim Urban bllok pallatesh rruga “Bashkimi”; Sistemim Asfaltim rruga Darragjat; Sistemim Asfaltim rruga “Darragjat” loti II; Sistemim Asfaltim rruga e varrezave Bleran; Sistemim Asfaltim i rruges Vukatane-Guri i Kuq; Rikonstruksion degezim rruga Amadeo; etj.); Në bashkinë Vau i Dejës me vlerë rreth 58,000 mijë lekë (Sistemim Asfaltim dhe ndricim i lagjeve NFP dhe Mlloje Vau i Dejes; Shtrim rruges, sistemim, ndricim qender Bushat; Ndricim i qendres se fshatit Kace dhe Plezhe; Sistemim dhe ndricim rruga qender Stajke; Ndricimi i rrugeve dhe vendosja e stolave ne fshatin Barbullush; Ndertim ure lagjia Kovac-Hajmel; Sistemim i qendres se fshatit Nenshat; Ndertim ure mbi lumin Gjader qe lidh Lagjet Kovac-Kabash dhe dheu i lehte; Ndertim ujesjellesi ne fshatrat qe ju sherben 20 familjeve); Në bashkinë Pukë me vlerë 1,500 mijë lekë (Rikonstruksion godina Zhvillimit Rural; Rikonstruksion ura Qerret; Sistemim amjente qender sociale, etj.); Në bashkinë Fushë Arrëz me vlerë mbi 5,000 mijë lekë (Ndërtim qendre administrative në Nj.A Blerim, Rikonstruksion rrugë të brendshme, etj)

Janë kryer procedurat e prokurimit dhe pritet të fillojë zbatimi i punimeve (me afat zbatimi 2022-2025) nepermjet FShZh, me një vlerë prej 1,658,446 mijë lekë, në 5 projekte; “Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe atraksionit turistik në zonën e Alpeve Shqiptare (seg Theth – Ndërlyaj, rikualifikim urban i sheshit të fshatit Theth, rikualifikim urban i sheshit të Kronit të Bogës)” 420,000 mijë lekë (me financimin e investimeve të qeverisë shqiptare); “Rikonstruksioni i rrugës Shirokë - Zogaj - Kufi, ndërtim sistemi të ujësjes - kanalizime Zogaj – Shirokë” 728,196 mijë lekë (Me fondet e BERZH-IPA); “Ndërtimi i Muzeut të Liqenit dhe Qendrës së Vizitorëve në bregun perëndimor të Liqenit të Shkodrës (The Nest)” 262,500 mijë lekë (Me fondet e BERZH-IPA); “Rikualifikim i Waterfrontit të Liqenit të Shkodrës, zona Shirokë - Zogaj (hapësira publike, plazh publik dhe aktivitete të shtuara)” 156,250 mijë lekë (Me fondet e BERZH-IPA); “Ndërhyrje turistike në kodrat përreth Shirokës (shtigje, pika panoramike, aktivitete rekreative)” 91,500 mijë lekë (Me fondet e BERZH-IPA)

#### **IV. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ADMINISTRATËN E SHTETIT (Administratën Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor)**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkoder në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive ka shqyrtuar veprimtarine e institucioneve qendrore ne nivel vendor dhe ka bashkërenduar punën ndërmjet tyre, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; Ka intensifikuar punën lidhur me bashkepunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me njësitë e veteverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë

aktivitet brenda territorit të Qarkut, nëpërmjet takimeve të shumta me drejtues të ministrive e Institucioneve të tjera qendrore, me qëllim zgjidhjen e problemeve që janë konstatuar nga institucionet në nivel Qarku.

Prefekti ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet qendrore, Degët Territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke koordinuar edhe veprimtaritë e tyre në nivel qarku, lidhur me menaxhimin e mbetjeve; Menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit; Goditjen e informalitetit në sektorin e furnizimit me ujë; Goditjen e informalitetit në ushtrimin e veprimtarisë së biznesit; Parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikimit të personave; Ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike; etj.

Gjatë vitit në ushtrimin e veprimtarisë së tij Institucioni ka patur një bashkëpunim shumë të mirë dhe është mbështetur nga Ministria e Brendshme (Drejtoria për Çështjet Vendore dhe Prefekturat), përfshi drejtuesit kryesor, të cilët gjatë vitit kanë organizuar e zhvilluar takime për probleme të zhvillimit të turizmit e territorit; Çështjet e Luftës kundër trafikimit të personave; Zbatimin e planit kombëtar në luftën ndaj kultivimit të bimëve narkotike; etj. Me ministrinë e Brendshme është bashkëpunuar në zgjidhjen e të gjitha problemeve në nivel qarku edhe me institucionet e tjera qendrore, përfshi problemet e mbrojtjes civile (Emergjencat e shkaktuara nga reshjet e shumta, përmytjet, zjarret, etj)

#### **IV.1. Institucionet qendrore në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre**

##### **IV.1.1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve**

Drejtoria Rajonale Tatimore (Drejtoritë Funktionale, Sektorët, Zyrat apo punonjësit që zbatojnë një funksion të caktuar), strukturë e Administratës Tatimore Qendrore, që merret direkt me mbledhjen e detyrimeve tatimore, me ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrollin e deklaratave dhe pagesave, kontrollin e tatimpaguesve, operon mbi bazën e manualeve procedurale të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku përshkruhen me hollësi veprimet që këto njësi ndërmarrin sipas funksioneve të administrimit tatimor

Objektivat për vitin 2021 (Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare; Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor; Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore) në përgjithësi janë arritur

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 5,485,540 mijë lekë, ose 97 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 244,460 mijë lekë (mosrealizim i cili ka ardhur nga mosrealizimi i të ardhurave kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore për 112,153 mijë lekë; Nga tatimi mbi të ardhurat personale 108,923 mijë lekë; Nga tatim fitimi 47,980 mijë lekë, etj). Realizimi i të ardhurave gjatë vitit ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar me 617,905 mijë lekë, por edhe me krahasuar me vitin 2019 me 111,288 mijë lekë (gjatë vitit 2019 janë realizur të ardhura me vlerë 5,992,157 mijë lekë

Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2021 (tremujori III-të), ka pësuar rritje me 456 persona krahasuar me vitin e kaluar

Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, për kontribuesit, numri i të punësuarve për vitin 2021 dhe 2020 paraqitet:

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi (sipas sektorëve dhe statusit)</b>	<b>Numri i të punësuarve, sipas vitit</b>
------------	--	---

		2021	2020
1	Në sektorin publik	10,010	10,037
	a. buxhetor	9,390	9,438
	b. jobuxhetor	620	599
2	Në sektorin privat	21,139	20,926
	a. Subjekte të regj. si person fizik	8,636	8,632
	b. Subjekte të regj. si person juridik	12,503	12,294
	Nga të cilët:		
	- Vendase	11,209	11,006
	- Të përbashkëta	397	475
	- Të huaja	897	813
	Gjithsej	31,149	30,693

Të ardhurat e realizuara dhe numri i të punësuarve ( kontribuesve), tregues të cilët kanë pësuar rritje jo vetëm krahasuar me vitin e kaluar, por edhe me vitin 2019 (para pandemisë), kanë ardhur nga masat e marra nga qeveria për mbështetjen e zhvillimin e turizmit dhe kryerjen e investimeve, si dhe nga puna dhe performanca e Drejtorisë Rajonale Tatimore

Gjatë vitit janë;

- Kryer 91 kontrole dhe 97 vizita fiskale, nga ku janë zbuluar detyrime me vlerë 67.541 mijë lekë;
- Bërë 309 ndryshime kësti tatim fitimi, ngatë cilët me rritje 305 me vlerë 61,419 mijë lekë dhe me zbritje 4 me vlerë 4,094 mijë lekë;
- Kryer 774 çështje “Kontroll nga Zyra”, zbulimi në total është 24,390,974 lekë ose 31,513 lekë/çështje
- Trajtuar 445 kërkesa për çregjistrim, ku për një pjesë të mirë të tyre ka qënë e nevojshme më shumë se një korespondencë me QKB-në.
- Kryer 896 kompensime detyrimesh tatimore me një vlerë prej 33.997.201 lekësh, janë anuluar edhe 844 kërkesa për transferim detyrimesh që nuk plotësonin kushtet për tu kryer
- Trajtuar 903 çështje Pyetje te Pergjitheshme ne sistem C@TS;
- Gjatë sezonit turistik jane aktivizuar me pergjegjesi tatimore Tvsh 78 subjekte, si dhe janë shtuar 479 punonjes te rinj

Në fund të muajit Dhjetor rezulton se numri i subjekteve active krahasuar me vitin e kaluar është rritur me 759, si dhe numri i fermerëve me 773. Po kështu është rritur numri I bizneseve të regjistruar me 532. Ndërsa numri I subjekteve të çregjistruara ka pësuar rënie me 7, krahasuar me vitin e kaluar

Në kuadër të masave të marra nga qeveria për fiskalizimin, gjatë vitit janë fiskalizuar 2,180 subjekte, nga 3,474 subjekte të përfshira, ose 62.8 % e tyre,

Në zbatim edhe të detyrës së dhënë nga Kryeministri u është dërguar shkresë 256 subjekteve, për korigjim deklarim page

Po kështu janë shqyrtuar, vlerësuar dhe kthyer përgjigje kerkesë-ankesave të ardhura nga persona e subjekte, si dhe lëshuar vertetime elektronike e manuale

Megjithë punën dhe arritjet gjatë vitit janë hasur probleme të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të punës;

- Nivel relativisht i ulët i reagimit nga biznesi i vogël në lidhje me fiskalizimin (Një pjesë e madhe e tyre po presin Ish kompanitë e kasave, të cilat nga ana e tyre po reagojnë me shumë vonesë për ti vënë në dispozicion tatimpaguesve kasat ekzistuese të përmirësuara sipas fiskalizimit);
  - Tatimpagues të cilët nuk paguajnë detyrimet si pasojë e paaftësisë paguese;
  - Tatimpagues (kryesisht biznes i vogël) të cilët ose nuk kanë kontakte ose nuk përgjigjen në kontaktet e vendosura;
  - Gjatë përcaktimit të tatimpaguesve për kontroll tek 30 %-i DRT vërehet se nga kriteret e vendosura dalin vetëm tatimpagues të cilët janë me humbje dhe me rënie të theksuar të xhiros dhe pagesave, nga të cilët edhe po u kontrolluan nuk priten pagesa të larta;
  - Persona të cilët janë regjistruar në E-Albania por nuk kujtojnë as fjalëkalimin dhe as kanë vendosur një E-mail aktiv. Kjo gjë ka krijuar edhe vonesa në pajisjen me Certifikata Elektronike;
  - Nivel i ulët i njohurive kompjuterike nga ana e shumë individëve, sidomos atyre të moshës së tretë por edhe nga ana e punonjësve të subjekteve publike të trajnuar për fiskalizimin;
  - Mungesë e mjeteve për të kryer detyra të tilla si kontaktimi/verifikimi në vend i tatimpaguesve. Kujtojmë se DRT ka vetëm një mjet në dispozicion;
  - Tatimpagues të cilët pasi krijojnë detyrime kalojnë në aplikim për çregjistrim;
  - Tatimpagues që nuk deklonjë pasi nuk ushtrojnë më aktivitetet dhe mbesin aktiv pasi nuk mund të kalojnë pasiv pasi kanë detyrime tatimore;
  - Punonjës të infektuar me COVID ose me simptoma, gjë që ka sjellur mungesën e tyre në punë;
  - Angazhimi i Ekspertëve të Jashtëm, Ing.Ndërtimi, ka qënë një arsye për mos kryerjen e kontrolleve në kohë (DRT-Shkodër, nuk kishte në organikën e saj një Ing.Ndërtimi, dhe për çdo subjekt me punime ndërtimi);
  - Dërgimi me vonesë i dokumentacionit ndihmës nga institucione të tjera (ASHK, Banka) dhe marrja e informacioneve nga institucione të tjera të nevojshme për të kryer vlerësime sa me objektive;
  - Në subjektet grumbullues të fruta perimeve për eksport, është hasur vështirësi në monitorimin e çmimit të blerjes nga fermerët si edhe vonesë në kthimin e përgjigjeve të Ekstensioneve Bujqësore

#### **IV.1.2. Dega e Doganës Shkodër**

Janë realizuar të ardhura nga Dogana, me një vlerë prej 3,759 mijë lekë, ose 118.3 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 580,564 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje jo vetëm me vitin e kaluar prej 783,384 mijë lekë, por edhe krahasuar me vitin 2019 (para pandemisë) me 413,681 mijë lekë (gjatë vitit 2019 janë realizuar të ardhura me vlerë 3,345,329 mijë lekë)

Si rezultat i bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e policisë vendore është intensifikuar puna, për goditjen e fenomenit të fshehjes së detyrimeve doganore nga subjektet gjatë importit të mallrave

Problem, edhe pse bashkëpunimi dhe mbështetja e strukturave të tjera nuk ka munguar, i vetmi ambient për një kontroll të hollësishëm mbetet një ambient i perbashkët me policinë kufitare në vijën e dytë, problem për të cilin kerkohet ngritja e ambienteve me paisje skanimi për

të gjitha mjetet, ka do të permirësonte dhe do ta bënte më efikase punën në pergjithësi, jo vetem të doganës

#### **IV.1.3. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore**

Gjatë viti zbatim të akteve ligjore e nën ligjore dhe Rregulloreve të ISSH, institucioni është angazhuar për realizimin e detyrave të parashikuara dhe ato të dala gjatë vitit

Janë realizuar detyrat e për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi, kontributet vullnetare, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të arketimit të detyrimeve nga subjektet publike e private.

Gjatë vitit janë arkëtuar të ardhura, për kontribut sigurime sohoqërore e shëndetësore nga të vetëpunësuarit në bujqësi me vlerë 179,464 mijë lekë, nga 165,000 mijë lekë të programuara, ose 109 %, si dhe nga kontributi vullnetar me vlerë 19,339 mijë lekë, nga 17,000 mijë lekë të programuara, ose 114 %. Pra vitin janë realizuar detyrat e ngarkuara për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetepunësuarve në bujqësi me tejkalim të planit vjetor, kontributet vullnetare me tejkalim të planit vjetor dhe ka ndjekur në vazhdimësi kontributet e subjekteve shtetërore e private. Dega e përfitime, gjatë vitit është përballur me një volum të konsiderueshëm pune duke shqyrtuar kërkesa të ndryshme, për përfitime, nga ligji 7703 datë 11.05.1993 ( i ndryshuar) për 12572 shtetas. Jane caktuar 3486 pensione te reja, dhe jane mbyllur 3345 pensione. Gjithashtu janë trajtuar kërkesat sipas Ligjit 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, ku përfitues deri tani kanë rezultuar 568 pensionistë.

Për të gjitha rastet janë bërë llogaritjet dhe rillogaritjet, vendimet, kartelalat financiare si dhe pasqyrimi dhe gjenerimi I pagesës në sistemin PCAMS.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera (Posta sha Shkoder dhe të gjitha bankat e nivelit te dytë që operojne ne Qarkun Shkodër, Tatim Taksat, institucionet tek te cilet bejme verifikime te vjetersive ne pune ose kalojmë përfitimet e kategorive të ndryshme etj.) ka qenë pjesë e punës së përditshme.

DRSSH Shkodër, ploteson të gjitha kërkesat për pensione të reja pleqeri, invaliditet, familjar, të gjithë llojet e tjere të perfitimeve suplementare, trajrimeve te ndryshme financiare, paftesive te perkohshme ne pune, barre lindjeve etj. Kërkesat priten nga Adisa Shkoder e Malesi e Madhe, si dhe ALSSH Puke, administrohen në rrugë zyrtare nga DRSSH-ja Shkodër dhe pergjigjet kthehen po zyrtarisht pranë institucioneve pritese, gjithmone brenda afateve ligjore të përcaktuara për çdo kategori te lartpërmëndur. Po ashtu u jemi pergjigjur ne kohe kerkesave per rishqyrtim pensioni duke rillogaritur pensionin, kur ky pëson ndryshim, ose duke kthyer pergjigje te kerkeses me shkrim, ne rastet kur nuk perfiton shtesë. Pranë DRSSH-së Shkodër funksionon edhe Komisioni Rajonal i Ankimit (pjesë e procedurës administrative te ankimit), i cili trajton kërkesat, kompetence e tij. Po kështu prane DRSSH-se Shkoder dhe Agjensive te saj, ekzistojne kutite e ankesave për pretendimet e cdo njerit.

#### **IV.1.4. Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të ushqimit**

Puna e Drejtorisë është përqendruar e realizimin e planeve te Inspektimeve te miratuara nga DPAKU; Ne realizimin e detyrimeve te planifikuara te treguesve financiar; Ne zbatimin me

rigorozitet të praktikave sipas ligjit (Ligji Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në R.Sh” me ndryshime; Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, me ndryshime; VKM Nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU”, me ndryshime), si dhe sipas planit kombëtar të kontrolleve (miratuar me Udhëzimit Nr. 2, datë 24.02.2020, me ndryshime) e urdhërave të KMCQ për marrjen e masave anticovid

Gjatë vitit janë kryer 1,685 inspektime, me praktika të rregullta online nga sektorët e inspektimit në terren (nga të cilat sipas planit 1,463 inspektime, ose 68.6 % dhe 222 inspektime jashtë planit), 15,337 inspektime në PKK Hani Hotit (të praktikave të lëvizjes produkteve ushqimore, produkteve bimore për konsum, kafshë të gjalla, medikamente veterinarë e plehra kimike), si dhe janë analizuar 424 mostra në laboratorin e DR, nga të cilat 141 mostra të ardhura nga PKK Hani Hotit, sipas planit të monitorimit të qumështit të përpunuar, etj.). Nga inspektimet e kryera janë konstatuar dhe raste të mos përmbushjes së kërkesave ligjore:

- *Mungesë e gjurmueshmërisë së produkteve;*
- *Mos realizim i detyrave të lëna në afatet e përcaktuara;*
- *Mungesë etiketasg në gjuhën shqipe;*
- *Mos plotësim i kërkesave ligjore për sistemin dhe etiketimin e produkteve ushqimore;*
- *Mosbashkëpunim OBU për dorëzimin e dokumentacionit, nga personat përgjegjës, me justifikime e arsye të ndryshme*

Për gjetjet e konstatuara gjatë ushtrimit të inspektimeve, janë marrë masa administrative 341 raste, nga të cilat:

- Gjobë në 24 raste, me vlerë 2,000 mijë lekë
- Paralajmërim, me qëllim eliminimin e parregullsive dhe shkeljeve të cilat nuk përbëjnë kundërvajtje administrative, në 309 raste
- Bllokim produktesh në 5 raste
- Asgjësim i produkteve në 3 raste me një sasi prej 5.2 ton (*produkte të skaduara-kalim të afatit të përdorimit* )

Gjatë vitit Drejtoria Rajonale e AKU është angazhuar në monitorimin zbatimin e masave anticovid, si pjesë e Task Forcës së ngritur në kuadrin e masave shtesë për mbrojtjen nga infeksioni

#### **IV.1.5. Drejtoria e Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive**

Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare për Punësim e Aftësim, Shkodër, (AKPA) , gjatë vitit ka ushtruar veprimtarinë në përmbushje të misionit dhe kryerjes së detyrave funksionale

- Përveç futjes së sitemit informatik të shërbimeve të punësimit ndaj punëkerkuesve dhe punëdhënësve nga MFE dhe AKPA u bë e mundur edhe përmirësimi i bazës ligjore
- Me fokus punësimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël, për rritjen e mundësive të punësimit, ka bashkëpunuar dhe organizuar tryeza të rumbullakëta me pjesëmarrje nga grupet e interesit (të organizuara këto në ambientet e DRAKPA, apo edhe në bashki, Universitet, ShSSH dhe OJF të ndryshme, me të cilat është bashkëpunuar në vazhdimësi)
- Janë analizuar dhe kthyer përgjigje 130 kerkesave të ardhura, nga të cilat 112 në menyrë shkresore dhe 18 nepermjet portalit të bashkëqeverisjes

Në fund të vitit janë regjistruar punëkerkues të papunë 3,397 persona (ku 53 % e

punëkërkuessve të pa punë janë femra) nga 3,658 personat të regjistruar në fund të vitit të kaluar, me një diferencë më pak 261 persona, ose 7.1 %.

Gjatë vitit janë punësuar 729 pu.pa (femra 409), nga të cilët:

- Me ndërmjetësime direkte 454 pu.pa.
- Me përfshirjen në programet e nxitjes së punësimit 272 pu.pa.

Janë regjistruar në kurse profesionale 513 pu.pa (femra 270), nga të cilët:

- Në kurse profesionale 419 pu.pa.
- Në Start-Smart 94 pu.pa.

Në kuadër të integritimit të punëkërkuessve të papunë, që vijnë nga grupet e dizavantazuara, në Drejetorinë Rajonale, kanë kaluar në cikle këshillimi rreth pu.pa. të mbështetur nga modulet e adaptuara në AKPA, nga implementimi i projekteve

Gjatë vitit janë ne kryerjen e veprimtarisë, janë hasur probleme;

- Mosfunksionimit të rregullt të transportit urban ( në oraret e fillimit të punës) në disa zona si Shiroka dhe Zogej. Ky fakt ka bërë që të kemi refuzime të vendeve të punës nga pu.pa. që banojnë në këto zona me arsyen e mungesës së këtij transporti.

- Po kështu mungesa e çerdheve dhe kopshteve në këto zona , si dhe në bashkinë Vau Dejës , është një problem shqetësues që çon në refuzimin e punës nga pu.pa. me arsyen se nuk kanë ku i lënë fëmijët;

- Kostoja që ju ngarkohet personave (për tu paraqitur fizikish cdo muaj në sportelet e shërbimeve), për të qenë përfitues të programeve pasive (Ndihmë ekonomike, apo pagesë papunësie

Nisur nga detyrat funksionale (Shërbime të ndërmjetësimit, Shërbime të ndërmjetësimit në punë për të papunët që kërkojnë punë, të punësuarit që kërkojnë të ndryshojnë punë, personat me paaftësi të ndryshme dhe punëdhënësit; Shërbime të këshillimit profesional dhe të aftësimit për punësim a vetëpunësim për punëkërkuessit; Shërbim e pagesës së papunësisë për individët që e përfitojnë atë; Financim të punëdhënësve që krijojnë vende të reja pune ose që punësojnë të rinj të sapodiplomuar; Nxitjen e punëdhënësve që punësojnë persona me paaftësi; Formimin dhe riformimin profesional për punëkërkuessit dhe për të rinjtë në intervalin ndërmjet shkollës së mesme dhe të lartë; Kryerja e studimeve të autorizuara të tregut të punës, etj.), gjatë vitit mbi bazën e planit të treguesve të monitorueshëm nga Drejtoria Përgjithshme, është hartuar plani i veprimeve për realizimin e treguesve, duke bërë një detajim me tregues për specialist

Për kryerjen e veprimtarisë nga ana e Drejtorisë Rajonale të SHKP është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore dhe subjekte publike e jo publike

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të AKPA-s, Shkodër, gjatë vitit janë shqyrtuar edhe kërkesa dhe ankesa të ndryshme të shtetasve, apo institucioneve të ndryshme (Hapje karte shëndeti; Konfirmimi i statusit si i papunë; Bursa studimi për fëmijët; Bashkime familjare me fëmijët në emigracion; etj, duke qenë dhe për të gjithë këto raste kërkohet konfirmimi si i papunë, megjithëse kërkuesit nuk kërkojnë punë, pra nuk janë të regjistruar si kërkues për punë; Ankesa nga pu.pa.” Ish përfitues të ndihmës ekonomike”)

#### **IV.1.6. Drejtoria Rajonale e Ofrimit Formimit Profesional Publik**

Bazuar në politikat qeveritare dhe Strategjinë kombëtare “PËR PUNËSIM DHE FORMIM”, u përcaktuan objektivat vjetore për formim profesional nëpërmjet zhvillimit të



kurseve afatshkurtëra në bashkëpunim me Zyrat e Punësimit në rajon. Këto objektiva u përcaktuan me synimin e qartë për të plotësuar kërkesat e tregut të punës për personel të trajnuar, me prioritet punëkërkues të papunë.

Është bërë planifikimi i zhvillimit të kurseve afatshkurtra të formimit profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke u fokusuar në përfshirjen e punëkërkuesve të papunë, me prioritet shtresat vulnerabël, ku në përfundim të procesit, dhe pas rishikimit të parashikimit sipas planit të AKPAS-s për treguesit e monitorueshëm sipas DROFPP-ve, është konkluduar për listën e kurseve që do të zhvillohen gjatë vitit, numrin e punëkërkuesve që do të përfshihen në këto kurse, si dhe janë parashikuar afatet e zhvillimit të tyre, duke planifikuar hapjen dhe zhvillimin e 26 llojeve të kurseve, nga të cilat 23 profesionale, 2 të tjera jo profesionale (Anglisht & Gjermanisht) dhe trajnimin «Start SMART+19». Nga këto 26 lloje kurseve, ishte planifikuar të realizoheshin:

- 757 regjistrime gjithsej (666 në kurset profesionale, 91 në ato jo profesionale Anglisht& Gjermanisht) dhe 378 të tjera në trajnimin “Start SMART +19”;
- 493 regjistrime pupa, nga të cilat 448 në kurset profesionale, 45 në ato joprofesionale (Anglisht) dhe 371 të tjera në trajnimin “Start SMART+19”.

Gjatë vitit janë hapur 13 lloje nga kurset e planifikuara, nga të cilat: 11 prej tyre profesionale dhe 1 jo profesional, si dhe “Start SMART”, duke realizuar;

- 718 regjistrime gjithsej (635 PUPA), 576 (502 PUPA) prej të cilave në kurset profesionale, 16 (9 PUPA) në kurs joprofesionale dhe 126 (124 PUPA) të tjera në trajnimin “Start SMART+19”;
- 537 certifikime gjithsej (482 PUPA), nga të cilat 375 (339 PUPA) në kurset profesionale, 30 (13 PUPA) në kurs jo profesional dhe 132 (130 PUPA) në trajnimin “Start SMART+19”.

Regjistrimet e punëkërkuesve të papunë janë realizuar në masën 104 %, ndërsa regjistrimet në total janë realizuar në masën 78 %, kjo për mos hapje të disa kurseve profesionale sipas planifikimit, për shkak mungesës së orientimeve të punëkërkuesve të papunë nga Zyrat e Punësimit për ndjekjen e kurseve, që zyrat kanë planifikuar dhe që janë në përputhje me kërkesat aktuale të tregut të punës, si: “Shërbim në bar dhe restorante”, “Mobileri”, “Saldim”, “Riparim makina qepëse”; Tejzgjatjes së rekrutimit të instruktorëve me kohë të pjeshme “Instalime dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik”, “Berber”, “Teknikë rrjeti kompjuterik” (sipas Udhëzimit Nr 11, datë 03.03.2020, pasi në zbatim të shkresës Nr. 913 prot., datë 23.03.2021 të AKPA-së, u pezullua procedura e rekrutimit prej datës 25.03.2021 deri në përfundim të fushatës zgjedhore); Ndërpërjes së procedurave të hapjes së kurseve profesionale: “Manikyr Pedikyr” (2 grupe), “Kuzhinë” (2 grupe), Sekretari” (1 grup), “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike” (1 grup), “Instalime dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik” (1 grup) dhe “Berber” (1 grup) gjatë muajit Shtator, për arsye të mungesës së drejtorit të Qendrës (dorëheqje).

Përfshirja në grupe të integruara të personave nga shtresat vulnerabël (pagesë papunësie, rom, emigrantë të kthyer, persona me aftësi të kufizuar, persona të skemës së ndihmës ekonomike dhe ish – skemës së ndihmës ekonomike) në kurset profesionale, si dhe “Start SMART+19”. Gjatë vitit 17 % e kursantëve të regjistruar dhe që kanë frekuentuar i përkasin shtresave vulnerabël

#### **IV.1.7. Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (Seksioni i Ekstensionit Bujqësor Shkodër)**

Drejtim kryesor i këtij i veprimtarisë është rritja e efektivitetit të shërbimeve të ekstensionit për këshillim, trajnim dhe sigurim informacioni në Qendrat e Informacionit Bujqësor e më gjerë, nëpërmjet realizimit cilësor të programeve dhe aktiviteteve të planifikuara, në përputhje me prioritetet dhe tendencat e zhvillimit të bujqësisë, politikave dhe strategjive të MBZHR

Numri i fermave brenda territorit të qarkut (me një sip, shumë të madhe gjeografike, e shtrirë nga bregdeti deri në lartësinë mbi 2000 m, ku kultivohen një larmi bimësh e kulturash bujqësore) ka qenë 43,902. Gjatë vitit është rritur numri i fermerëve të regjistruar (me NIPT) krahasuar me vitin e kaluar me 851 dhe krahasuar me vitin 2019 me 1,281 (Numri i fermerëve me NIPT gjatë vitit ka qenë 6,038, në vitin e kaluar 5,187 dhe në vitin 2019 ka qenë 4,757)

Sipërfaqja e tokës bujqësore në qark (5 Bashki) është 46,115 Ha (tokë arë 42,530 dhe pemë frutore 3,585 Ha), nga e cila e mbjellë 37,030 ha dhe Livadhe, kullota dhe e pa mbjellë (djerr) 9,085 Ha

Prioritet dhe objektivat e ekstensionit (zbatimi i udhëzimeve të MBZHR dhe MFE mbi skemat kombëtare në bujqësi dhe shpërndarjen e informacionit, për masat e mbështetjes dhe kriteret e përfitimit të projekteve nga fermerët në skemën IPARD II dhe skemat kombëtare) dhe sektorët strategjikë (Prodhimi dhe grumbullimi i BAM-ve ; Prodhimi i pemëve frutore dhe perimeve ; Prodhimi dhe përpunimi industrial i fruta perimeve ; Prodhimi dhe përpunimi industrial i produkteve të qumështit dhe mishit) kanë qenë të orinetuar drejt sistemeve bujqësore në zhvillim, jo si një shërbim i izoluar, por një shërbim kompleks ku përfshihet i gjithë sistemi i gjenerimit, transformimit, përhapjes dhe përdorimit të informacionit dhe njohurive në fushën e bujqësisë

Kanë aplikuar për skemat IPARD II, sipas këshillimeve të dhëna nga specialistët e ekstensionit dhe orientimeve të AZHBR, 978 fermerë, nga të cilët 887, ose 90 % janë shpallur fitues, të cilët kanë terhequr sasinë e karburantit (sipas skemës)

Në skemat kombëtare kanë aplikuar online 1,678 fermerë, nga të cilët kanë përfituar 528;

- Për tufën bazë të matriculluar 247
- Mbarështim bletarie 140
- Masa III-Zevëndësim plasmas termik 16
- Masa IV-Bimë aromatike mjekësore 106
- Bujqësia organike 19

Në qark ushtrojnë veprimtarinë 6 Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor, ku janë të përfshirë 56 fermerë; Grupe të vogla interesi, të cilët bashkojnë punën dhe prodhimin e tyre për marketimin e produkteve të caktuara (Në Shkodër 21 grupe me 650 fermerë; Pukë e Fushë Arrëz 6 grupe me rreth 75 fermerë); Po kështu ushtrojnë veprimtarinë edhe disa agrobiznese, të cilat monitorohen nga specialistët e SEB (“KLEGEN”, “KONAJ”, “ALBA MILK”, “NZI”, “BUNAFARM”, “REÇI PRODHIMTAR”, “INTEK HASMEGAJ), si dhe disa grupe të vogla në bashkinë Malësi e madhe e Pukë, që prodhojnë e përpunojnë produkte organike në kushtet e fermës

Për kryerjen e veprimtarisë është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore, shoqata e organizata dhe fermerë, bashkëpunim i cili ka qenë i mirë,

veçanërisht;

- Në përballimin e situatës emergjente të krijuar nga reshjet dhe përmbytjet, si dhe rënia e zjarrit (bujqësia nuk u përball me situata të rënda dhe përmbytjet nuk kanë rrezikuar kulturat bujqësore. Ka patur 2 raste zjarri ku janë djegur 1.7 Ha ullishte në Nj.A Ana e Malit dhe 1.5 Ha me BAM në bashkinë M.Madhe)

- Në zbatimin e planit të veprimit kundër kultivimit të kanabisit (Ndërgjegjësimin, orientimin dhe trajnimin e fermerëve drejt kultivimit të kulturave bujqësore fitim prurëse; Identifikimin e kultivimit të sipërfaqeve të mbjella, përfshirë serrat; Monitorimin dhe kontrollin e territorit, etj)

- Në zhvillimin e aktiviteteve të tjera (Zhvillimi i aktiviteteve me përparësi agroturizëm, kryesisht në fshatrat turistik; Për identifikimin e fermave me prodhime autoktone, të cilat janë një potencial tradicional, ku deri më sot janë 33 ferma të çertefikuara dhe në proces, nga të cilat 19 kanë përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare; Për realizimin e aktiviteteve me përparësi marketingun e prodhimeve bujqësore, etj)

#### **IV.1.8. Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë (Sektori Shkodër)**

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, në Qarkun Shkodër ka në administrim 151.1 km kanale të parë kullues, 63.9 km argjinatura mbrojtëse nga përmbytjet, rrjet të parë ujitës me gjatësi 180 km si dhe një rezervuar për ujitjen e tokave bujqësore (rezervuari i Shtodrit)

Janë kryer shpenzime për investime, me fondet e buxhetit, me vlerë prej 62,527 mijë lekë, për mbrojtjen nga lumi “Drin” perballe harkut te Berdices, Nj.A Berdicë e bashkisë Shkodër

Nga Buxheti i Shtetit për vitin 2021 është akorduar fondi prej 19.7 milion lekë në zërin “shpenzime operative” të ndara për: rehabilitimin e rrjetit kullues me fondin prej 18.7 milion lekë, për rehabilitimin e rrjetit ujitës 2.2 milion lekë si dhe 1 milion lekë për rehabilitimin e objekteve të mbrojtjes nga përmbytja.

Gjatë vitit janë kryer punime në 15 objekte të kullimit, të punime rehabilituese të programuara dhe të domosdoshme

Sipas programit të hartuar është punuar për rehabilitimin e 10 objekteve të kullimit (Kanali kullues K-6 Dajç, Bregu-Bunës me fondin prej 2,000 mijë lekë; Kanali Kullues K-5 Dajç, Bregu-Bunës me fondin prej 1,500 mijë lekë; Kanali kullues K-2 Bushat me fondin prej 1,100 mijë lekë; . Kanali kullues K-4 Dajç, Bregu-Bunës me fondin prej 1,800 mijë lekë; Kanali kullues K-3+7 Bushat me fondin prej 3,500 mijë lekë; Kanali kullues K-1 hidrovari Ças me fondin prej 2,300 mijë lekë; Kanali kullues K-13 Gur i Zi me fondin prej 1,000 mijë lekë; Kanali kullues K-1 Oblikë me fondin prej 1,000 mijë lekë; Kanali kullues i Peshkut me fondin prej 1,000 mijë lekë dhe Kanali kullues Urë-Vilu (Murtemza) me fondin prej 3,500 mijë lekë)

Janë kryer punime të domosdoshme, për rehabilitimin e veprave të kullimit në 5 objekte (Kanali Kullues K-4 Nenshat –Hajmel me vlerë 894 mijë lekë; Kanali Kullues K-21 Bushat me vlerë 1,836 mijë lekë; Kanali kullues , vazhdimi K-1 hidrovari Ças me vlerë 1,549 lekë mijë lekë; Perroi i Glines ,Vau i Dejës me vlerë 454 mijë lekë dhe Perroi i Oblikes me vlerë 282 mijë lekë)

Janë kryer punime në 5 vepra të ujitjes;

Për rehabilitimin e veprave të ujitjes (Kanali ujitës KU-3 Bërdicë me vlerë 1,100 mijë

lekë; Kanali ujitës Mjedë-Kosmaç (punime me te trete) me vlerë 500 mijë lekë dhe Kanali ujitës Mjedë-Kotërr (punime me te trete) me vlerë 600 mijë lekë)

Punime të domosdoshme rehabilituese në 2 vepra ujitëse (Kanali ujitës KU-3 Bërdicë me një vlerë prej 754 mijë lekë dhe Kanali ujitës Portat Mjedë-shpërndarësi Mjedë me një vlerë prej 288 mijë lekë)

Janë marrë masa dhe është punuar në forcimin e argjinaturave;

Është ndërhyrë për Riparimin e argjinaturës së lumit Buna, Shirq (punime me të tretë) me fondin prej 1,000 mijë lekë

Per mbrojtjen e tokave bujqesore dhe zonat e banuara nga veshimi i ujrave te lumenjeve e perrenjeve malor ne qarkun Shkoder nder vite jane ndertuar argjinatura e mbrojtjes nga permbytja me nje gjatesi te pergjitheshme prej 63.9 km, por nga verifikimi i gjendjes konstatohet se është e domosdoshme ndërhyrja me punime të domosdoshme rehabilituese, për garantimin e sigurisë së 4 argjinaturave (Argjinatura e lumit Buna Reç-Pulaj, duhen kryer punime per pastrimin dhe shkuljen e bimesise dhe pemeve ne trupin e argjinatures ne gjithe gjatesine dhe punime per riparimin e demtimeve, gerryerjeve dhe per mbylljen e vrimave; Argjinatura e lumit Buna Pentar – Luarze, duhen kryer punime per pastrimin e bimesise ne trupin e argjinatures per gjithe gjatesine e shtrirjes se saj si dhe punime per riparimin e demtimeve te veshjes prej betoni të skarpates , demtime te shkaktuara nga zhvillimi i rrënjëve te bimësive , si dhe punime per mbylljen e vrimave dhe gerryerjeve me materiale te ndryshme; Argjinatura e lumit Buna , Dajç, nevojiten te behen edhe punime per riparimin e demtimeve te veshjes prej betoni të skarpates , demtime te shkaktuara nga zhvillimi i rrënjëve te bimësive , si dhe punime per mbylljen e vrimave dhe gerryerjeve me materiale te ndryshme; Argjinatura e lumit Buna, Darragjat nevojiten te behen punime per veshjen me shtresë prej betoni të skarpates si dhe punime per mbylljen e vrimave dhe gerryerjeve që janë shkaktuar ne trupin e argjinaturës. Ne panelin terthore te argjinatures se lumit Buna ne zonen Derragjat eshte e nevojshme nderhyrja per riparimin e demtimit te pllakave prej betoni); Po kështu në Argjinaturën Kuç – Vukatane eshte e nevojshme nderhyrja me punime rehabilituese e perforcuese per sigurine e argjinatures; Argjinatura Suka-Mjede-Stajka eshte e nevojshme nderhyrja me punime rahabilitimi e perforcimi per garatimin e sigurise e mbrojtjes nga uji; Argjinatura e Rrjollit, Bashkia Malesi e Madhe ka nevoje per punime rehabilituese ne nje segment prej te pakten 800m pasi jane verejtur shume probleme me gerryerje te argjinatures qe avancojne sa here qe ka rreshje intensive duke rrezikuar permbytjen e zones ku shtrihet shtrati i perroit; Argjinatura e lumit Vermosh, Bashkia Malesi e Madhe ka nevoje per punime perforcuese per sigurimin e mbrojtjes nga vershimet e ujerave te lumit pasi jane verejtur shume probleme me gerryerje te argjinatures qe avancojne sa here qe ka rreshje intensive duke rrezikuar permbytjen e zonave e banuara; Bregu i lumit Kir Probleme jane konstatuuar ne bregun e majte te Lumit Kir te Ura Bardhaj qe nga vershimi i ujit rrezikohen banesa dhe shembja e rruges se zones se banuarsi edhe segmenti ne krahun e djathte te Xhamija plumbit .Ne segmentet ne Hot te Ri perball fshatit Myselim si dhe segmenti poshte sifonave ne Mes te KUShtoder ne krahun e djathte te rrjedhjes se lumit vazhdojne gerryerjet nga vershimi i lumit ne periodha me rreshje te medha

Ndërsa Argjinatura e Çasit dhe Vilu, Velipoje; Argjinatura Kosmaç-Ashte; Argjinatura Naraç-Gjader janë në gjëndje të mirë teknike

Per Lumin Buna, është konstatuuar dëmtim i pllakës së betonit në panelin mbrojtës të

argjinaturës në hyrje të fshatit Derragjat si dhe gërryerje që avancojnë në brigjet e lumit në Goricë të Muriqanit.

Për rritjen e sigurisë së digës së rezervuarit Shtodër (me kapacitet ujembajtëes prej rreth 11 milion m<sup>3</sup>, shërben për rritjen e kapacitetit të ujit për ujitjen e tokave bujqëesore të zonës nëpërmjet kanalit Rragam –Shtodër – Koplik) gjatë vitit 2020 dhe 2021 me fondet e buxhetit të shtetit në zërin investime janë kryer punime rehabilituese për nënobjektet si: shkarkuesi katastrofik, vepra e lëshimit të ujit, shkarkuesi fundor, rrethimin e digës, ndriçimin e saj si dhe krijimin e kushteve për ruajtjen e objektit. Aktualisht gjendja e digës dhe e elementëve të sajë është e mirë, vazhdon mbushja me ujë e rezervuarit për të bërë të mundur sigurimin e sasisë së nevojshme të ujit për ujitje në sezonin e ujitjes

#### **IV.1.9. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bune**

Veprimtaria e Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor mbështetet në Ligjin Nr. 111, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me ndryshime; VKM Nr. 550, datë 15.07.2020 “Për miratimin e Formularëve të kërkesës për miratim në parim, për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor e lejes/autorizimit në përdorimin e burimit ujor”, Rregullores së Këshillit të Basenit Ujor (miratuar me Vendimin Nr. 06, datë 12.06.2019 të Këshillit të Basenit), si dhe planeve të punës të hartuara e miratuara, sipas problemeve të veçanta

Gjatë vitit janë zhvilluar 5 mbledhje të Këshillit të Basenit Ujor Drin-Bune (datë 19 Mars; 23 Prill; 01 Korrik; 12 Tetor dhe 18 Nëntor), në të cilat janë marrë 36 vendime;

- Leje përdorim uji 27 (prodhim energjie 14, prodhim uji të ambalazhuar 2, për akuakulturë 2, qellime blegtorale 1 dhe qelolime të ndryshme 8)
- Ndryshim leje përdorimi 1
- Autorizim për shkarkim ujëra të ndotura 1
- Autorizim për veprimtari në brigje dhe shtretër të burimeve ujore 1
- Leje për hapje puse shpimi 2
- Mos miratim leje përdorim uji 2 (për prodhim energjie 1, prodhim uji të amb.1)
- Anullim leje përdorim uji 1 (përdorim uji për akuakulturë)
- Shtyrje e propozimit për pezullim leje përdorim uji për energji elektrike 1

Jane ushtruar 214 kontrole dhe monitorime në subjektet e pajisura me leje, lidhur me përdorimin e burimeve ujore (33 subjekte që përdorin ujin për prodhim energjie, 8 subjekte që përdorin ujin për inbotilim, 59 burime të UK, 16 përdorues teknologjik, 5 perorues në akuakulturë, 4 përdorues turistik, 9 përdorues të ndryshëm, 2 përdorues hapje pus shpimi, 1 ushtrim aktiviteti në brigje, 12 subjekte për shfrytëzim inerte për ndërtim rrugë, 33 ankesa dhe verifikime jashtë planeve të punës dhe 32 matje të cilësisë së ujit me pajisjen Aquaread)

Gjatë vitit u është dërguar shkresë zyrtare subjekteve debitore, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, si dhe Sh.A të Ujësjellës Kanalizimeve, të cilat akoma nuk kanë kontratë me Zyrën e Basenit

Janë faturuar të ardhura me vlerë 94,346 mijë lekë, nga 65,687 mijë lekë të planifikuara, ose 144 % e të ardhurave të planifikuara, me një diferencë më tepër prej 28,659 mijë lekë

#### **IV.1.10. Administrata e Zonave të Mbrojtura**

Pavarsisht problemeve të krijuara, nga pandemia si dhe kushtet klimatike (temperaturat e

ulëta në periudhën e dimrit dhe të lart në verë) në bashkëpunim me institucionet vendore (mbështetur edhe në marrëveshjet e nënshkruara) e qendrore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore (mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me bashkinë Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë e Fushë Arrëz), DVP, ZVA Shkodër e M.Madhe, bashkëpunim i cili ka qënë i mirë dhe me institucionin e Prefektit shumë i mirë, në menyrë të vazhdueshme, gjatë gjithë vitit, u intensifikua puna për realizimin e objektivave të vitit (Zbatimi me rigorozitet e akteve ligjore e nënligjore e të rregulloreve e urdhrave të punës; Ngritja e kapaciteteve menaxhuese, monitoruese e kontrolluese nepermjet trajnimeve të vazhdueshme; Pasurimi dhe Perfeksionimi i sistemit database, për të gjitha aktivitetet dhe problematikat e zonës së mbrojtur; Ndërgjegjësimi dhe njohja e komuniteteve dhe shkollave me vlerat e zonave të mbrojtura; Pakësimi i rasteve të zjarreve, sipërfaqeve të dëmtuara dhe veprimtarisë së paligjshme në zonat e mbrojtura; Rritja e nivelit të bashkëpunimit ndërkuftar me palën malazeze për liqenin e Shkodrës). Por megjithë unën e bërë, rezultat ishin larg pritshmërie

Gjatë vitit janë kryer 156 monitorime të florës dhe faunës së habitateve, monomentët e natyrës. Tabela e të dhënave të florës është pasuruar si në monitorime (duke i i shtuar listës së monitorimeve specie të reja në ZM), ashtu edhe në të dhëna të mbledhura. Për monitorimin e faunës së egër janë vendosur kamera kurth në Parkun Kombëtar Theth, Rezervatin Natyror të Menaxhuar Liqeni i Shkodrës dhe Peisazhin Ujor Tokësor të Mbrojtur Lumi “Buna”-Velipojë, kamera të cilat ka regjistruar foto të dhive të egra, derrave të egër, dhelpra, çakall, lepur i egër, etj, monitorim që tregon për rritje të konsiderueshme (prej 10 %) të numrit të llojeve të faunës së egër në ZM, krahasuar me vitin e kaluar

Nga Censusi ndërkombëtar i shpendëve dimërues të ujit, të kryer në 3 zona, 2 prej të cilave në ZM dhe 1 në liqenin e HEC Vau i Dejës, kanë rezultuar 23,208 individ (RNM liqeni i Shkodrës 20,342, PUTM lumi Buna-Velipojë 1,665 dhe liqeni i HEC Vau Dejës 1,202 individ).

Gjatë vitit me masat e marra nga qeveria shqiptare sezoni turistik ka qënë i mbarë. Në shërbim të turistëve kanë funksionuar Qendrat e Informacionit Turistik në Theth dhe Velipoj, duke ofruar informacion rreth zonës, sygjerime dhe asistencë në raste të ndryshme

Në kuadrin e nismës së pyllëzimit gjatë vitit janë mbjellë 19,600 fidan të llojeve të ndryshme në territorin e ZM, por edhe jashtë saj Po kështu është punuar në mënyrë të vazhdueshme për pastrimin e territorit nga mbetjet, kjo edhe në kuadrin e nismës “Të pastrojmë Shqipërinë” dhe në zbatim të projekteve të ndryshme në zonat e mbrojtura

Janë zhvilluar workshop-e e trajnime (stafi gjatë vitit ka marrë pjesë në 4 trajnime me tematika të ndryshme, lidhur me kryerjen e veprimtarisë), në sallë dhe online (përmes paltformave elektronike).

Në Peisazhin Ujor Tokësor të Mbrojtur Lumi “Buna”-Velipojë, në funksion të planeve të menaxhimit, nga 4 shoqata dhe 4 individ (të shpallur fitues) po zbatohet projekti i MAVA-s me një vlerë prej 108 mijë Euro, fitues të të cilit

Gjatë viti janë hasur probleme, të cilat kanë ndikuar në veprimtarinë e AdZM (parandalimi i gjuetisë; kultivimi i bimëve narkotike; menaxhimi i zjarreve dhe aktiviteteve të paligjëshme; peshkimi i paligjshëm në ujërat e liqenit Shkodrës). Lidhur me ushtrimin e aktiviteteve të paligjëshme janë mbajtur 22 procesverbale konstatimi dhe 1 kundërvajtje penale, rast i referur në prokurori, për veprën penale “Ndotje të ujërave”

#### **IV.1.11. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**

Në zbatim të detyrimeve ligjore gjatë vitit është punuar për trajtimin, vlerësimin dhe regjistrimin e titujve të pronësisë, përfshi ato të përfituara nga legalizimi, si dhe trajtimin e problemeve të veçanta të dërguara për zgjidhje nga ASHK. Janë përpunuar 29,742 aplikime dhe shërbime kadastrale, 31,167 aplikime të bëra, Kështu;

- Janë përpunuar 975 praktika të mbartura nga vitit 2020
- Janë pëpunuar 3657 aplikime dhe shërbime kadastrale, për të cilat është lëshuar “Çertifikata e pronësisë” (për nr. pasurie)
- Janë evaduar me përgjigje 2,345 aplikime;
- Janë kualifikuar për legalizim 1,098 objekte;
- Janë emetuar 1,175 Vendime (77 Vendim marrje në zbatim të VKM; 126 ankesa të ardhura nga qytetarët, për vonesa në trajtimin e aplikimeve; 260 ankesa të referuara nga portali i bashkëqeverisjes, prej të cilave 230 ankesave dhe 30 janë në proces)

Në lidhje me procesin e legalizimit, janë evidentuar në terren 1,432 praktika; Është hartuar dokumentacioni tekniko-ligjor për 1,253 praktika objektsh në proces legalizimi; Janë nxjerrë 1,098 vendime legalizimi dhe 77 vendime 827/2020

Janë realizuar të ardhura me vlerë 253,459 mijë lekë (Nga shërbimet 116,079 mijë lekë; Tatim kalim pronësie 556 mijë lekë; Taksë kalim pronësie bashkisë 3,199 mijë lekë dhe Rivlerësim pasurie 133,625 mijë lekë

Ndërsa në lidhje me parcelat ndërtimore, janë arkëtuar të ardhura me vlerë 23,918 mijë lekë dhe janë kaluar fonde, për kompensimin e trojeve të ish pronarëve me vlerë 16,740 mijë lekë

Ndër problemet më të rëndësishme mbetet pamjaftueshmëria e ambienteve të punës, për zhvillimin normal të veprimtarisë, përfshi edhe kushtet e papërshtatshme (ambientet me sip. të vogla dhe me lagështi, në menyrë të veçantë për arkivin)

#### **IV.1.12. Arsimi**

Nga ana e bashkive janë marrë masat për përmirësimin e infrastrukturës së shkollave. Në bashkinë Shkodër për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë janë hapur puse shpimi në 35 shkolla; Janë realizuar e janë në proces punime rikonstruksioni dhe përmirësim i ambienteve dhe infrastrukturës në 11 objekte të shkollave (9 në bashkinë Shkodër dhe 2 në bashkinë Malësi e Madhe); Janë kryer punimet e mirëmbajtjes dhe lysterjes së objekteve të shkollave në të gjitha bashkitë (sistemim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme; lysterje e ambienteve të brendshme, sistemim e i rrjetit elektrik dhe atij hidraulike, pastrimi dhe heqja e barërave, si dhe riparimin e mobiljeve-karriga dhe banka)

Janë marrë masa për sigurimin e ngrohjes në shkolla (Ndryshimin e sistemit të ngrohjes; Furnizimin e shkollave me pajisjeve ngrohëse-soba, reflektor, bombola gazi, etj. dhe lëndë djegëse për ngrohje-dru zjarri, naftë, pelet, gaz të lëngshëm, energji elektrike). Për rritjen e sigurisë dhe garantimin e shëndetit të nxënësve dhe personelit mësimor është bërë zëvendësimi i ngrohjes me gaz (kjo për të gjitha shkollat) me sitem tjetër ngrohjeje (kaldajë, ose me soba me dru zjarri), kjo në të gjitha shkollat përveç 16 shkollave të bashkisë Shkodër, në të cilat duhet merren masa për zëvendësimin e ngrohjes me gaz

Nga ana e Zyrate Vendore Arsimore dhe bashkive janë marrë masat e duhura për

plotësimin e shkollave me personelin mësimor dhe mbështetës, dokumentacionin e domosdoshëm (përfshi edhe hartimin e planeve mësimore), si dhe ofrimin e shërbimit të pastrimit, furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm.

Po kështu janë marrë masa për kryerjen e shërbimit të transportit të nxënësve dhe mësuesve nga qendra e banimit në shkollat përkatëse (për rastet ku nuk janë lidhur kontrata me subjektete, munges ofertuesish, për kryerjen e shërbimit, përfituesve u kalohen shpenzimet e transportit në llogaritë e tyre personale në bankat e nivelit të dytë)

Janë marrë masat e nevojshme për garantimin e sigurisë në shkolla, përfshi edhe vendosjen dhe kryerjen e shërbimit me oficer sigurie. Nga ana e DVP janë hartuar e miratuar plane të veçanta masash për mbikëqyrjen e shkollave dhe ambienteve përreth gjatë orarit të zhvillimit të mësimin, përfshirë edhe shërbimin e disiplinimit të trafikut dhe qarkullimit të mjeteve në afërsi të shkollave me vëmendje të shtuar me fillimin dhe mbarimin e mësimin. Nga ana e bashkive në shërbim të krijimit dhe rritjes së kushteve të sigurisë janë instaluar pajisje të sigurisë dhe sinjalit.

Por megjithë punën e bërë, akoma ka probleme, të cilat ndikojnë në ecurinë normale të procesit mësimor;

- Mungesa e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, kjo kryesisht në shkollat e bashkisë Pukë e Fushë Arrëz, por edhe në disa shkolla të zonave malore të bashkive Shkodër, Malësi e Madhe e Vau i Dejës

- Mungesa e sinjalistikës rrugore (horizontale dhe vertikale) dhe kufizuesve të shpejtësisë në afërsi të disa shkollave

- Numri shumë i vogël i nxënësve, për zhvillimin e mësimin dhe pamundësia e transferimit në një shkollë tjetër (përqendrimi)

Janë krjuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimin nxënësve me aftësi ndryshe

Nuk ka nxënës, të cilët nuk frekuentojnë mësimin për shkak të fenomenit të gjakmarrjes

Gjatë vitit arsimor 2021-2022 janë regjistrua e frekuentojnë mësimin 25,530 nxënës, në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar (21,076 në arsimin publik dhe 4,454 në arsimin jo publik), nga të cilët në klasën e parë 1,945 nxënës (nga 1,915 nxënës që kanë qenë vitin e kaluara dhe nga 1,971 nxënës që kanë qenë vitin arsimor 2019-2020), me një diferencë më pak në total prej 1,234 nxënës, ose 4.6 %

Nga ana e Zyrave Vendore Arsimore, për të vlerësuar situatën, me synim sigurimin e një arsimit të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e kurrikulës në shkolla në funksion të rritjes dhe garantimit të cilësisë së arsimit dhe zbatimin e strategjive kombëtare, gjatë vitit ka kryer monitorime të institucioneve arsimore, për;

- Sigurimin e regjistrimit të gjithë nxënësve, sipas procedurave ligjore;
- Zbatimin, sipas standardeve të kerkuara, i kurrikulës në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar;

- Mësimdhënien nga mësues me arsimin e lartë sipas profilit që kërkon vendi i punës;

- Zhvillimi i mësimin në kushte me bashkëkohore;

- Planifikimin dhe shpërndarjen e librit shkollor falas

- Mirëmenaxhimin e procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të Maturës Shtetërore (Mbështetur në Udhëzimin e MARS Nr. 9, datë 09.04.2021 “Për zhvillimin e provimeve



*kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2020-2021” dhe Nr. 3, datë 08.02.2021 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të maturës shtetërore 2021”);*

- Zbatimin e detyrimeve ligjore në dobi të mirëfunksionimit të IA;
- Zbatimin e standardeve në shkolla qendra komunitare.
- Rritjen dhe mirëfunksionimi e shkollave Qendër Komunitare me gjithë kushtet, si një hap i rëndësishëm për partneritet të ri dhe orientimin e shkollës në realitet të ri të domosdoshëm
- Rritjen e numrit të shkollave “Bëjmë detyrat e shtëpisë në shkollë”, si një faktor i rëndësishëm për rritjen e cilësisë në arsim
- Krijimin dhe funksionimin e klasave sportive
- Menaxhimin e procesit të praktikës profesionale;
- Ngritjen dhe funksionimin e rrjeteve profesionale, duke bërë që mësuesit të zhvillohen profesionalisht nepermjet ndarjes së eksperiencave, apo zgjidhjes së problemeve të hasura gjatë zhvillimit të procesit mësimor;

- Rankimin e shkollave, sipas kartës së performancës;

Për eliminimin e parregullsive dhe gjetjeve të rezultuara nga monitorimi (probleme me element të disiplinës formale në punë; të disiplinës profesionale; dokumentacionin shkollor, etj.) janë dhënë rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilave është ndjekur në vazhdimësi:

Për kryerjen e veprimtarisë, sigurimin e zhvillimit normal të procesit mësimor, brenda standardeve të kërkuara, është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore, shoqata e organizata të ndryshme që operojnë në qark, si dhe komunitetin, bashkëpunim i cili mirë; Kështu është bashkëpunuar me,

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e infrastrukturës (Ndërtim, rikonstruksion, rrethim, mirëmbajtje e lyerje të ambienteve të shkollave, krijimin e ambienteve të pastra jo vetëm në ambientet e shkollave, por edhe oborreve të tyre, si dhe sigurimin e ngrohjes gjatë periudhës së dimrit); për funksionimin e grupeve multidisiplinare (duke bërë zgjidhjen e të gjitha rasteve specifike); Regjistrimin e të gjithë fëmijëve në shkollë, përfshi fëmijët në situatë ruge, etj.

- Drejtorinë Vendore të Policisë, për Zbatimin e Programit “Edukimi, ndergjegjesimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”; Koordinim dhe mbështetje mbi bazën e një plani veprimi kundër trafikimit të personave; Sigurimin e mbarëvajtjes së provimeve kombëtare; Sigurimin e rendit dhe qetesise ne ambientet përreth shkollave

- Institucionin e Prefektit, për Koordinimin ndërinstitutional mbi bazën e një plani veprimi kundër trafikimit të personave dhe ekstremizmit të dhunshëm; Marrjen e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore të njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore në krijimin e një infrastrukture të përshtatshme, sigurimin e ngrohjes, regjistrimin e fëmijëve dhe zhvillimin normal të procesit mësimor, brenda standardeve dhe kushteve të përcaktuara; Për përballimin e emergjencave civile në menaxhimin e situatave që krijohen nga temperaturat e ulta, përmbytjet, reshjet e dëborës, etj.

Nga ana e ZVA vemëndje i është kushtuar edhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të ndryshme të shtetasve, apo institucioneve të ndryshme (Ofrimin e shërbimit për legalizim dokumentacioni shkollor; sigurimin e vazhdimet të procesit mësimor për fëmijët, familjet e të të cilëve janë kthyer nga emigracioni; Sigurimin e aksesit për organizatat që operojnë në shkolla;

Sigurimin e cilësisë në IA jo publike; etj.)

#### **IV.1.13. Shërbimi Shëndetësor**

Veprimtaria e institucioneve shëndetësore për zbatimin e detyrimeve ligjore është ofrimi i shërbimit shëndetësor nëpërmjet kujdesit shëndetësor dhe spitalor

Veprimtaria e institucioneve shëndetësore në qark monitorohet në menyrë të vazhdueshme nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Shkodër (në përputhje me VKM Nr. 419, datë 04.07.2018 “*Për krijimin, menyrën e organizimit dhe të funksionimit të OSHKSH*” dhe Rregullores së brendshme “*Për menyrën e organizimit dhe funksionimit të OSHKSH*” - miratuar me Urdhrin Nr.18)

Gjatë vitit, krahas detyrave të tjera, veprimtaria ka qenë e përqendruar në zbatimin dhe respektimin e masave për parandalimin e përhapjes dhe përballimin e situatës së krijuar nga infeksioni SARS COV 2.

Marrja dhe përpunimi i të dhënave periodike ka bërë të mundur identifikimin e problemeve (Numri i përgjithshëm i mjekëve ka qenë i pamjaftueshëm dhe me një shpërndarje disi të pabarabartë, në raport me numrin e popullsisë; Mungesa e transportit për urgjencat mjekësore dhe e dhomave të pritjes me kushte normale në Q.Sh, si dhe mungesa e ujit të rrjedhshëm në disa ambulanca; etj.) dhe ndërhyrjet me masa konkrete për zgjidhjen e tyre

Megjithë vështirësitë dhe problemet e hasura, rezultatet e arritura në përmirësimin e nivelit të shërbimit shëndetësor (Identifikimin, minimizimin dhe zgjidhjen e situatave që shkaktohen në shëndetin publik), kanë qenë të mira, nga të gjitha institucionet shëndetësore, kjo falë edhe bashkëpunimit me të gjitha institucionet dhe njësitë e vetëqeverisje vendore

#### **IV.1.14. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër**

Gjatë vitit në funksion të kryerjes së detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, në zbatim edhe të masave anticovid, për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve,

- Aplikim online dhe pajisje me targë prove dhe rinovim, duke u pranuar kërkesa me konfirmimin e aktiviteteve të shitblerjes së mjeteve n regjistrin tregtar (Shqyrtimi i kerre aplikimeve bëhet në adresën elektronike të DPSHTRR;
- Aplikim online për pajisje me targa të veçanta dhe jashtë serie;
- Shërbime për porositjen e targave online, duke informuar publikun për targat e veçanta;
- Marrëveshja nga DPSHTRR, për shërbimin postar expres, për targat me zgjedhje;
- Aplikim online i kërkesës për të kryer një ndryshim konstruktin në mjet
- Zgjatja e orarit të kryerjes së shërbimit në sportele, për t’ju ardhur në ndihme qytetarëve;
- Procedurat për evidentimin e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë së mjetit me deklaram nga shitësi;
- Verifikim i mjeteve që aplikojnë për statusin dhe regjistrim RETRO nga komisioni vlerësues dhe grupi mbikëqyrës, të cilët kontrollojnë plotësimin e kriterëve dhe kushteve teknike RETRO;
- Shkurtimi i Kohës dhe marrjes së kartës së lejes së drejtimit, si në rastin e rinovimit, ashtu edhe për herë të parë

Për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve, janë afishuar në ambientet e Drejtorisë numrat e

telefonit dhe adresën elektronike dhe janë ngritur grupe pune të veçanta: Në kryerjen e veprimtarisë është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisje vendore, për identifikimin e targave të mjeteve dhe përcaktimin e pronarëve të këtyre mjeteve, për efekt të masave administrative (gjobave) të vendosura nga këto njësi, si dhe me të gjitha institucionet e tjera, bashkëpunim i cili ka qenë i mirë

#### **IV.1.15. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shteteror të Punes dhe Sherbimeve Shoqerore**

Nga ana e Drejtorisë Rajonale IShPShSh, për kryerjen e veprimtarisë dhe për çështje me objektiv të përbashkët, është bashkëpunuar me institucionet Rajonale Tatimore, Sigurimeve Shoqërore, Agjencësi Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Spitalin Rajonal, Drejtorinë Vendore të Policisë, etj.

Jane kryer 530 inspektime (me 1221 punëmarrës), nga të cilat;

- 445 inspektime të programuara;
- 36 inspektime rastësore;
- 18 inspektime, për aksidente;
- 16 inspektime, verifikim ankesa
- 15 inspektime, në kuadrin IPARD

Nga inspektimet e kryera ka rezultuar:

- Punëmarrës të padeklaruar (98 persona), të cilët janë futur menjëherë në skemen e sigurimeve shoqërore

Për shkeljet e legjisllacionit të punës, të gjetura nga inspektimet e kryera, janë marrë masa:

- Masa urgjente për marrëdhëniet e punës 33
- Masa urgjente për sigurinë dhe shëndetin në punë 12
- Paralajmërim për sanksione 7
- Vendosje gjobë 16
- Rekomandim për eliminimin e shkeljeve të vertetuara, lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë

Gjatë vitit janë shqyrtuar edhe 16 ankesa të ardhura nga portal i bashkëqeverijes, shumica e të cilave janë zgjidhur në favor të punëmarrësve

#### **IV.1.16. Dega Rajonale e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore (Ligji Nr. 10433 datë 16.11.2011 “Për inspektimin në RSh”; Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semuindjeve infektive”, me ndryshime; Nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”; Nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”; Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM Nr. 241, datë 27.03.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e ISHSH”; Aktit Normativ të KM Nr. 3, datë 15.03.2020; VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”; Urdhërave e Udhëzimeve për zbatimin e masave anticovid 19, përfshi edhe urdhërat e Prefektit; etj), arritjes së objektivave, për rritjen e sigurisë së produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjen e konsumatorit nga rrisqet dhe kërcënimet e mundshme dhe planeve të hartuara e miratuara, sipas çështjeve me tematikat, janë ushtruar 1,504 inspektime e

riinspektime në subjekte publike e private (Inspektime 1262, përfshi 5 inspektime jashtë planit; riinspektime 222 dhe 20 inspektime anti covid). Po kështu janë kryer 1,890 monitorime antiduhan Për gjetjet e konstatuara, janë marrë 14 masa administrative, nga të cilat;

- 2 gjoba me vlerë 60 mijë lekë;
- 2 masa urgjente, për mbyllje të përkohshme
- 9 paralajmërime

Gjatë vitit, në kuadër të masave parandaluese të përhapjes së infeksionit Covid-19, inspektimi/kontroli/monitorimi i zbatimit të masave anticovid, ka qenë ndër aktivitetet kryesore të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor; duke kryer

a. 113 inspektime (11 Institucion i Shërbimit Shëndetësor spitale, ambulanca, qendra shëndetësore; 36 Pika të shitjeve të produkteve ushqimore, Markete e Supermarkete, Dyqane mishi etj; 5 Furra buke/ Pasticeri; 1 Bar-kafe/Restorante/ Piceri/ Fast-Food; 10 Subjekte Arsimore; 3 Parukeri; 5 Zyra Pagesash-OSHE,UKT,Shërbim Postar,Telefoni celulare; 34 Shitje me pakice e produkteve të tjera jo ushqimore (shitje me pakicë e veshjeve, mjeteve shtëpiake,materiale ndërtimi,kancelari,librari)

b. 3,184 monitorime ( 21 Institucione të Shërbimit Shëndetësor-spitale, ambulanca, qendra shëndetësore; 480 Pika të shitjeve të produkteve ushqimore (Markete e Supermarkete; 113 Furra buke/ Pasticeri; 1569 Bar-kafe/Restorante/ Piceri/ Fast-Food; 57 Farmaci; 22 Klinika/ Laboratorë dentarë; 1 Subjekte argëtimi, qendra interneti, playstation, lojra për fëmijë; 16 Biznese: Fason/ Call-center/ Fabrika e linja prodhimi e përpunimi; 180 Subjekte arsimore; 47 Berberë,Parukeri; 3 Hotele; 65 Zyra Pagesash-OSHE,UKT,Shërbim Postar,Telefoni celulare; 571 Shitje me pakice e produkteve të tjera jo ushqimore-shitje me pakicë e veshjeve, mjeteve shtëpiake,materiale ndërtimi,kancelari,librari; 3 Subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm; 15 Shërbime të ndryshme-riparimicelularë,kompjuter,auto,gomisteri; 21 Institucione Publike)

c. 18,885 monitorme tek individët, të cilët janë këshilluar për vendosjen e barrierës mbrojtëse

Po kështu gjatë vitit janë kontaktuar 2, 575 persona, të rezultuar pozitiv, të cilat kanë rezultuar në banesë, duke zbatuar procedurat e karantinimit.

Për gjetjet nga inspektimet dhe monitorimet anticovid, janë marrë;

- 9 masa të ndërmjetme (Mbyllje të përkohëshme, mbyllje të pjesëshme
- 65 masa paralajmërim, për mos mbajtjen e barrierës mbrojtëse nga klientët në ambientet e mbyllura

Në bashkëpunim me AKU, duke u nisur nga problematika e funksionimit të tregut pranë sheshit Rus, që lidhet me tregtimin e produkteve ushqimore brenda dhe jashtë tregut, kushtet higjieno-sanitare dhe menaxhimin e mbeturinave përreth tij , është monitoruar gjendja në terren në orë të ndryshme të ditës dhe konstatoi se në ambjentet e përbashkëta brenda tregut nuk kishte të grumbulluara plehra apo mbeturina, si dhe në ambjentet e jashtme përreth tregut koshat e mbeturinave të vendosur nga Bashkia Shkodër nuk kishin grumbullim dhe depozitim të plehrave në vende që mund të bëhen shkak ose burim i shfaqjes apo përhapjes së sëmundjeve ngjitëse

Kërkesat e ardhura pranë ISHSH kanë të bëjnë më së shumti me kërkesat për tu pajisur me Akt-miratim Higjieno-sanitar. Shqyrtimi i tyre është realizuar brenda afateve kohore dhe janë

lëshuar në total 140 Akt-miratime për vitin. Inspektorati ka shqyrtuar edhe një kerkesë (denoncim) të ardhur nepërmjet portalit të bashkëqeverisjes, lidhur me mungesën e kushteve higjeno-sanitare në një klinikë mjekësore, nga shqyrtimi dhe verifikimi ka rezultuar se është e mbyllur që nga fillimi i pandemisë

ISHSH gjatë këtij vitit ka pasur bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë, për kontrollin e zbatimit të masave të veçanta, për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkatuar nga Covid-19. Konkretisht objekt kontrolli ka qënë mbajtja e barrierave mbrojtëse në ambiente të hapura dhe të mbyllura. Bashkëpunim ka pasur gjithashtu edhe me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Shkodër, në dhënien e informacionit në lidhje me veprimtarinë e Laboratorit mjekësor Serfa Faja

Për zbatimin e detyrimeve ligjore gjatë vitit është bashkëpunuar edhe me institucionet e tjera vendore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore

#### **IV.1.17. Drejtoria Rajonale e IKMT**

Në zbatim të detyrimeve ligjore Drejtoria Rajonale e IKMT gjatë vitit ka ushtruar 260 kontrole, inspektime dhe verifikim ankesa

- Sektori i Mjedisit dhe Ujrave 97 (90 planifikuar dhe 7 jashtë planit)
- Sektori i Inspektimit Pyjor 90 (në pyje e kullota 70, në subjekte 5 dhe të tjera 15)
- Sektori i Inspektimit të Territorit 73 (46 kontrole, 16 inspektime dhe 11 verifikim ankesa)

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka patur bashkëveprim me njësitë e vetëqeverisjes vendore në 74 raste dhe me Drejtorinë Vendore të Policisë në 14 raste

Për gjetjet e konstatuara gjatë kontrolleve të ushtruara është marrë 1 masë (për shkelje në menaxhimin e mbetjeve), si dhe janë sekuestruar 47 m<sup>3</sup> lëndë drusore

Në territorin e qarkut janë shfaqur vatra zjarri në 36 raste, duke përfshirë një sip. prej 2,517 Ha dhe djegur 175 Ha

#### **IV.1.18. Drejtoria Rajonale e FSDKSH**

Gjatë vitit ka ushtruar veprimtarinë mbështetur në ligjin 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në RSh”, me ndryshime, programeve e planeve të punës të miratuara, si dhe detyrave të dhëna nga Fondi

Në veprimtarinë e kryer gjatë vitit, me vëmedje të shtuar marrjen e masave anticovid 19, nuk janë hasur probleme

Janë analizuar dhe zgjidhur, duke iu kthyer përgjigje, kerkesë-ankesat e ndryshme

#### **IV.2. Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim**

Gjatë vitit janë evidentuar 1,999 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 1,753 prej tyre me 2,392 autor, ose rreth 87.6 %

Evidentimi dhe referimi në prokurori i veprave penale, si dhe zbulueshmëria e tyre për vitin 2021 e 2020, sipas të dhënave të Drejtorisë Vendore të Policisë, paraqitet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti	
			2021	2020
1	Vepra penale të evidentuara dhe të referuar në prokurori	Numër	1,999	1,754
2	Vepra penale për të cilat janë zbuluar autorët	“	1,753	1,627
3	Persona të implikuar,	“	2,392	2,015
	Nga të cilët			
	-U është privuar liria (arrestuar)	“	581	397
	-Janë ndaluar	“	152	122
	-Janë ndjekur në gjëndje të lirë	“	1,473	1,362
	-Janë shpallur në kërkim (janë larguar, apo i fshihen drejtësisë)	“	186	134

Gjatë vitit kanë ndodhur mesatarisht 5,47 vepra penale në ditë; ose 5.8 vepra penale për 1000 banorë. Në strukturën e veprave të evidentuara vendin e parë me 34 % e zënë veprat e hetuara nga seksioni për krimet në Komisaritin e Policisë Shkodër; vendin e dytë me rreth 21 % veprat penale në fushën e krimit ekonomik-financiar dhe vendin e tretë me 14 rreth 14% veprat penale në fushën e qarkullimit rrugor; etj.

Numri i veprave penale të evidentuara dhe të zbuluara gjatë viteve 2017-2021, paraqitet:

Nr.	Vepra penale	Viti				
		2017	2018	2019	2020	2021
1	Të evidentuara	2,306	2,292	2,081	1,754	1,999
2	Të zbuluara	2,019	2,050	1,889	1,627	1,753

Nga studimi i kriminalitetit gjatë viteve 2017-2021 rezulton se ka pësuar ulje nga viti në vit, për tu rritur në vitin 2021, ndërsa zbulueshmëria ka pësuar ulje, duke rënë në nivelin e pesë viteve më parë

- Është ulur kriminaliteti në masën 15.8 %;
- Është rritur shkalla e zbulueshmërisë së veprave penale 2 %;

Objektivi i Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit për vitin ka qenë rritja e standardeve për kontrollin kufitar, nepermjet aplikimit të praktikave më të mira për menaxhimin e integruar të kufirit, me synim garantimin e kufive të hapur e të sigurtë; Lëvizje të lirë të njerzëve por të kontrolluar; Lëvizje të mjeteve dhe mallrave; Përmirësim i shërbimit ndaj shtetasve; Këshillim, Sensibilizim të qytetarëve për rregullat e lëvizjes dhe qëndrimit në vendet e zonës Shëngen. Është punuar për krijimin e kushteve optimale të rendit e sigurisë publike për pushuesit vedas dhe të huaj gjatë në destinacionet turistike, në menyrë të veçantë gjatë sezonit veror, përfshirë edhe menaxhimin e hyrje/daljeve në kufi, me gjithë kufizimet që ka patur sezonit turistik veror 2021. Rëndësi i është kushtuar mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme me komunitetin, pushtetin vendor, si partner të ngushte të policisë së shtetit, agjencitë ligjzbatuese, në funksion të ofrimit të një shërbimi sa më cilësor dhe të shpejtë për komunitetin në zonat kufitare dhe rritjen e parametrave të sigurisë në kufi. Gjatë vitit janë organizuar dhe zhvilluar takime me Prefektin e qarkut, drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe administrator të Nj.A e kryetar fshatrash të zonave kufitare, lidhur me masat sensibilizuese e ndërjegjësuere në parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike. Po kështu është bashkëpunuar me organet doganore për përmirësimin e nivelit të shërbimit, orientimin e levizjes së sigurtë të turistëve, nga

hyrja deri në dalje të P.K.K-ve.

Gjatë veprimtarisë së ushtruar janë konstatuar probleme;

- Pozicioni gjeografik i territorit që mbulon DVKM, përgjithësisht terren i thyer, shumë i pyllëzuar, liqenor dhe lumor dhe me shumë drejtime të mundshme, terren që favorizon elementë me prirje për kryerjen e aktiviteteve kriminale nepermjet kufirit
- Afërsia e fshtrave në të dy anët e kufirit, lidhjet farefisnore ndërmjet banorëve të zonave kufitare; Papunësia e lartë tek banorët e zonave kufitare, me ndikim në rritjen e veprimeve të kundërligjshme, në menyrë të veçantë në fushën e kontrabandës, trafikimit të lëndëve narkotike, dhënien e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit të shtetasve nga vendet e treta, etj.
- Tendenca e shtetasve shqiptar, kryesisht të fëmijëve të mitur për të kërkuar azil në vendet e BE, kryesisht në Francë, Gjermani, Belgjikë dhe Angli

### **Rekomandime për përmirësimin e punës**

1. Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit mes të gjithë aktorëve, marrëdhëniet direkte me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor (Degët Territoriale), duke krijuar struktura (grupe ndërinstitucionale) të veçanta bashkëpunimi, për shërbimet e ndërsjella të policisë vendore, policisë bashkiake dhe institucioneve qendrore në nivel vendor (duke analizuar periodikisht nivelin e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura) për:

a. Kontrollin efektiv të territorit, me qellim parandalimin e;

- Ndërtimeve pa leje;
- Krimeve mjedisore (ndotja e mjedisit nga mbetjet, me vemendje të shtuar brigjet dhe shtratin e lumenjve, liqenin e Shkodrës dhe ato të HEC-ve, rrugët kombetare, destinacionet turistike; prerja e paligjshme dhe dëmtimi i pyjeve, etj);

- Kultivimit të bimëve narkotike si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të përdoruesve të tyre. Në luftën goditëse ndaj bimëve narkotike, parësore mbetet puna parandaluese në kultivimin e tyre dhe për të cilën duhet një mbikëqyrje e rreptë dhe e vazhdueshme në Menaxhimin e burimeve njerëzore, që merret me aktivitetin e paligjshëm të bimëve narkotike, sipas periudhave (Në periudhën përgatitore dhe kultivimit, që nga punimi dhe përgatitja e sipërfaqeve për mbjellje; lëvizja e farave dhe fidanëve e cila kryhet nga zonat urbane në ato rurale; tregtarët, transportuesit dhe personat e tjerë potencial për tu marrë me këtë aktivitet të paligjshëm) dhe njësitë administrative e fshatrave (Ato Nj. A, fshatra, zona dhe sipërfaqet të cilat janë të njohura për kultivimin apo mundësinë e kultivimit të bimëve narkotike);

- Ndotjes akustike, me vemendje të shtuar ndotjen nga zhurma e automjeteve (ndërhyrjet dhe modifikimi i mjeteve, përfshi edhe motorët, të cilët gjenerojnë zhurma tej normave të lejuara dhe të besdihme për qytetarët);

- Aksidenteve rrugore e disiplinimin e trafikut rrugor, nëpërmjet shërbimeve të përbashkëta të struktura të policisë me ato të institucioneve përgjegjëse e të njësitë të vetëqeverisjes vendore (vendosjen e sinjalistikës rrugore dhe përcaktimin e vendqendrimeve të mjeteve të transportit të udhëtarëve)

b. Evidentimin dhe goditjen e individëve/grupeve të ndryshëm, të cilët kryejnë aktivitetin kriminal të trafikimit të personave dhe shfrytëzimit të të miturve (për kryerje vepra

kriminale, punë të detyruar, lypje në rrugë, etj) me qëllim parandalimin e trafikimit të personave, me vemëndje të shtuar komunitetin rom e egjiptian, si dhe fëmijët e rrugës

c. Hartimin e planeve të përbashkëta operacionale dhe shkëmbimin e informacioneve të ndërsjella lidhur me:

- Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore dhe realizimin e mbrojtjes civile, për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës dhe të trashëgimisë kulturore e të mjedisit

- Zbatimin e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme (kulturore, sportive, etj), tubimeve, apo në raste festash kombëtare e lokale.

- Marrjen e masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik

2. Bashkëpunimi me institucionet arsimore (Zyrat Vendore të Arsimit, shkollat e sistemit parauniversitar dhe universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkoder) për parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike jo vetëm në ambientet e shkollave dhe universitetit, por edhe jashtë këtyre ambienteve nga nxënësit dhe studentët, si kontingjenti më i rishkuar.

3. Bashkëpunimi me institucionet e kultit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe organet e drejtësisë, për evidentimin e personave me tendencë terroriste, apo propaganduese e bashkëpunuese me strukturat e ISIS

#### **IV.3. Problemet e konstatuara nga analizat mujore të punës të institucioneve qendrore në nivel vendor**

Nga analizat e veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, janë konstatuar:

Problemet e pronësisë mbi tokën bujqësore, e cila veç të tjerave ka sjellë edhe pamundësinë e përfitimit të financimit të fermerëve, nga ana e buxhetit (subvencionimi në kultura bujqësore, ose lloje të gjësë së gjallë)

Menaxhimi i mbetjeve mbetet akoma problem dhe nje sfide vecanerisht per zonen periferike te qytetit Shkoder e Kopluk, perfshi njesite administrative Rrethina, Postribe, Ana e Malit, Guri Zi, Gruemirë, etj. Depozitimi i mbetjeve në vend depozitime të pamiratuara (ose të miratuara nga bashkitë) për bashkinë Malësi e Madhe, Pukë e Fushë Arrëz. Mosmiratimi i venddepozitimit të mbetjeve inerte, duke bërë që depozitimi i tyre në vende të ndryshme dhe kryesisht në brigjet dhe shtretërit e lumenjve të shkaktojë probleme jo vetëm ekologjike, por edhe përmbytje (Hedhja e mbeturinave përgjatë lumit “Kir”) në zonat periferike të qytetit Shkodër dhe fshatrave të Nj.A

Menaxhimi i situatave emergjente të krijuara nga reshjet e përmbytjet në periudhën e dimrit (në Nj.A dhe fshatrat e zonës nënshkodrës) dhe nga zjarret gjatë periudhës verës

Ushtrimi i veprimtarisë së paligjshme të gjuetisë (në territorin e ZM) dhe peshkimit (në ujërat e liqenit të Shkodrës)

#### **IV.4. Grupet ndërinstitucionale të punës (task-forcat)**

Prefekti i qarkut ka drejtuar grupet ndërinstitucionale (task forcen vendore), duke qenë pjesë përbërëse e tyre, për:

Koordinimin dhe bashkëveprimin efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre Institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit, si



dhe monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së strukturave dhe institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit

Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave

Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar “*Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2021*”

Ndjekjen dhe ecurinë e zbatimit të mekanizmave ligjor, për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor

Kontrollin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve, brenda territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Menaxhimin dhe përballimin e situatave emergjente në qark (përfshi pandemie, e shkaktuar nga COVI-19), sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje publike e private

#### **IV.4.1.Task Forca Vendore Antikanabis**

Në zbatim të Planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, me përfaqësues të Degëve Territoriale të të gjitha Institucioneve që janë të përfaqësuara në TFQ, si dhe përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore (mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit) është ngritur dhe funksionon Task Forca Vendore “Për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit”

Nga ana e Prefektit, në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive, në cilësinë edhe të drejtuesit të Task Forcës Vendore;

a. Është miratuar plani i veprimit “*Për koordinimin dhe bashkëveprimin efektiv të veprimtarisë së institucioneve rajonale vendore dhe të këtyre institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit gjatë vitit 2021*”, plan i cili është hartuar mbi bazën e planeve të institucioneve rajonale dhe njësive të vetëqeverisjes vendore (pjesë përbërëse e Task Forcës Vendore)

b. Në takimet me drejtuesit e Degëve Territoriale dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, janë trajtuar çështjet të cilat kanë të bëjnë me veprimet antikanabis (veçanërisht masat parandaluese) me objektivin e vetëm moskultivimit të kanabisit

c. Gjatë vitit veprimtaria është përqendruar kryesisht në koordinimin e veprimtarisë së institucioneve dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për zbatimin e plan veprimit antikanabis, si dhe realizimin e bashkëpunimit të të gjithë institucioneve ligjzbatuese për ndjekjen në dinamikë, marrjen e masave parandaluese

Nga Institucionet rajonale, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera të përfshira në Task Forcën Vendore, për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, lidhur me parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe pasojat e kësaj veprimtarie të kundërligjshme, janë organizuar takime të përbashkëta dhe të veçanta, gjatë gjithë vitit;

Gjatë vitit nga strukturat e policisë vendore dhe strukturat e tjera e njësitë e vetëqeverisjes vendore (pjesë e Task Forcës Vendore Antikanabis) nga 11,930 kontrolle (nga të cilat nga strukturat e policisë vendore 6,487 kontrolle), të ushtruara me 1,973 grupe (nga të cilat 1,320

grupe nga strukturat e policisë vendore) në të cilat janë angazhuar 7,664 punonjës (duke kryer 70,668 ore shërbimi) dhe 1,595 automjete, janë evidentuar 191 raste të kultivimit të 53,387 rrënjë bime narkotike në 506 parcela dhe 39 ambiente të mbyllura (795 fidan/kubik, si dhe 52,592 bimë në parcela), të dyshuara bimë narkotike-cannabis sativa, nga të cilat 26,070 rrënjë, ose 48.8 % i përkasin territorit të bashkisë Malësi e Madhe; 19,909 rrënjë, ose 37.3 % i përkasin territorit të bashkisë Shkoder; 3,741 rrënjë, ose 7 % i përkasin territorit të bashkisë Vau i Dejës; 3,322 rrënjë, ose 6.2 % i përkasin territorit të bashkisë Fushë Arrë dhe 345 rrënjë, ose 0.7 % i përkasin territorit të bashkisë Pukë, gjetje të cilat sipas Nj.A, në formë grafike paraqitet:





Për rastet e kultivimit të bimëve narkotike janë evidentuar 211 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 84, ose 40 %, në të cilën janë implikuar 156 autor

Për rastet e zbuluara janë proceduar penalisht (referuar në Prokurori), 186 persona, nga të cilët:

- 156 autor (arrestuar në kushtet e flagrancës 50 persona, ndaluar 33, ndiqen në gjendje të lirë 50 persona dhe 23 persona janë shpallur në kërkim);
- 30 persona për veprën penale “Shpërdorim detyre” dhe “Moskallëzim krimi” (parashikuar nga neni 248 e 300 i Kodit Penal)- 17 Kryetar fshatrash, 9 inspektor të shërbimit pyjor, 2 roje ujësjellësi dhe 2 elektrikist

Krahasuar me vitin e kaluar rezulton se gjatë këtij viti janë evidentuar më shumë 149 raste të kultivimit të bimëve narkotike (nga 42 në 191 raste), si dhe 45,245 rrënjë (nga 8,142 rrënjë në 53,387 rrënjë)

Numri i rasteve, parcelave dhe bimëve narkotike të gjetura dhe të asgjësuar gjatë viteve 2016-2021, në formë grafike paraqitet:



Nisur nga niveli i lartë riskut që paraqet qarku Shkodër, në kultivimin e bimëve narkotike, me qëllim kontrollin efikas të territorit (me një shtrirje të gjerë dhe shumë të vështirë), është kërkuar zgjidhja e problemeve të hasura gjatë viteve të kaluara (probleme që kanë qenë dhe janë bërë prezent në mënyrë të vazhdueshme), të cilat kanë ndikuar e ndikojnë veprimtarinë e monitorimit dhe kontrollit të territorit (Numri i vogël e i pamjaftueshëm i mjeteve me kalueshmëri të lartë dhe gjendja jo e mirë teknike e tyre, për shkak të amortizimit; Mungesa e mjeteve të tjera teknike- Dron, Dylbi, Kamera Termike, etj); duke mundësuar sigurimin e;

- 10 automjeteve me kalueshmëri të lartë, për plotësimin e nevojave në transportin e efektivave të policisë në zonat e vështira malore
- 4 dron, të cilët të përdoren me qëllim monitorimin/kontrollin e territorit, sidomos në zonat e thella malore, ku është e vështirë lëvizja e mjeteve dhe forcave.
- 10 copë GPS shtesë, të cilët të përdoren nga grupet e kontrollit të territorit.
- Veshjeve të përshtatshme, për punonjësit e policisë, për kontrollet e territorit
- 20 paketave të ndihmës së shpejtë, pjesë e të cilës të jetë “Antivipër”, për garantimin e jetës së punonjësve të policisë, gjatë kontrollit të territorit (nga pickimi i gjarpërinjve, apo insekteve të tjera helmuese)

#### **IV.4.2. Zbatimi i masave për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave**

Është hartuar e miratuar plani i veprimit të luftës kundër trafikimit të personave për vitin 2021, për qarkun Shkodër, si dhe programi (kalendari) i aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuëse në parandalimin e veprimtarisë kriminale të trafikimit të personave, që do të zhvillohen gjatë muajit Tetor - Muaji i luftës kundër trafikimit të personave

Janë zhvilluar takimet e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave (I krijuar me Urdhër Nr. 6, datë 26.01.2017, të Kryeministrit “Për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, në çdo Qark”) dhe Tryezës Teknike (të ngritur me Urdhër Nr. 11, datë 24.03.2017, të Prefektit/Kryetarit të Komitetit Rajonal), duke zbatuar protokollin e masave anticovid, takime të cilat janë organizuar në bashkëpunim me MB (Zyrën e Koordinatorit Kombëtar) dhe me UNICEF Albania, ku janë trajtuar; Gjetjet e fazës së parë për TQNj dhe përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit të UNICEF Albania; Përgatitja e planit të ri kombëtar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2021-2023 (Draft plani)

Nga ana e njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore, pjesë e KRLKTP, sipas planeve të miratuara, janë organizuar e zhvilluar gjatë gjithë vitit aktivitete sensibilizuese, ndërgjegjësuëse dhe informuese, lidhur me çështjet e trafikimit të personave dhe parandalimin e këtij fenomeni, përfshi edhe aktivitetet e muajit Tetor (i nominuar si muaji i luftës kundër trafikimit të personave), me sloganin “Është koha për të thënë mjaft-Trafikimit të personave!”, ku nga KRLKTP, Institucionet Vendore dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, duke respektuar protokollin e masave anticovid, janë zhvilluar:

Mbi 80 aktivitete sensibilizuese, ndërgjegjësuëse dhe informuese, lidhur me trafikimin e personave dhe parandalimin e këtij fenomeni (përfshi takimet e organizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Zyrrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik, Drejtoria Vendore e Policisë e Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Organizata e Shoqata të ndryshme, etj.);

- sesione informuese me komunitetin, nxënës, mësues, psikologë, etj.
- orë të hapura, edukative në shkolla;
- trajnime, tryeza të rrumbullakëta;
- shfaqje filma, dokumentar, video, etj. me subjekt rreth çështjeve të trafikimit të personave; emisione televizive në mediat lokale;
- javë solidariteti, në ndihmë të familjeve në vështirësi ekonomike;
- ekspozita me punime të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, ne te gjitha shkollat brenda territorit të qarkut, sipas njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ekspozita, me punimet më të mira, në hollin e ndërtesës së Institucionit të Prefektit në mbyllje të aktiviteteve të muajit Tetor, ku u shpërndanë Çertifikata vlerësimi për nxënës dhe shkolla

Gjate vitit janë evidentuar 4 raste si Viktima te Mundshme Trafikimi (nga strukturat e bashkisë Shkodër 2 të mitur dhe 2 nga DR e AKPA), si dhe ka vazhduar menaxhimi i 8 rasteve të identifikuara gjatë vitit të kaluar nga bashkia Shkodër, raste të cilat trajtohen në familje nën mbikqyrjen e Qendrave Komunitare “Për Familjen” dhe organizatës “Të ndryshëm, të barabartë”, duke ofruar shërbime të specializuara.

Nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë nuk janë identifikuar persona VT/VMT. Për 1

rast, shtetas i mitur, të evidentuar dhe raportuar nga policia greke, për të cilin matialet i janë referuar prokurorisë dhe është në hetim akoma.

Nga shërbimet e policisë kufitare dhe të migracionit janë kapur 377 persona në kufi, nga vendet në konflikt (për herë të parë 265 shtetas të huaj), nga të cilët 49 të mitur, 24 femra, persona të cilët janë dërguar e ridërguar në qendrën e azilkërkesve; Janë larguar vullnetarisht 373 shtetas të huaj (Pas nxjerrjes së urdhër largimit vullnetar). Janë dërguar në qendrën e mbyllur për të huajt 2 shtetas; Janë nxjerrë urdhër dëbimi, për 2 shtetas të huaj; Janë goditur 6 raste, shtetas shqiptar, për dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit të emigrantëve. Gjatë periudhës vazhdon lëvizja e emigrantëve nga vendet në konflikt me destinacion vendet e Europës Perëndimore, të cilët përdorin vëndin tonë si tranzit. Ju është refuzuar hyrja në territorin e vendit tonë 54 shtetasve të huaj. Ju është refuzuar dalja nëpërmjet PKK 120 shtetasve shqiptar, të cilët nuk kanë plotësuar kushtet ligjore, për të udhëtuar apo kanë shkelur rregullat e hyrjes e qëndrimit në vendet e BE.

Nga ana e Shërbimit Social Shtetëror janë bërë vlerësime social-ekonomike të minorenëve që ndodhen të pashoqëruar në emigracion Janë trajtuar me ndihmë ekonomike 4,354 familje në qark, nga të cilat: 407 familje me k/familjar gra, 7 familje me jetim .Nga skema e ndihmës ekonomike trajtohen 38 familje me shërbim kujdestarie dhe 44 viktima të dhunës.

Kanë përfituar nga skema e PAK 5,255 persona dhe kujdestari 1,409 persona, nga të cilët 64 persona të komunitetit rom dhe egjiptian.

Nga ana e shërbimit social, për familjet në vështirësi ekonomike dhe me probleme sociale janë shpërndarë 200 çanta shkollore dhe mjete shkollor, 80 pajisje ndihmëse për PAK; Lodra për 100 fëmijë; në bashkëpunim me Islamik Relief 300 pako ushqimore; Si dhe në bashkëpunim me The Door për 90 familje, dyshek e veshmbathje;

Për përballimin e situatës së krijuar nga situata Covid-19 janë mbështetur me paketa mbështetëse ( duke ofruar ndihma ushqimore, veshmbathje, paketa higjieno -anitare) nga Bashkia Shkodër 289 familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe familje me vështirësi social-ekonomike. Po kështu për vitin shkollor 2020-2021, janë mbështetur me çanta dhe materiale didaktike 256 fëmijë të familjeve në nevojë, ndërsa për vitin shkollor 2021-2022 janë mbështetur 160 fëmijë

Janë identifikuar dhe evidentuar nga bashkia Shkodër 60 raste të fëmijëve të rrugës,ndërsa nr total i rasteve të menaxhuara për këtë periudhë është 65, për të cilat së bashku me familjet janë: Hartuar planet e ndërhyrjes për integrimin; Mbështetur me ndihma ushqimore, veshmbathje e medikamente për fëmijët, të cilët kanë patur probleme shëndetësore; Mbështetur nga ana psiko-sociale, lehtësim dhe orientim për procedurat administrative, punësim, ndihmë ekonomike, etj. Numri i punëkërkesve të papunë të regjistruar ka qenë gjithsej 5,320 (femra 3,500), nga të cilët të komunitetit rom dhe egjiptian 201, jetim 8, emigrant të kthyer 28) Bashkia Shkodër tashmë ka të ngritur dhe funksionale një qendër ditore, që ofron shërbime me orar të zgjatur edhe në fund javë, për fëmijët e rasteve të dhunës në familje, VMT/VT. Me mbështetjen e Food Bank, është ngritur mensa në QKMF, pranë të cilës ofrohet një vakt i ngrohtë. Po kështu pranë QKMF ofrohen shërbime të higjenës dhe lavanderi për familjet dhe fëmijët në situatë rruge. Në bashkëpunim me Terre Des Hommes janë ofruar, për vitin shkollor 2020-2021, klasa mbështetëse për fëmijët e Qendrës Komunitare “Për familjen” Nr.5, ku bëjnë

pjesë edhe fëmijët e kampit rom tek Zalli i Kirit, klasa të cilat do të ofrohen edhe për vitin shkollor 2021-2022

#### **IV.4.3. Zbatimi i protokollit të masave anticovid**

Për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia SARS COV 2 dhe parandalimin e përhapjes, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore (Ligjit nr. ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; Akti Normativ të KM Nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit, të shkaktuar nga COVID-19”, me ndryshime, Vendimeve të KTE dhe Udhëzimeve të MSHMS, Prefekti i qarkut, gjatë vitit ka bashkëpunuar, koordinuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë e institucioneve vendore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjatë gjithë vitit, në mënyre periodike dhe sipas problemeve dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore janë organizuar takime me qëllim zbatimin e masave, duke u përqendruar në zbatimin e masave kufizuese

#### **IV.5. Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat**

Në zbatim të ligjit nr.45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, Ligjit nr.107/2016, “Për Prefektin, si dhe në vijim të detyrave të deleguara nga MM, dhe AKMC, gjatë vitit 2021, puna dhe veprimtaria e sektorit të PPECK është përqendruar në planifikimin e situatave të pritshme emergjente, parandalimin e tyre dhe organizimin e strukturave për reagim dhe kthimin normalitet të zonave që janë prekur nga fatkeqesite natyrore, sic ishin emergjencat dimerore, permbytjet dhe zjarret në pyje dhe kullota.

Jane organizuar gjatë vitit 2021, cdo muaj mbledhjet e KMC në nivel Qarku dhe janë ndjekur edhe mbledhjet e KMC të bashkive, sipas specifikave të tyre:

##### **a. Emergjencat dimerore dhe e permbytjes (20 Dhjetor 2020 - Mars 2021)**

###### **a.1. Problematikat dhe Demet**

- Sipërfaqja totale e përmbytur në nivel Qarku vlerësohet 8870 Ha
- Shtëpi të përmbytura, 53
- Shtëpi të rrethuara nga uji 321.
- Shtëpi me prezence uji në oborre, 541.
- Familje të evakuara, 27.
- Popullsia e prekur, kryesisht fermerë, rreth 4970
- Mbështetja me 1,062 pako ushqimore dhe me mbi 12,000 lit. ujë të pijshëm për familjet, shtëpitë e të cilave janë prekur nga përmbytjet (Në bashkinë Shkodër 455 familje; M.Madhe 200 familje; Vau i Dejës 400 familje dhe Fushë Arrëz 7 familje)
- Mbështetja me rreth 400 ton bazë ushqimore

###### **a.2. Mbështetja e Qeverisë Shqiptare**

- Mbështetja e Kryeministrit të Shqipërisë për të parë nga afër veprimtarinë e strukturave reaguese në fshatin Obot dhe në kaskaden e H/C-et. V.Dejës.
- Pjesëmarrja e Dr.AKMC, në operacionin për mbylljen e argjinaturës së Shirqit, dhe mbështetja me ndihma ushqimore të komunitetin dhe gjësë së gjallë për fermerët e zonave të përmbytura.

- Pjesmarrja dhe mbështetja e Ministrave të Mbrojtjes, Bujqësisë, etj në zoant e permbytjese

### **Mbi punën e Prefekti në rolin e Kryetarit të KMC,**

- Ka qenë prezent cdo ditë në terren, dhe ka kordinuar të gjitha agjensitë dhe strukturat në mbështetje të komunitetit.
- Ka bërë përpjekje maksimale institucionale për të gjetur burime dhe donator brenda vendit, krahas kërkesavë ndaj institucioneve përkatëse për garantimin e sigurimit të bazëz ushqimore për bagëtite dhe pakove ushqimore për komunitetin.
- Angazhimi, insistimi dhe bashkëpunimi me institucionet qendrore të Prefektit, bëri të mundur, nxitjen e faktorëve të tjerë të Qeverisë, për zbatimin e projektit për një kohë rekord në Lagjen Berdice, (Harku Berdice).
- Mbikqyrja e mbështetjes financiare të Qeverisë shqiptarë, ndaj bashkive për periudhen 2 mujore të përmbytjes.
- Mbështetja dhe inkurajimi I punës së strukturave të ushtrisë dhe FNSH, Shëndetësisë në të gjitha operacionet e evakuimit shpëtimit.
- Pas shumë përpjekjesh dhe peripecive si dhe kembenguljes e u be e mundur kalimi i dy segmenteve rrugore shumë problematike, sic ishte Boge-Q.Thore-Theth dhe Kelmendi, të cilat brenda këtij viti, kaluan në juridiksionin e Autoritetit Verior mbi bazen e VKM, nr.600

### **Konkluzione**

- Nuk pati dëme në njerëz dhe gjëne e gjallë, pamvarësisht situatës shumë të vështirë, në zonat e nënshkodrës dhe në ato malore nga izolimi i dëborës.
- Situata e rendit dhe sigurisë publike ka qenë në parametrat normal të qëndrueshëm, pasi nuk patëm asnjë ngjarje kriminale gjatë periudhës dy mujore.
- Menaxhimi i situatës së përmbytjes e konsiderojmë të suksesëshme, falë bashkëpunimit të strukturave të DVP, Ushtrisë, FNSH, DUK, Lezhe, në të gjitha fazat e saj, si dhe mbështetjes përmanente të qëndrueshme, nga strukturat qendrore të Qeverisë Shqiptare, MM, AKMC.
- Kordinim, miremenaxhim dhe bashkëpunim shumë profesional i të gjithë sistemit të kaskadës së KESH.
- Funksionimi i KMC në nivel Qarku, ka qenë shumë aktiv, takimet e përditshme në zyrë e alternuar me konstatimin në terren, komunikim i drejtëpërdrejtë me komunitetin në zonat e përmbytura.
- Plani Emergjencave i hartuar nga SECK, realizoi qelimin në të gjitha fazat, duke u konkretizuar në drejtimin dhe kordinimin e strukturave në të gjithë territorin e përgjegjësisë

### **Gjetje dhe Probleme**

- Mos respektim të niveleve të përgjegjësive nderinstitucionale dhe mos përcaktimi i Drejtuesit të Operacionit, për të cilën duhet të ketë një akt nenligjor (problem i shfaqur në Bashkinë Shkoder, në operacionin e organizuar për mbylljen e argjinaturës së Shirqit në Dajc).

- Sistemi Vrojtimit, monitorimit për parandalimin e problematikave në të gjithë sistemin e atrgjinaturave në disa raste nuk funksioni nga institucionet përgjegjëse.
  - Largesia dhe përqendrimi i strukturave logjistike të institucioneve rajonale, larg territorit të përgjegjësive nga institucionet perkatese, veshpireson shpejtesine reaguese.
  - U konstatuan probleme në kanalet e dyta dhe treta, pastrimin e kolektoreve sidomos në fushën e Dajcit, përgjegjësi e Bashkive.
  - Problem shqetësues është segmenti rrugor kryesor i Dajcit, për të cilin duhet projekt dhe nderhyrje e menjehershme, vecanerisht tek tombinot që janë projektuar në të gjithë këtë segment rrugor.
  - Pastrimi i Kanali Murtemzës, në NJA Velipojë, ngelet Detyre emergjente e Dr.U.K, Lezhë
  - Gërryerjet në Lumin Kir në Fshatin Bardhaj, Detyre emergjente për nderhyrje e Dr.U.K, Lezhë
  - Mosfunksionim i institucioneve sidomos, për kalimin e tyre nga regjimi normal i punës në situatë emergjente, detyrim ligjor i cili nuk mirëmenaxhohet, që nga Institucioni i Prefektit dhe institucionet e tjera, pasi koncepti i tyre është se këto detyrime janë vetëm të strukturave emergjente. Duhet të ligjërohet me një VKM, apo udhëzim të vecantë.
  - Nderhyrje për pastrimin e Perroit të Kufirit me Malin e Zi, në Doganën e Muriqanit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në përmbytjen e tokave në fushën e Muriqanit. Kërkohet zbatim i marrëveshjes nderqeveritare me Malin e Zi, dhe zbatimin e një projekti të përbashkët.
  - Pastrim i kanalit të kanalit të Hidrovorit në pjesën e grykëderdhjes së Vilunit në Velipojë.
  - Nuk kemi informacion paraprak për sasinë e niveleve të prurjeve të lumenjve në Liqenin Shkodres, burimet e brendshme të tij, prurjet e lumenjve Kir dhe Gjadër të cilët reflektohen në Lumenjt Bune dhe Drin.
  - Zbatim i kompetencave për informim të nderjellte nga niveli i Bashkise me Institucionin e Prefektit i cili duhet të jetë detyruar; **Duhet një akt nënligjor**
  - Kompensimi e dëmeve ngelet detyrim, sidomos për fermerët të cilëve u janë dëmtuar të mbjellat dhe bizneset në tokat e përmbytura.
  - U shfaqën probleme sidomos në marrjen, dorëzimin dhe shpërndarjen e ndihmave ushqimore për komunitetin dhe gjënë e gjallë për të cilat një udhëzim i vecantë, që përcakton procedurat dhe institucionet përgjegjëse, nga burimi i ardhjes deri në ekzekutimin e tyre tek familjet në nevojë; **Kërkohet Akt nënligjor**
  - Mbështetja e menjehershme me ushqime për gjënë e gjallë, kjo vecanerisht për bashkitë që tradicionalisht përmbyten, për të cilën duhet të ketë një rezervë shtetërore e cila të parakontraktohet, kryesisht për fermerët; **Kërkohet një akt nënligjor.**
- U evidentuan dhe u përcaktuan detyrat sipas përgjegjësisë institucionale për nderhyrjet emergjente, për:**
- DRUK, Lezhë, të ndërhyjë në krahun e djathtë të KK-5, në argjinaturen e Shirqit, detyre e lënë brenda Muajit Gusht të këtij viti.



- Bashkia Shkodër të pastroje dhe sistemoje kanalizimet dhe sipas standarteve, (sipas skemës së kullimit) ne rrugen kryesore dhe ne teresi ne NJA, Dajc. Brenda Muajit Gusht të ketij Viti.

- Marrja e masave nga Bashkia Shkoder per vlersimin e demeve gjate periudhes se permbytjes dhe dergimin e dokumentacionit ne Prefekturë

- Nga KB të rishikohen taksat e tarifave vendore për banorët e zonave të përmbytura, duke i përjashtuar nga detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore të përmbytura të cilat kanë qenë të kultivuara); Korigjimin e detyrimit për taksën mbi ndërtesat, për periudhën që familjet kanë qenë të larguara nga ndërtesat për shkak të situatës; Korigjimin e detyrimit të tarifës së pastrimit, për familjet e zonave të përmbytura. lehtësim detyrimesh për taksa e tarifa vendore

- Nga ana e Inst.Pref. gjykohet per propozim ne KM, mundësia e shpërnguljes të fshatrave të Nj.A Ana e Malit e Dajc që janë vazhdimisht në zonën e rriskut (Marrjes me qira nepermjet KESH Sh.A, apo shpronësim të tokave e shtëpive).

- Vijimi investimeve për mbrojtjen e lumit “Buna” jo vetem në periudha emergjencash, pasi rrit kostot e projekteve, dhe per rrjelloje keto nderhyrje ne situatë emergjente, nuk janë efektive dhe të qendrueshme.

- Nga DR.U.K, Lezhe (sipas informacionit të marrë) ne tre mujorit te fundit te vitit 2021, jane bere investime te konsiderueshme duke nderhyre ne te gjithë sistemin e argjinaturave te zones se nenshkodres, ne pastrimin e kanalete para, te cilat kane siguruar dhe ne nje mase te konsiderueshme do te parandalojne permbytjet e pritshme, njekohesisht edhe nga Bashkia Shkoder jane marre masa te mira per pastrimin e kanaleve ne juridiksionin e saj ne kete zone

Përsa i përket parandalimit të përmbytjeve, problem shqetesues ngelet hellja e inertëve në shtretërit e lumenjve, nga DRUK Lezhe (sipas informacionit të marrë), janë marre masa lidhur me problematikat e hasura per pastrimin e tyre ne disa raste, siç ishte heqja e materialeve te hedhura nga persona fizik, privat apo shtetëror, në shtratin e lumit Kir, për të cilat jane ngritur grupet e punes të cilët monitorojne në menyre të vazhdueshme. Problemi vijon të jetë shqetësues sidomos për Bashkinë Shkodër, meqenëse nuk ka vendgrumbullimin e inertëve në territorin e kesaj Bashkie.

#### **b. Zjarret ne Pyje dhe kullota.**

Nivel Qarku, janë shfaqur rreth 727 raste dhe vatra zjarri, nga të cilat;

- Bashkia Shkodër 430 raste zjarresh, nga të cilat 287 ndërhyrje shpëtimi;
- Bashkia Malësi e Madhe 162 raste zjarresh;
- Bashkia Vau Dejës 93 raste zjarresh;
- Bashkia Puke 28 raste zjarresh;
- Bashkia Fushe Arrëz 14 raste zjarresh;

- **Shkembimi i informacionit të saktë dhe në kohë reale**

- Sistemi vrojtimit, monitorimit dhe raportimit ne kohe reale ne disa raste ka qene problematike;

- Nuk jane shfrytezuar 100% kapacitetet dhe burimet njerezore ne nivel bashkie, strukturat vullnetare dhe angazhimi komunitetit.

- Strukturat e EC ne nivel drejtorie dhe sektori nuk kane funksionuar ne disa bashki;

- Problem kryesor është djegia e të mbjellave bujqesore nga vete feremret dhe pronaret dhe dalja jashtë kontrollit e vatres së zjarrit;
- Veprimtaria ligjzbatuese për parandalim apo ndeshkim të zjarrvnieve të qëllimshëm ngelet detyrë e pa realizuar nga të gjitha strukturat ligjzbatuese;
- Kontrolli paraprak dhe ndeshkimi subjekteve private dhe shtetërore që nuk zbatojnë rregullat e parandalimit dhe shuarjes së zjarreve në objektet shtetërore dhe private.

- **Shkembimi i informacionit të saktë dhe në kohë reale**

Nga Institucioni Prefektit të Qarkut Shkodër, është konsoliduar sistemi i lajmerimit të hershëm, menyra e komunikimit, raportimit dhe shkembimit të informacionit të ndërsjelltë me të gjithë institucionet e nivelit qendror dhe lokal, që janë të parashikuar në planin e gadishmerisë dhe në skemat përkatëse. Aktualisht me planet dhe masat konkrete të Sektorit të ECK është mbuluar i gjithë territori i përgjegjësive të Qarkut duke u informuar në kohë reale për çdo rast apo fenomen emergjent e cila transmetohet nepermjet tre grupeve WhatsApp nepermjet celularit të përgatitur nënkas për Sektorin e emergjencave dhe KMC

- c. **Masat për zbatimin e Ligjit dhe akteve nenligjore.**

- Vlen të theksohet se miratimi e një sasi të konsiderueshme të akteve nenligjore po e bën çdo ditë e më të zbatueshëm zbatimin e Ligjit për Mbrotjen Civile e njëkohësisht po ezauron shumë problematika institucionale që kanë zvarritur zbatimin e ushtrimit të përgjegjësive ligjore të institucioneve ligjzbatuese në kuadrin e miremenaxhimit të emergjencave. Siç është zbatimi VKM për e 4% dhe 8%, në bazë të projektbuxhetit të parashikuar nga çdo bashki.

- Mbetet për tu përcaktuar me VKM:

- Planifikimi, vlersimi i rrishtit në të gjitha nivelet, ngelet një detyrim ligjor i cili duhet të zbatohet sa më shpejt. Kërkoheht një akt apo model strukturor nga AKMC;

- Përsa i përket zbatimit të VKM, 655, për strukturën e funksionimit të Drejtorisë së EC, në nivel Bashkie, ka patur mangësi në mirëfunksionimin e drejtorive dhe sektorëve të EC në nivel Bashkie, mardhëniet ndërmjet tyre, detyrimet për informacion të ndërsjelltë, zbatimin e skemave të vrojtimit, lajmerimit, dhe të ndërhyrjes, në bashkitë Puke, F. Arrez nuk është struktura e plote sektori EC, ndërsa është e plote në bashkitë M.Madhe dhe V.Dejes;

- Mbetet detyrë që në prag të miratimit të projektbuxhetit të shikohet mirë planifikimi i 4 % dhe të ushtrohet trysni ndaj bashkive edhe për miratimin e strukturave duke e detyruar me shtyrjen e miratimit të buxhetit për vitin në vijim;

- Shpallja e fatkeqësisë natyrore, kriteret dhe procedurat e shpalljes për një zonë të caktuar, NJA, Bashki, N/Prefekturë, etj. Me daljen e VKM përkatëse është ezauruar edhe kjo problematika e cila është shfrytëzuar edhe politikisht në përmbajtjet e Janarit;

- Roli i N/Prefektëve për bashkëpunimin, monitorimin, mbikqyrjen, informimin periodik të institucionit të Prefektit për mbledhjet e KMC në nivel bashkie, është i mangët;

- Organizimi dhe funksionimi i KMCQ, mardhëniet me KMCB, në varësi të precipitimit të situatave, duhet të ketë akte nenligjore detyruese për zbatimin e tyre nga të gjitha nivelet e pushteteve dhe institucioneve;

- Kordinimi dhe bashkëpunimi, kontaktet me AKMC, Qendrën Kombëtare Operacionale të Mbrotjes Civile (QKOMC). Mbeshtetja konkrete nga MM, AKMC, për të mirëfunksionuar mekanizmat përkatës në miremenaxhimin duke respektuar përgjegjësitë ndër-institucionale të

bashkive/institucionet me Institucionin e Prefektit. Duhet të ketë një akt nënligjor;

- Roli i Keshillit të Qarkut në kuadrin e kordinatorit apo te anetarit te KMCQ

## **V. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**

Marrëdhënit e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshillin e qarkut dhe bashkitë), të përcaktuara edhe në Ligjin “Për Prefektin e qarkut” dhe “Për vetëqeverisjen vendore”, kanë qenë marrëdhënie konsultimi dhe bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Njesite e veteqeverisjes vendore, janë asistuar me ndihmën e nevojshme juridike në mënyrë qoftë verbalisht, apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet drejtuese në interpretimin dhe zbatimin akteve ligjore e nenligjore.

Është bashkëpunuar për ushtrimin e funksioneve të transferuara nga Ministrinë dhe Institucionet qendrore tek njësite e vetëqeverisjes vendore, duke mbikqyrur e monitoruar përdorimin e fondeve të transferuara nga buxheti (në formën e transfertës sektoriale) për kryerjen e ketyre funksioneve. Po kështu është bashkëpunuar mbi zbatimin e detyrimeve ligjone në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, përfshi edhe shërbimin e furnizimit me ujë të konsumatorëve dhe largimin e ujrave të ndotura

### **V.1. Kyerja e funksioneve të transferuara njësive të vetëqeverisjes vendore**

Në përmbushje të misionit dhe përgjegjësisve, mbështetur në Ligjin “Për Prefektin”, Vendimet e KM dhe Udhëzimeve në zbatim të tyre, është bashkërenduar puna me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) për ushtrimin nga ana e tyre, të funksioneve të transferuara nga institucionet qendrore, duke mbikqyrur dhe monitoruar fondet e transferuara (transferten e pakushtëzuar sektoriale) për kryerjen e ketyre funksioneve, për:

#### **1.1. Shërbimin e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin**

Gjatë vitit nga transferta e pakushtëzuar sektoriale, për kryerjen e shërbimit të MZSH, janë programuar fonde me vlerë 95,966 mijë lekë, ose 2,796 mijë lekë më shumë krahasuar me vitin e kaluar (në vitin 2020 janë programuar fonde me vlerë 93,170 mijë lekë)

Janë kryer shpenzime me vlerë 111,149 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 18,893 mijë lekë; Shkoder 46,897 mijë lekë; Vau i Dejës 16,486 mijë lekë; Pukë 15,578 mijë lekë dhe Fushë Arëz 13,295 mijë lekë), nga 137,347 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2021 dhe të trashëguara) ose 80.9 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 26,198 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2022

#### **1.2. Rrjetin e rrugëve rurale**

Gjatë vitit nga transferta e pakushtëzuar sektoriale, për menaxhimin e sistemit të rrugëve rurale, janë programuar fonde me vlerë 56,905 mijë lekë (në të njëjtën vlerë me vitin e kaluar 2020)

Janë kryer shpenzime me fondet nga transferta sektoriale me vlerë 54,393 mijë lekë

(Bashkia M.Madhe 12,788 mijë lekë; Shkoder 12,634 mijë lekë; Vau i Dejës 5,255 mijë lekë; Pukë 7,782 mijë lekë dhe Fushë Arëz 15,934 mijë lekë), nga 71,343 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2021 dhe të trashëguara) ose 76.2 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 16,950 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2022

### ***1.3. Pyjet dhe kullotat publike***

Gjatë vitit fondet e programuara nga transferta se pakushtëzuar sektoriale, për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, me vlerë 54,663 mijë lekë, ose 4,970 mijë lekë më shumë krahasuar me vitin e kaluar (në vitin 2020 janë programuar fonde me vlerë 49,693 mijë lekë)

Janë kryer shpenzime me vlerë 50,743 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 11,946 mijë lekë; Shkoder 11,070 mijë lekë; Vau i Dejës 5,926 mijë lekë; Pukë 11,353 mijë lekë dhe Fushë Arëz 10,448 mijë lekë), nga 65,632 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2021 dhe të trashëguara) ose 77.3 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 14,889 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2022

### ***1.4. Sistemin e ujitjes dhe kullimit***

Gjatë vitit fondet e programuara nga transferta e pakushtëzuar sektoriale, për kryerjen e shërbimit me vlerë 58,822 mijë lekë, ose 3,290 mijë lekë më shumë krahasuar me vitin e kaluar (në vitin 2020 janë programuar fonde me vlerë 45,532 mijë lekë)

Janë kryer shpenzime me vlerë 54,949 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 8,290 mijë lekë; Shkoder 30,464 mijë lekë; Vau i Dejës 12,383 mijë lekë; Pukë 868 mijë lekë dhe Fushë Arëz 2,944 mijë lekë), nga 75,979 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2021 dhe të trashëguara) ose 72.3 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 21,030 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2022

### ***1.5. Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, konviktet e arsimit parauniversitar***

Gjatë vitit fondet nga transferta e pakushtëzuar sektoriale, për sistemin e arsimit parauniversitar (bazë, mesem dhe konviktet e arsimit parauniversitar), janë rritur me 4,268 mijë lekë, ose 1 % krahasuar me vitin e kaluar (gjatë vitit nga transferta e pakushtëzuar sektoriale janë programuara 451,862 mijë lekë)

Janë kryer shpenzime me vlerë 451,974 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 59,900 mijë lekë; Shkoder 243,398 mijë lekë; Vau i Dejës 49,024 mijë lekë; Pukë 64,741 mijë lekë dhe Fushë Arëz 34,911 mijë lekë), nga 509,549 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2021 dhe të trashëguara) ose 88.7 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 57,575 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2022

### ***1.6. Mbrojtja sociale***

Gjatë vitit fondet e programuar për mbrojtjen sociale, nga transferta e pakushtëzuar sektoriale, janë në të njëjtën vlerë me vitin e kaluar (55,354 mijë lekë)

Janë kryer shpenzime me vlerë 49,206 mijë lekë (Bashkia Shkoder 35,862 mijë lekë dhe Bashkia Vau i Dejës 13,344 mijë lekë), nga 58,303 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2021 dhe të trashëguara) ose 84.4 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 9,097 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2022

Pasqyra, lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve për ushtrimin e funksioneve të transferuara (transfera sektoriale), përmbledhëse dhe sipas bashkive

**Përmbledhëse**

*Në mijë lekë*

Nr.	Bashkia	Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallar e shërbime		Transferime për buxhet. familjare e individ		Investime		Shuma	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	M.Madhe	89,782	87,945	15,150	14,846	21,272	7,881	3,992	1,145	0	0	130,196	111,817
2	Shkoder	250,456	227,085	43,375	38,392	121,374	75,331	40,307	37,029	2,500	2,488	458,012	380,325
3	Vau i Dejës	72,904	72,542	12,030	12,016	26,891	17,860	0	0	0	0	111,825	102,418
4	Pukë	75,610	72,848	12,479	12,241	21,151	11,084	859	834	10,826	3,315	120,925	100,322
5	Fushë Arrëz	70,347	58,236	11,736	9,986	14,819	9,017	293	293	0	0	97,195	77,532
	<b>Qarkut</b>	<b>559,099</b>	<b>518,656</b>	<b>94,770</b>	<b>87,481</b>	<b>205,507</b>	<b>121,173</b>	<b>45,451</b>	<b>39,301</b>	<b>13,326</b>	<b>4,543</b>	<b>918,153</b>	<b>772,414</b>

**1. Bashkia Malësi e Madhe**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxh familj. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Ujitja dhe kullimi Kullimit	1	4240	3,864	3,697	645	617	9,302	3,976	193	0			<b>14,004</b>	<b>8,290</b>
Administrimi i pyjeve	1	4260	8,700	8,700	1,453	1,453	3,553	1,584	435	209	0	0	<b>14,141</b>	<b>11,946</b>
Rrugë Rurale	1	4520	11,419	10,938	1,916	1,820	0	0	368	30	0	0	<b>13,703</b>	<b>12,788</b>
Arsimi bazë (përf. parash.)	1	9120	43,798	43,798	7,345	7,345	0	0	1,603	86	0	0	<b>52,746</b>	<b>51,229</b>
Arsimi mesëm, përfshi Konviktin)	1	9230	7,355	6,915	1,228	1,153	1,846	603	291	0	0	0	<b>10,720</b>	<b>8,671</b>
Shërbimi i MZSh-së	1	3280	14,646	13,897	2,563	2,458	6,571	1,718	1,102	820	0	0	<b>24,882</b>	<b>18,893</b>
<b>Totali</b>			<b>89,782</b>	<b>87,945</b>	<b>15,150</b>	<b>14,846</b>	<b>21,272</b>	<b>7,881</b>	<b>3,992</b>	<b>1,145</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>130,196</b>	<b>111,817</b>

## 2. Bashkia Shkodër

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet famil.ind. e të brendshme		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Ujitja dhe Kullimi	1	4240	12,146	8,563	2,222	1,499	23,542	20,372	31	30	0	0	37,941	30,464
Administrimi i pyjeve	1	4260	13,594	7,972	2,052	1,377	3,557	1,721	0	0	0	0	19,203	11,070
Rrugë rurale	1	4520	0	0	0	0	23,917	12,634	0	0	0	0	23,917	12,634
Arsimi bazë (parashkollor)	1	9120	152,556	151,759	25,361	25,182	0	0	1,184	949	0	0	179,101	177,890
Arsimi i mesëm (përgjith.)	1	9230	44,838	32,535	8,325	5,436	44,695	24,688	366	361	2,500	2,488	100,724	65,508
Mbrojtja sociale	1	10430	0	0	0	0	860	584	38,253	35,278	0	0	39,113	35,862
Shërb. i MZSh-së dhe MC	1	3280	27,322	26,256	5,415	4,898	24,803	15,332	473	411	0	0	58,013	46,897
<b>Totali</b>			<b>250,456</b>	<b>227,085</b>	<b>43,375</b>	<b>38,392</b>	<b>121,374</b>	<b>75,331</b>	<b>40,307</b>	<b>37,029</b>	<b>2,500</b>	<b>2,488</b>	<b>458,012</b>	<b>380,325</b>

## 3. Bashkia Vau i Dejës

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.familjar e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Ujitja dhe Kullimi	1	4240	3,083	3,083	504	504	8,796	8,796	0	0	0	0	12,383	12,383
Administrimi i pyjeve	1	4260	4,945	5,093	833	833	899	0	0	0	0	0	6,677	5,926
Rrugë rurale	1	4520	4,333	4,244	723	709	605	302	0	0	0	0	5,661	5,255
Arsimi bazë (parashkollor)	1	9120	32,782	32,782	5,462	5,462	0	0	0	0	0	0	38,244	38,244
Arsimi i mesëm (përgjith.)	1	9230	2,028	2,028	334	334	0	0	0	0	0	0	2,362	2,362
Arsimi (konviktet)	1	9240	7,521	7,219	1,199	1,199	0	0	0	0	0	0	8,720	8,418
Shërb. i MZSh-së dhe MC	1	3280	9,840	9,840	1,643	1,643	7,105	5,003	0	0	0	0	18,588	16,486
Mbrojtja sociale	1	10430	8,372	8,253	1,332	1,332	9,486	3,759	0	0	0	0	19,190	13,344
<b>Totali</b>			<b>72,904</b>	<b>72,542</b>	<b>12,030</b>	<b>12,016</b>	<b>26,891</b>	<b>17,860</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>111,825</b>	<b>102,418</b>

4. Bashkia Pukë

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.fam.e ind.		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Ujitja dhe Kullimi	1	4240	621	593	100	99	3,737	176	0	0	0	0	4,458	868
Administrimi i pyjeve	1	4260	8,532	8,219	1,393	1,370	2,600	876	60	60	1,179	828	13,764	11,353
Rrugët rurale	1	4520	4,806	4,806	936	936	1,183	1,055	0	0	3,469	985	10,394	7,782
Arsimi bazë (përfsh.parash.)	1	9120	36,858	34,941	5,998	5,829	2,711	2,491	74	74	2,662	1,032	48,303	44,371
Arsimi i mesëm (përgjith.)	1	9230	6,184	6,153	1,024	1,024	822	718	36	36	0	0	8,066	7,931
Arsimi (konvikti Pukë)	1	9240	7,760	7,409	1,204	1,204	7,814	3,664	43	43	500	119	17,321	12,439
Shërbimi i MZSh-së	1	3280	10,849	10,727	1,824	1,779	2,284	2,104	646	621	3,016	347	18,619	15,578
<b>Totali</b>			<b>75,610</b>	<b>72,848</b>	<b>12,479</b>	<b>12,241</b>	<b>21,151</b>	<b>11,084</b>	<b>859</b>	<b>834</b>	<b>10,826</b>	<b>2,055</b>	<b>120,925</b>	<b>100,322</b>

5. Bashia Fushë Arëz

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.familj. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Ujitja dhe Kullimi	1	4240	990	497	179	83	6,024	2,364					7,193	2,944
Administrimi i pyjeve	1	4260	8,775	8,464	1,441	1,373	1,631	611					11,847	10,448
Rrugët rurale	1	4520	11,403	10,781	2,494	1,839	3,620	3,163	151	151			17,668	15,934
Arsimi bazë (përf. parash.)	1	9120	33,306	25,440	4,970	4,634			142	142			38,418	30,216
Arsimi i mesëm	1	9230	4,071	4,019	753	676							4,824	4,695
Shërbimi i MZSh-së	1	3280	11,802	9,035	1,899	1,381	3,544	2,879					17,245	13,295
<b>Totali</b>			<b>70,347</b>	<b>58,236</b>	<b>11,736</b>	<b>9,986</b>	<b>14,819</b>	<b>9,017</b>	<b>293</b>	<b>293</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>97,195</b>	<b>77,532</b>

## **V.2. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistencë juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.**

Në mbështetje të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Prefekti i Qarkut gjatë vitit ka vazhduar konsultimin dhe bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta

### **Ligjshmëria e akteve normative të miratuara nga organet e njësive të qeverisjes vendore**

Pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, në sekretari-arkivin gjatë vitit 2021, nga 6 njësi të qeverisjes vendore- 5 bashki dhe njësi e dytë e qeverisjes vendore- Këshilli i Qarkut Shkodër, janë depozituar gjithsej 293 akte, nga të cilat normative 269 Në mbështetje të ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe akteve nënligjore specifike, për 234 akte normative Prefekti ka vlerësuar se kanë përputhshmëri ligjore referuar funksioneve vendore, ndërsa për 35 prej tyre nuk ka lejuar procedimin e mëtejshëm, duke bërë argumentimin ligjor. Janë rishqyrtuar 7 VKB.

Aktet normative janë shqyrtuar në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe Rregullave “Për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut” (miratuar me Urdhrin Nr.175, datë 09.07.2020, të Ministrisë të Brendshme)

Njësitë edhe gjatë këtij viti janë asistuar me ndihmë juridike verbale apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet e pushtetit vendor në interpretimin e ligjit për ti dhënë rrugë zhvillimit vendor & për të qenë sa më afër qytetarit në respekt të parimit të subsidiaritetit.

Spektori juridik gjatë vitit 2021 është ndeshur me vendimmarrje si buxhetet vendore të cilat paraqesin detyrim analizimin e elementeve buxhetore, si një dokument me karakter të plotë financiar dhe i rëndësishëm për gjithë territorin e bashkisë respektive.

Vendimeve të miratuara nga organi kolegjal me objekt rishpërndarjen e fondeve buxhetore, si kërkesë e ligjeve financiare është kërkuar respektimi i qartë i qëllimit dhe arsyeja e transferimit të këtyre fondeve në respekt të parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor, atij të transparencës, parashikueshmërisë, unitetit dhe universalitetit në menaxhimin e sistemit buxhetor, respektimit rigoroz të destinacionit të transfertave specifike, edhe pse jemi ndeshur hera herës me oponencë, veçanërisht në përdorimin e fondit rezervë/kontigjencë (fondi i kontigjencës, i cili ka një natyrë të veçantë përdorimi në buxhetin vjetor të këshillit të njësive të qeverisjes vendore, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave).

Vendimeve mbi përdorimin e fondit rezervë/kontigjencë & emergjencë, i cili sipas ligjit financiar duhet të jetë deri në tre përqind pjesë e buxheteve vendore, por praktikisht në buxhete miratohen në një përqindje të ulët, edhe pse bashkitë e qarkut çdo vit me situata natyrore të vështira.

Ka pasur një bashkëpunim ndër-institucional me Agjencinë e Basenit Drin Bunë sipas



ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i përditësuar

Nuk janë konfirmuar praktika të NJQV në rastet kur organi kolegjal nuk ka respektuar zhvillimin e seancave të këshillimit me publikun parashikuar në nenin 18 të ligjit nr.139/2015 dhe ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin & konsultimin publik”.

Praktikat e sjella nga NJQV për dhënie në përdorim të pronës publike, në mungesë të çertifikatës së pronësisë i është kërkuar për shqyrtim dhe analizim të mëtejshëm statusi juridik nga ASHK-ja, sipas *Kreut II, neni 4, pika 1/b e Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”*.

Në vëmendje ka qenë rregullimi i pasojave ligjore/financiare sipas afateve ligjore të përcaktuara në shkresën e Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil Tiranë nr.1764 prot datë 16.12.2019, proces i cili është ndjekur

Viti 2021 ishte vit zgjedhor, proces i cili e ngarkon Prefektin në rolin e koordinatorit, dhe punonjësit ndërlidhës për masat e marra para dhe gjatë procesit zgjedhor të datës 25 Prillit

Në zbatim të Udhëzimit, kryetarëve të bashkive i është kërkuar zyrtarisht sipas afateve ligjore respektimi i afateve ligjore duke bërë të mundur realizimin e tyre në kohë, garantimin e transparencës maksimale për qytetarët në hartimin, shpalljen dhe njoftimin e shtetasve, shpalljen e listës paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve dhe njoftimin e zgjedhësve brenda afateve të parashikuara në ligjin nr.10190, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH” i ndryshuar.

Detyra kryesore e Prefektit në zbatim të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”, i ndryshuar, nenit 94, ka qenë paraqitja pranë KQZ-së (si organ vendimarrës) listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut për vendet e numërimit të votave që përmbushin kushtet referuar nenit 93 pika 1 & 2 e Kodit Zgjedhor

### **Nga verifikimi në vend i akteve të Këshillave të njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore është konstatuar**

Sipas Urdhërit të Prefektit është kryer procesi i verifikimit në vend, nga i cili ka rezultuar se të gjitha NJQV (sekretari i organit kolegjal-personi përgjegjës) kanë depozituar të gjitha aktet me karakter normativ.

Janë kontrolluar edhe aktet e kryetarëve të bashkive, nëse ka pasur akte të karakterit normativ të cilat nuk janë depozituar në sekretari arkivin.

Është konstatuar se nga organet e bashkisë është përmirësuar puna dhe procesi i verifikimit në vend i ndihmon të gjitha palët për tu unifikuar dhe korrigjuar gabimet qoftë në terminologji, qoftë kur keqinterpretohen kompetencat ligjore, e cila mund të vijë për shkak se jo çdo akt është azhurnuar plotësisht.

Organit kolegjal i është theksuar forcimi për zhvillimin e seancave të këshillimit parashikuar në nenin 18 të ligjit nr.139/2015 dhe ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Këshillat bashkiak kanë rregulloret e reja për funksionimin dhe organizimin e tyre (të miratuara), rregullore që ndihmojnë në fuqizimin e tyre.

### **Proceset gjyqësore**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt 2.10.2016 “Për Prefektin”, ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, vazhdon të jetë pjesë e proceseve të iniciuara si pasojë e procesit të verifikimit në vend që nga viti 2016, seancë në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative Apelit Tiranë për Vendimin e Këshillit Komunal Gjegjan nr.39 dt 29.05.2015 “Për përdorim të fondit rezervë dhe kontigjencës me fond prej 486.000 lekë, me nr.663 prot dt 04.06.2015, për Vendimin e Këshillit Komunal Gjegjan Gjegjan nr.40 dt 29.05.2015 “Për përdorim të fondit rezervë dhe kontigjencës në shumën prej 130.000 lekë” me nr.668 prot dt 04.06.2015 si njësi administrative e bashkisë Pukë

### **V.3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor**

Është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre ligjore, si dhe rritjen e performancës së organeve të tyre. Njësitë të vetëqeverisjes vendore u është kërkuar zbatimi i detyrimit ligjor (neni 15 i Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”) për publikimin e akteve; U është rikujtuar detyrimi i përcaktuar në aktin nënligjor, për marrjen e Vendimeve, të trajtimit të familjeve me ndihme ekonomike, brenda muajit; U është rikujtuar marrja e vendimeve në kushtet e konfliktit të interesit; Është bashkëpunuar për ndarjen e detyrave, sipas kompetencave midis të zgjedhurve dhe të emëruarve, kjo në rastet e paqartësive; U janë kaluar për shqyrtim e vlerësim kërkesat dhe ankesat e qytetarë dhe subjekteve të ndryshme, brenda kompetencës tyre, pavarësisht institucionit që i është drejtuar.

Janë organizuar takime të shumta për: Menaxhimin e mbetjeve; Mbarëvajtjen e sezonit turistik; Situatën e rendit dhe qetësisë publike; Përballimin e situatave emergjente, përfshi zbatimin e protokollit të masave antocovid; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Çështjet e garantimit të sigurisë ushqimore; Përmirësimi i shërbimit shëndetësor, të furnizimit me energji elektrike e ujë të pijshëm; Krijimi i kushteve për zhvillimin normal të procesit mësimor, përfshi sigurimin e ngrohjes në shkolla

## **VI. FUNKSIONET E DELEGUARA, KRYERJA E VEPRIMTARISË NGA INSTITUCIONET TË CILAVE U JANË DELEGUAR FUNKSIONET NGA INSTITUCIONET QENDRORE**

### **VI.1. Shërbimet sociale**

Me fondet e buxhetit janë trajtuar nga skema e ndihmës ekonomike gjatë vitit 55,138 familje (mesatarisht 4,595 familje/muaj) familje me një vlerë prej 288,308 mijë lekë (mesatarisht 5,229 lekë/familje/muaj), nga 58,615 aplikues (mesatarisht 4,885 aplikues/muaj).Krahasuar me vitin e kaluar ka në rritje me 257 të numrit të aplikuesve, ose 0.4 % si dhe me 932 përfitues, ose 1.7 % Po kështu janë trajtuar nga skema e ndihmës me fondet e kushtëzuara të buxhetit për bashkitë (deri 6 %) 461 familje/muaj, me një vlerë mesatare mujore 3,603 lekë/familje. Krahasuar me vitin e kaluar është pakësuar me 18 numri

i familjeve të trajtuar nga bashkitë me fondet e kushtëzuara. Gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga COVID 19 është dyfishuar masa e ndihmës ekonomike për 4,734 familje. Me fondet e buxhetit për pagesë paaftësie janë trajtuar 11,200 persona (Persona me aftësi të kufizuar dhe kujdestar të tyre 6,672 dhe 4,528 invalidë të punës), ose 410 persona më pak krahasuar me vitin e kaluar. Kanë përfituar shpërblim, me rastin e festave të fundvitit 4,693 familje përfituese të ndih. ekonomike (përfshi 425 familje përfituese nga fondet e kushtëzuara 6%) dhe 5,447 persona me pagesë paaftësie

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, sipas planit të kontrollit të NE dhe PAK, janë kryer 19 kontrolle në njësitë administrative të bashkive, brenda territorit të qarkut (Në bashkinë M.Madhe 4, Shkoder 7, Vau i Dejës 5, Pukë 2 dhe Fushë Arrëz 1), ose 100 % e planit. Po kështu janë kryer 70 verifikime në familje, sipas planit të kontrolleve të miratuara ShSSH Tiranë, ose 49 verifikime më shumë se në vitin e kaluar. Nga kontrollet e verifikimet e ushtruara ka rezultuar një dëm ekonomik (Mungesë dokumentacioni në dosjet e përfituesve të NE, PAK dhe invalid pune; Mosrespektim i afatit 6-mujor të penalizmit; Mosçekin i personave përfitues të PAK/nvaliditet, trajtim në IEVP; Mënyra e administrimit të dokumentacionit të NE dhe Pak, nga zyrat e financës në bashki- Listpagesat e nënshkuara mbahen në bashki, duke krijuar vështirësi në kontroll, Hartimi i U.Shpënzimeve të përbashkëta për bashkinë Pukë, Fushë Arrëz, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe, Mungesa e akt marrëveshjeve me Postën Shqiptare, apo bankat e nivelit të dytë, për menyrën e levrimit të fondeve, kjo për bashkinëPukë, Fushë Arrëz, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe. Kryerja e vizitave në familje jo në përputhje me ligjin dhe mos hedhja në sistem, për reflektimin e ndryshimeve të konstatuara, Mungesa e informacionit të duhur nga administratorët shoqëror, lidhur me gjendjen reale të familjeve aplikuese; Pagesa të padrejta të PAK dhe invalid të punës, kryesisht të përfituesve për herë të parë, ose përfundojnë afatin e përfitimit) me vlerë 6,626 mijë lekë (Ndihma ekonomike dhe 6 % me vlerë 3,622 mijë lekë për 362 familje, Pagesa paaftësie 2,694 mijë lekë për 102 persona dhe pagesa invalid pune 310 mijë lekë për 45 persona)

Nisur nga gjetjet e konstatuara, janë lenë 59 rekomandim detyra (38 rekomandim shpërblim dëmi, 13 masa disiplinore dhe 8 masa administrative, gjobë)

Nga kontrollet e ushtruara rezultojnë me mangësi të mëdha Nj.A Shllak, Hajmel e Bushat të bashkisë Vau i Dejës; Gjegjan, bashkia Pukë; Shkrel, Kelmend e Qendër, të bashkisë Malësi e Madhe

Janë shqyrtuar, duke kthyer përgjigje 30 kerkesave të ardhura nga qytetar, nepërmjet platformës së bashkëqeverisjes, SHSSH dhe avokatit të popullit; Gjatë vitit janë regjistruar 174 ankesa zyrtare, me pak se në vitin e kaluar: Janë pritur në zyrë, duke i sqaruar në lidhje me shërbimet sociale 929 persona

Gjatë vitit janë kryer 42 monitorime për shërbimet sociale në qendrat/institucionet e përkujdesit rezidencial (40 në IPSh Publike dhe 2 në IPSh jopublike), si dhe 2 monitorime tematike (në IPSh jopublike), në përfundim të të cilave, mbi bazën e gjetjeve të rezultuara, janë lënë rekomandimet përkatëse

Me mbështetje e donatorëve të ndryshëm janë asistuar me pako ushqimore 253 familje në nevojë; Me dyshek e veshmbathje 97 familje; Me lodra me restin e festave të fundvitit 100 fëmijë të familjeve në nevojë; Me artikuj shkollor, me fillimin e vitit të ri shkollor, 200 fëmijë të familjeve në nevojë dhe 30 fëmijë të vendosur në familje kujdestare;

573 pajisje të ndryshme ndihmëse dhe mjete lëvizëse, për personat me aftësi ndryshe, kjo në bashkëpunim me shoqatën “The Door”, etj.

Në kryerjen e veprimtarisë gjatë vitit është bashkëpunuar me Shoqatën e para/tetraplegjikëve; DR të AKPA; ISHPSHSH; QOFPP; Me subjekte publike e jopublike; MD (Avokatin e ndihmës juridike falas); Shoqata të ndryshme të cilat zhvillojnë aktivitetit e tyre në qark

## **VI.2. Zhvillimi i territorit**

Për zhvillimin e territorit nga ana e Insitucionit të Prefektit janë ndjekur problem te ndryshme të territorit si strehimi, pronësie dhe mjedisi. Jane ndjekur dhe mbikqyrur nismat për të gjitha hapat e caktuara per hartimin e planeve të përgjithshme vendore për bashkitë e qarkut, duke rekomanduar bashkërendimin e punës në të gjitha etapat me qellim zbatimin sa më eficient të ketyre planeve, në përputhje me ligjin Nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zvillimin e teritorit*”. Janë ndjekur problemet në lidhje me distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës dhe lartësinë e ndërtesës, moszbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve të paligjshme nga ana e Inspektoriatit vendor të mbrojtjes së territorit, shqyrtimi i ndërtimeve pa leje, shtesat anësore dhe në lartësi, në lidhje me pagesën e këstëve për shlyrjen për pëfitimin e programeve sociale të strehimit dhe probleme me ndotjen e mjedistit nga lëndët djegëse, si rezultat i aktiviteteve tregtare. Janë shqyrtuar vendimet e organeve të njësisive të vetëqeverisjes vendore në fushën e ndërtimit dhe burimeve ujore

Është bërë konfirmimi i gen planeve të objekteve që privatizohen apo jepen me qera, objekte këto sipas Njesive Administrative të bashkive brenda territorit të qarkut

Është bashkëpunuar me agjensinë e Basenit Drin-Bunë për të gjitha problemet që janë paraqitur duke bërë verifikimin e problemeve sipas rasteve të paraqitura dhe përgatitjen e marrjen e masave per organizimin e 5 mbledhjeve të KBU Drin – Bunë

Është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke koordinuar edhe me institucionet vendore për menaxhimin e mbetjeve dhe krijimin e një mjedisi të pastër. Në menyre të vazhdueshme gjatë gjithë vitit, por me vemendje të shtuar përpara fillimit të sezonit turistik (Maj-Qershor) dhe në kuadrin e nismës së qeverisë shqiptare “Për një shqipëri të pastër” (Nëntor-Dhjetor), sipas planit të masave është bërë verifikimi i gjendjes së menaxhimit të mbetjeve; Identifikimi dhe përcaktimi i ndërhyrjeve emergjente; Hartimi i grafikut të pastrimit dhe largimit të mbetjeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; Koordinuar puna në terren për pastrimin e pjesëve të territorit dhe largimin e mbetjeve; Si dhe mbikqyrja dhe monitorimi i menaxhimit të mbetjeve nga grupi ndërinstitutional i monitorimit

## **VI.3. Zhvillimi i turizmit**

*Kontributin më të madh në rritjen ekonomike (bile mbi parashikimet e organizmave ndërkombëtar financiar e bankar), e ka patur sezoni turistik, i cili edhe në qarkun Shkoder, ka qenë i suksesshëm, sukses që ka ardhur falë masave të qeverisë për kryerjen e investimeve publike e lirimin e masave shtërnguese (masa të diktuar përparandalimin e përhapjessë Sars Cov 2), për shkak të përmirësimit të situatës, gjë që ka sjellë shtimin e numrit të turistëve gjatë sezonit.*

Objektivat e sezonit turistik veror 2021, megjithë problemet e hasura, në përgjithësi janë arritur; Krahasuar me sezonin e kaluar, ka patur rritje, duke iu kthyer trendit rritës të sezoneve para pandemisë, shkaktuar nga covid 19; Kështu gjatë sezonit është:

- Garantuar siguria publike në zonat turistike (Është ruajtur qetësia dhe rendi, janë parandaluar aktet kriminale, duke mos u evidentuar asnjë ngjarje kriminale; Është mirëmenaxhuar trafiku, duke garantuar sigurinë rrugore; Si rezultat i kontrolleve dhe masave të marra ka patur një menaxhim të mirë të mjeteve ujore, duke mos shënuar asnjë problem; Janë marrë masa parandaluese ndaj zhurmave, duke eliminuar ndotjen akustike dhe duke krijuar qetësi tek pushuesit; Ka patur një menaxhim më të mirë dhe përpunim të shpejtë të turistëve dhe mjeteve në Pikat e Kalimit Kufitar)

- Rritur numri i turistëve vendas dhe të huaj të cilët kanë vizituar dhe qëndruar si turist, sipas destinacioneve turistike në qark, për rrjedhojë janë rritur të ardhurat nga turizmi. Vetëm në zonat e mbrojtura, krahasuar me vitin e kaluar, numri i turistëve të huaj është rritur rreth 2 herë

Arritjet në zhvillimin e turizmit kanë ardhur nga përmirësimi i nivelit të bashkëpunimit dhe i veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor (duke veçuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e strukturave të policisë vendore) dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive për këtë sektor;

- Është përmirësuar shërbimi shëndetësor, duke plotësuar jo vetëm në numër qendrat shëndetësore me personelin e duhur, por duke qëndruar në gatishmëri e plotësuar të gjitha nevojat në zonat turistike;

- Është përmirësuar infrastruktura rrugore drejt zonave turistike, në mënyrë të veçantë rruga “Shkodër-Velipojë (segmenti Harku i Berdicës- Kryqëzim Baks)”, me përfundimin e një segmenti prej 0.8 km (nga loti I-rë prej 4.26 km), i cili kishte mbetur që nga vitit 2019, për shkak të shpronësimeve

- Nga ana e bashkisë Shkodër janë kryer investime, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore me një vlerë prej mbi 350,000 mijë lekë (Në sistemin e rrugëve të brendshme të qytetit, në zonën e plazhit dhe fshtrat e Nj.A Velipojë, Në pikën turistike Shirokë, Në Nj.A Ana e Malit që lidh vendin tone me Malin e Zi, si dhe Nj.A të tjera brenda territorit të bashkisë)

- Nga ana e FSHZH (me fondet e bankes boterore) janë kryer investime me një vlerë prej 736,303 mijë leke, në Rikonstruksionin e rruges Qafe Thore-Theth (Investim i filluar në vitin 2019 dhe i përfunduar 2021)

- Nga ana e ARRSH janë kryer ndërhyrje për rikonstruksione të pjesshme dhe mirëmbajtja e akseve rrugore me destinacion turizmin;

- Nga ana e policisë kufitare janë marrë të gjitha masat për të ofruar një shërbim të shpejtë në lëvizjen e shtetasve të huaj e shqiptar (hyrje e dalje) në pikat e kalimit kufitar (Muriqan, Hani i Hotit, Grabom dhe Vermosh) si dhe për përdorimin e mjeteve motorike lundruese argëtuese (Si rezultat i masave të marra nga shërbimet e policisë kufitare, në stacionet e plazhit, nuk ka patur asnjë incident nga mjetet lundruese argëtuese gjatë sezonit turistik);



- Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer inspektime dhe kontrole, lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore, në plotësimin e kushteve dhe standardeve ushqimore, si dhe mbrojtjes së konsumatorit;

- Nga ana e organeve tatimore janë marrë masa kundër informalitetit, goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga subjektet private në zonat turistike.

- Nga ana e Operatorit të shpërndarjes energjisë elektrike, nëpërmjet masave të marra është siguruar furnizim pa ndërprerje me energji elektrike gjatë gjithë sezonit;

- Nga ana e Sh. A “Ujësjellës-Kanalizime” me masat e marra është siguruar një furnizim normal me ujë të pijshëm për zonat turistike dhe në mënyrë të veçantë i plazhit Velipojë, ku gjatë gjithë sezonit ka një patur furnizim pandërprerje

Nga ana e Prefektit të qarkut, në cilësinë edhe të drejtuesit të KRZHT;

• Është ngritur Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, mbështetur në pikën 1 të nenit 20 të Ligjit Nr. 93/2015, datë 27.07.2015 “Për Turizmin” dhe Udhëzimin Nr. 8502 datë 24.10.2016 të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit” (pika 2.1, 2.2, 2.3 e kap. II), komitet i cili drejtohet nga Prefekti dhe ka në përbërje përfaqësuesit e institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore

• Është hartuar e miratuar plani i veprimit në nivel qarku “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2021” duke u mbështetur në planet e Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, përgjegjëse për zhvillimin e veprimtarisë turistike (Bashkitë; Agjencia Kombëtare e Bregdetit; Drejtoria Detare; Drejtoria Vendore e Policisë, Kufirit dhe Migracionit; Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor; Drejtoria Rajonale e AKU; Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe e Hetimit Tatimor Rajoni Verior; Drejtoria Rajonale e OSSHE, Sh.A; Ujësjellës Kanalizime Sh.A; Inspektoratet Shtetërore, etj.)

• Janë organizuar takimet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, në të cilën janë ftuar edhe të gjithë drejtuesit e Institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, takime në të cilat është analizuar e vlerësuar veprimtaria e Komitetit dhe Institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, masat e marra, problemet e hasura

• Nga ana e Prefektit të Qarkut në bashkëpunim dhe koordinim të veprimtarisë së institucioneve ligjzbatuese (Drejtoria Rajonale të IKMT Shkoder, bashkisë Vau i Dejës dhe policisë vendore) është bërë largimi i ndotësve të përhershëm të ujit të pijshëm (stalla, vendqendrimet të bagëtive) nga territori në afërsi të stacionit të pompave Trush, (nga ku furnizohen konsumatorët e Nj.A Velipojë, përfshi zonën e plazhit) një problem i pazgjidhur prej vitesh

• Është bërë hapja zyrtare e sezonit turistik (Në bashkinë Shkodër, në plazh Velipojë, pikën turistike të Thethit e Shirokës, si dhe në Nj.A. për promovimin e vlerave dhe resurseve, kryesisht në fushën e agroturizmit, të cilat ndikojnë në zhvillimin social ekonomik të këtyre njësive; Në bashkinë Malësi e Madhe në pikën turistike Razëm e Kelmend; Në bashkinë Vau i Dejës në Nj. A Vau i Dejës e Temal, në promovimin e vlerave në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit; Në bashkinë Pukë, organizimin e ditës së kulturës pukjane “Simfonia e Bjeshkëve”, për përcjelljen e traditave dhe vlerave të zonës, me ndikim në rritjen e numrit të turistëve, nisur edhe nga investimet e realizuara në qytet)

- Është publikuar kalendari i festave lokale dhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore
- Është ngritur grupi ndërinstitucional i punës me drejtuesit e përfaqësues të Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit (Urdhër i Prefektit Nr. 42, datë 19.05.2021), grup i cili ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e plan veprimit “*Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2021*”
  - Janë ngritur strukturat menaxhuese të dedikuara për sektorin e turizmit.
  - Në funksion të menaxhimit dhe mbarëvajtjes së sezonit turistik veror, zhvillimit të këtij sektori me peshë të konsiderueshme në rritjen ekonomike, janë organizuar takime të herëpashershme me drejtuesit e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për raste të konstatimit të problemeve, takime me drejtues të atyre institucioneve në të cilat janë shfaqur, për zgjidhjen e tyre
  - Është koordinuar nga Prefekti, veprimtaria e Bashkive, Institucioneve Shtetërore Rajonale, Agjencive dhe Inspektorateve për zbatimin e plan veprimit dhe detyrimeve ligjore, sipas fushave dhe përgjegjësi, për mbarëvajtjen e sezonit turistik;
  - Kanë funksionuar zyrat e informacionit turistik në Shkodër, Velipojë e Theth, duke i shërbyer si vizitorëve, ashtu edhe marketingut të destinacioneve turistike.
  - Është bërë promovimi i destinacioneve, ofertave turistike nëpërmjet organizimit të panairove dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe të traditës, sipas bashkive dhe njësive administrative të këtyre bashkive

#### ***Gjatë sezonit;***

Destinacionet turistike të qarkut janë frekuentuar, akomoduar e vizituar nga rreth 3 milion turistë të huaj e pushues vendas

- Nga pikat kufitare gjatë sezonit turistik kanë hyrë dhe dale (janë përpunuar në PKK) 1,888,872 shtetas dhe 632,959 mjete, ose 1,410,255 shtetas dhe 440,637 mjete më shumë krahasuar me sezonin e vitit të kaluara
- Është rritur numri i pushuesve të akomoduar në strukturat akomoduese-Resort, Hotel, Motel, Bujtinë, etj., për rrjedhojë edhe të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar
- Është rritur rreth 2 herë, numri i turistëve të huaj, të cilët kanë vizituar Zonat e Mbrojtura, krahasuar me vitin e kaluar (nga 192 mijë në 376 mijë)
- Numri i turistëve, të cilët vizituan kalanë “Rozafa” ka qenë rreth 46,000
- Është rritur numri i vizitorëve të cilët kanë vizituar muzetë e qytetit Shkodër, përfshi edhe Muzeu Kombëtar të Fotografisë “*Marubi*”, Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer 386 inspektime e kontrole në terren (restorante, fastfoode, furra buke) në zonat turistike, si dhe nga laboratorit për 72 mostra. Për parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara (Tregtim në kushte të pa pershtatshme higjieno-sanitare; Tregtim produkte me kalim të afatit të përdorimit; Mungesë e sistemit të gjurmueshmërisë së ushqimeve; Ushtrim aktiviteti pa u regjistruar në QKB; Problem me etiketimet e produkteve ushqimore; etj.) janë marrë 103 masa (Masë administrative-gjobë, 12 raste, Paralajmërim, për ndërprerje të aktivitetit, 86 raste bllokim produkti 4 raste, si dhe asgjësim produkti 1 rast)

Nga ana e organeve tatimore, sipas planit operacional të punës, janë marrë masa, për goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga

subjektet private në zonat turistike; si rezultat i të cilave janë aktivizuar me përgjegjesi tatimore TVSH 78 subjekte, rritur numri i të punësuarve me 479 persona dhe për rrjedhojë janë rritur të ardhurat gjatë sezonit turistik. Ndërsa nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren janë ushtruar 192 kontrolle, në përfundim të të cilave për parregullsitë dhe shkeljet e vërtetuara janë marrë masa të ndryshme, penalitete në 11 raste, si dhe 1 rast bllokim aktiviteti, për mos regjistrim në organet tatimore

Nga ana e Degës Rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor janë kryer 339 inspektimet dhe 64 riinspektime; 345 monitorime, për zbatimin e ligjit "Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e duhanit" dhe "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit"; si dhe 63 inspektime dhe 560 monitorime për parandalimin e përhapjes së covid-19; Në përfundim të të cilave për parregullsitë dhe shkeljet e vërtetuara, janë marrë 4 masa administrative (Gjobë në 2 raste me vlerë 60 mijë lekë dhe paralajmërim në 2 raste, për mosvendosjen e barrierës mbrojtëse nga klientët në ambientet e mbyllura-market)

Nga ana e Inspektoratit shtetëror të punës dhe shërbimeve shoqërore janë ushtruar kontrolle në 130 subjekte me 1,555 punëmarrës; Po kështu janë ushtruar inspektime/kontrolle në 24 subjekte ( në 5 subjekte, sipas kërkesë/ankesave, në 20 subjekte, inspektime rastësore dhe në 4 raste, për aksidente në punë). Nga kontrollet dhe inspektimet e ushtruara janë evidentuar 33 punëmarrës informal, të cilët janë përfshinë menjëherë në skemen e sigurimeve shoqërore. Për shkeljet e konstatuara gjatë kontrolleve dhe inspektimeve, janë marrë masa urgjente në 12 subjekte, si dhe masa administrative (gjobë) në 4 raste me vlerë 1,400 mijë lekë

**VI.3.a. Problemet e hasura gjatë këtij sezoni dhe koordinimi me aktorët e tjerë publik për sa i përket garantimit të sigurisë fizike të pushuesve, cilësisë së shërbimit, shëndetit publik, higjienës etj. të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në mbarëvajtjen e turizmit:**

- Masat kufizuese, shkaktuar nga pandemia Sars Cov 2
- Menaxhimi i mbetjeve, ku më problematike është ndotja e liqenit të HEC Koman, e cila krijohet nga grumbullimi i mbetjeve të lumenjve dhe nga mjetet e transportit ujqor, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e transportit në këtë liqen

- Gjendja e infrastrukturës rrugore drejt destinacioneve turistike, përfshirë segmentin Qafë Thore-Theth, i cili gjatë sezonit ka qenë në proces rikonstruksioni të plotë, çka ka krijuar probleme dhe vonesa dhe trafik në lëvizjen e turistëve drejt pikës turistike Theth, aq tërheqëse për turistët e huaj

- Administrimi dhe menaxhimi i territorit dhe hapësirave publike (zënia forcërisht dhe përdorimi në mënyrë të paligjshme i hapësirave publike, sipërfaqe të territorit të plazhit, nga subjekte dhe individë për qëllime biznesi dhe ndërhyrjet nga institucionet ligjzbatuese, gjatë sezonit, për kthimin e ligjshmërisë)

- Mos zbatimi i kritereve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit plazhit" (miratuar në VKM 171, datë 27.03.2019, me ndryshime), në stacionet e plazhit

- Lidhja me vonesë e kontratave për përdorimin e hapësirës publike nga ana e njësive vendore me subjektet që do të ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të plazhit. Nga të dhënat monitoruese ka rezultuar se gjatë sezonit, janë lidhur 63 kontrata me 57 subjektet private, për dhënie me qira të hapësirave publike (88 parcela me një sip. prej 73,647 m<sup>2</sup>), për ushtrim



veprimtarie të stacionit të plazhit,

- Mungesa e rojeve bregdetare (vrojtuesve të çertifikuar) dhe shërbimit të vrojtimit, kjo edhe si shkak i vonesave në nënshkrimin e marrveshjes së subjekteve të stacionit të plazhit me vrojtuesit, shoqëruar me çertifikatëpërkatësetëkualifikimit)

- Mospërputhja, mbi vendosja dhe diferenca e sip. të stacionit të plazhit në terren me sip sipas hartave (të propozuara nga bashkia dhe të miratuara nga Komiteti i Menaxhimit të SezonitTuristik), duke sjellë probleme në ndarjen në terren pas nënshkrimit të kontratave

- Ofrimi i standarteve në plazhet publike (sipas të dhënave gjatësezonit ka patur 105 stacione plazhi publik, nga 15 të planifikuara në fillim të sezonit), veçanërisht pjesa e kritereve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastruktura e plazhit publik (Tabelizimi i të gjitha hapsirave publike, Ngritja e pikave të vrojtimit dhe pajisja e hapsirave publike me vrojtues të certifikuar; Sigurimi i pastrimit të hapsirave publike; Pajisja e hapsiravepublike me shërbime higjienike; Markimi i zonës së notimit)

- Prezenca e shitësve ambulant në hapësirat në mes vijës ujore e stacioneve të plazhit

### **VI.3.b. Rekomandime**

- Rishikimi i Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë se stacionit të plazhit” (miratuar me VKM Nr. 171, me ndryshime), për;

- Eliminimin e mospërputhjeve të të dhënave të sipërfaqes sipas hartës, me ato në terren;

- Zvarritjet në dorëzimin e parcela, etj.;

- Përfshirjen në listën e plazheve të miratuara (Shtojca 1 e Rregullores) të plazhit Rrjoll, Nj.A Velipojë, bashkia Shkoder

- Garantimin e sigurisë së pushuesve në stacionet e plazhit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratave (për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e pare mjekësore) dhe shmangien e formalizmave (rishikimin e neni 5/8/b tërregullores),duke i ngarkuar kontraktimin e shërbimit të vrojtimit për të gjithë territorin e plazhit, autoritetit shtetëror (Institucioniqendror/njesisë së vetëqeverisjes vendore) kundrejt një tarife, të qiramarrësit të hapësirës publike për ushtrimin e aktivitetit të stacionit të plazhit (sipas sip. së çdo stacioni)

- Monitorimi dhe ndërhyrjet, për paligjshmërinë e veprimeve të kryera nga persona/subjekte, në zonën bregdetare, të përfundojnë përpara fillimit të sezonit turistik veror 2022, kjo për të shmangur ndërhyrjet gjatë sezonit me ndikim negativ në zhvillimin e turizmit

- Procedura e aplikimit online, për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit për sezonin turistik veror 2022, të përfundojë brenda muajit Shkurt, duke eliminuar vonesat në lidhjen e kontratave-përfundimin e procedurës së lidhjes kontratave brenda muajit Mars (në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 4/4 të Rregullores)

### **VI.4. Shërbimi i gjendjes civile**

Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile ka grumbulluar, administruar dhe kontrolluar aktet e gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje) të mbajtura nga zyrat e gjendjes civile të bashkive dhe NjA pjesë përbërëse e bashkive, mbështetur në Ligjin Nr. 10129, dt 11.05.2009 “Për gjendjen Civile”, me ndryshime (neni 32 “Administrimi dokumentacionit”), për cilat është dokumentuar dorëzimi (me procesverbal), duke dhe kryer lidhjet e këtyre akteve.

Janë lëshuar çertifikata përkatëse (sipas kërkesave të shtetasve apo institucioneve të

ndryshme), të gjëndjes civile, për dokumentacionin që administron vetë zyra, duke u bazuar në rregjistrat themeltarë si dhe në aktet e tjera

Është ndjekur zbatimi i vendimeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, bazuar në Ligjin “Për Gjendjen Civile” dhe Udhëzimin Nr.481, dt 05.09.2013 “Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si gabim material”, nga zyrat e Gjendjes Civile të bashkive dhe njësive administrative pjesë përbërëse e ketyre bashkive, duke bërë verifikimet në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

U është kthyer përgjigje, me informacionin e kërkuar, brenda afatit, kërkesave të Institucioneve të ndryshme

Është bashkëpunuar me zyrat e Gjendjes Civile të njësive të vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave në shqyrtimin e kërkesave, për gabimet në regjistra dhe korrigjimin e tyre

U janë bërë të njohura zyrave të gjendjes civile brenda qarkut, ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore”Për gjendjen Civile”

## **VII. ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS**

### **VII.1. Organizimi dhe shpenzimet e kryera për zhvillimin e veprimtarisë**

Administrata e Prefektit është e organizuar dhe funksionon, sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri (Urdhër Nr. 11 dt. 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër”), me një organikë prej 27 punonjësish:

1.	Prefekt	1
1.1	Sekretar i Prefektit	1
2.	Sekretari i përgjithshëm	1
3.	Nënprefekt (Malësi e Madhe dhe Pukë)	2
4.	Spektori i monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara	6
5.	Spektori i zhvillimit urban	3
6.	Spektori i planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave	3
7.	Spektori juridik	3
8.	Spektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	7

Në fakt administrata ka funksionuar me 2 punonjës më pak (Në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, si dhe në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse), pasi pozicionet e punës kanë mbetur dhe janë vakant, për arsye të moskryerjes së procedurave të konkurrimit dhe emërimit të punonjësve në keto pozicione

Për zhvillimin e veprimtarisë, nga ana e Institucionit, janë kryer shpenzime me vlerë 30,728 mijë lekë, ose 89.7 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim fondesh prej 3,511 mijë lekë. Ndërsa nga zyra e gjendjes civile janë kryer shpenzime me vlerë 2,906 mijë lekë, ose 99.2 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 23 mijë lekë.

Programimi dhe përdorimi i fondeve, sipas programeve, në nivel art. Paraqitet:

Në mijë lekë

Art.	N/art	Emertimi i shpenzimeve	Programimi dhe përdorimi		
			Plani me ndryshime	Fakti	Dif.
<b>Totali i shpenzimeve Administrata e Prefektit dhe Gjendja civile</b>			<b>37,168</b>	<b>33,634</b>	<b>3,534</b>
<b>Administrata e Institucionit (Gr.16, T 1160, Kap.1)</b>					
600		<b>Paga, shperblime dhe te tjera shpenz. personeli</b>	<b>22,656</b>	<b>20,890</b>	<b>1,766</b>
601		<b>Kontribut per sigurime shoqerore dhe shendetesore</b>	<b>3,578</b>	<b>3,445</b>	<b>133</b>
602		<b>Mallra dhe sherbime te tjera</b>	<b>6,782</b>	<b>5,372</b>	<b>1,410</b>
	<b>6020</b>	<b>Materiale dhe sherbime zyre te pergjithshme</b>	<b>1,050</b>	<b>970</b>	<b>80</b>
	100	Kancelari e tjera	250	240	
	200	Mat. për pastrim,dizifek.,ngrohje dhe ndriçim	200	199	
	300	Materiale për funksionimin e zyreve	400	338	
	500	Blerje dokumentacioni	100	98	
	900	Furnizim dhe materiale të tjera zyre e të përgjithshme	100	95	
	<b>6021</b>	<b>Materiale dhe shërbime speciale</b>	<b>100</b>	<b>99</b>	<b>1</b>
	1099	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	100	99	
	<b>6022</b>	<b>Sherbime nga te tretet</b>	<b>1,850</b>	<b>1,483</b>	<b>367</b>
	2001	Elektricitet	614	380	
	2002	Uje	1	1	
	2003	Sherbime telefonike:	210	159	
		<i>Fikse</i>			
		<i>Celulari</i>			
	2004	Posta dhe shërbim korrier	200	134	
	2008	Sherbime të sigurimit dhe ruajtjes	675	675	
	2010	Sherbime të printimit dhe publikimit	90	76	
	2099	Shërbime të tjera	60	57	
	<b>6023</b>	<b>Shpenzime transporti</b>	<b>980</b>	<b>931</b>	<b>49</b>
	3100	Karburanti	790	787	
	3200	Pjese kembimi , goma dhe bateri	50	46	
	3300	Rregjistrim,kalaudim ,siguracion	100	61	
	3900	Te tjera	40	37	
	<b>6024</b>	<b>Shpenzime udhetimi</b>	<b>400</b>	<b>270</b>	<b>130</b>
	4100	Udhetim i brendshem	400	270	
	4200	Udhëtim jashtë vendit	0	0	
	<b>6025</b>	<b>Shpenzime per mirmbajtje te zakonshme</b>	<b>2,040</b>	<b>1,425</b>	<b>615</b>

	5300	Shpenzime per mirmbajtjen e objekteve ndertimore	1,000	470	
	5500	Shpenzime për mirëmbajtje aparateve,pajisje e veg punës	940	858	
	5600	Shpenzime per mirmbajtjen e mjeteve te tansportit	100	98	
	<b>6026</b>	<b>Shpenzime per qiramarrje</b>	<b>100</b>	<b>0</b>	<b>100</b>
	6100	Shpenz. Për qiramarrje ambiente			
	6900	Shpenzime të tjera qiraje	100	0	
	<b>6027</b>	<b>Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>12</b>
	7900	Shpenzime për detyrime të tjera	12	0	
	<b>6029</b>	<b>Shpenzime te tjera operative</b>	<b>250</b>	<b>195</b>	<b>55</b>
	9001	Shpenzime per pritje percjellje	100	95	
	9003	Shpenzime gjyqësore	50	0	
	9008	Shpenzime per tatime,taksa,rregjis. pasurie nga inst. etj.	100	100	
<b>606</b>		<b>Transferta per buxhete familjare dhe individë</b>	<b>223</b>	<b>183</b>	<b>40</b>
<b>231</b>		<b>Shpenzime per rritjen e A.Q. Te trupzuara</b>	<b>1,000</b>	<b>838</b>	<b>162</b>
		<b>Shuma:</b>	<b>34,239</b>	<b>30,728</b>	<b>3,511</b>

**Gjendja Civile (Gr.16, T 1170, Kap. 1)**

<b>600</b>		Paga, shperblime dhe te tjera shpenz. personeli	2,500	2,490	10
<b>601</b>		Kontribut per sigurime shoqerore dhe shendetesore	429	416	13
<b>602</b>		Mallra dhe sherbime te tjera	0	0	0
		<b>Shuma</b>	<b>2,929</b>	<b>2,900</b>	<b>23</b>

**VII.2. Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre**

Për bashkërendimin e veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe me njësitë e vetëqeverisje vendore dhe realizimin e detyrave nga administrata e Institucionit nga Prefekti janë nxjerrë 68 Urdhra, me problematika të ndyshme, të cilat janë zbatuar, sipas afateve të përcaktuara

Administrata ka zbatuar në të gjitha rastet urdhërat e nxjerrë, duke siguruar në këtë mënyrë efektivitetin e tyre.

**VII.3. Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë**

**Veprimtaria e organit këshillues të prefektit të qarkut në zbatim të nenit 23 të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”**

Në funksion të kryerjes veprimtarisë dhe ushtrimit të përgjegjësive nga ana e prefektit janë zhvilluar mbi 60 takime (pa përfshirë takimet online, të cilat janë zhvilluar në zbatim të masave anticovid), takime të cilat në formë të përmbledhur, sipas çeshtjeve të trajtuara,

paraqiten:

- Analizat e veprimtarisë vjetore 2020 dhe 6/mujore 2021 të Institucionit
- Mbi problematikat në kuadër të luftës kundër kultivimit të bimëve narkotike, Zbatimi i Planit Kombëtar të veprimit antikanabis për Qarkun Shkoder (Takime periodike të Prefektit me drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore si dhe takime sensibilizuese në njësitë e vetëqeverisjes vendore)
- Mbi çështjet e luftës kundër trafikimit të personave (3 Takime periodike të Komitetit Rajonal të luftës kundër trafikimit të Personave dhe të Tryezës Teknike), takime të cilat janë organizuar në bashkëpunim me MB (Zyrën e Koordinatorit Kombëtar) dhe me UNICEF Albania. Prefekti në bashkëpunim me MB dhe organizatat partnere si dhe me mbështetjen e UNICEF ka zhvilluar takim sensibilizues dhe ndergjegjesues për parandalimin e trafikimit të personave datë 25 Tetor; KRLKTP në bashkëpunim me institucionet arsimore, Institucionet dhe njësitë e vetëqeverisjes dhe me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile kanë zhvilluar aktivitetin përmbysës marshim të nxenesve të shkollave të arsimit parauniversitar publik e jopublik përgjatë pedonaleve të qytetit Shkoder si dhe ekspozitën me punimet e nxenesve rreth temës së antitrafikimit (29 Tetor)
- Mbi masat për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik 5 takime (Takim i Komitetit Rajonal të Turizmit, evidentimi i masave të marra nga të gjithë Institucionet për fillimin, mbarëvajtjen e sezonit turistik dhe zhvillimin e turizmit gjatë vitit 2021; Ngritjen e grupit të punës për monitorimin e zbatimit të planit të masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik; Takim datë 03.06 në pikën turistike Theth, lidhur me përgatitjet për fillimin e sezonit turistik; Takim datë 24.06 në Vermosh, lidhur me zhvillimin e turizmit malor, në përfundim të të cilit u eksplorua shtegu e shënjuar nga vetë banorët, si një mundësi më shumë për promovimin e shtegjeve të Kelmendit;
- Takim mbi bashkëpunimin ndër-institucional dhe koordinimin e veprimeve për zbatimin e Urdhrit Nr. 226, datë 14.05.2021 të Ministrit të Brendshëm “*Për marrjen dhe zbatimin e masave për mbrojtjen, kontrollin dhe monitorimin e territorit, mjedisit dhe pyjeve nga ndërhyrjet/ndërtimet e kundërligjshme nga policia e shtetit dhe inspektoriat kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ngritjen e sekretariatit teknik të monitorimit*”; si dhe 1 takim me përfaqësues të AKB dhe përfaqësues të ISHTI për Rajonin Verior për bashkëpunim dhe marrje të masave për zbatimin e detyrimeve ligjore për menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit gjatë vitit 2021.
- Në kuadrin e ditës botërore të mjedisit (takim datë 04.06), takim në të cilin një grup të rinjsh hapen ekspozitën fotografike me temë: “*Stop krimet mjedisore*”)
- Takim në fshatin Vermosh, Nj.A Kelmend, me rastin e ditës Nderkombëtare të Danubit, me drejtues të bashkisë Malësi e Madhe, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, UNDP-Albania, Student të ekselencës së inxhinierisë mjedisit, ku në përfundim të takimit u vendosën shënja orientuese për promovimin e lumit të Vermoshit, si pjesë e basenit të Danubit (datë 29 Qershor)
- Takime me drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore dhe strukturat e KMCQ, lidhur me situatën e krijuar nga reshjet e shiut dhe përmbajtjet në zonën e Nën Shkodrës dhe përcaktimin e masave për përballimin e situatës (7 takime, datë 08.01, 09.01, 10.01, 12.01, 21.01, 02.02 dhe mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut); Me drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve

vendore, lidhur me masat për përbalimin e situatës së krijuar nga reshjet e dëborës në njësitë e zonave malore, si dhe breshërit në qytetin Shkodër (4 takime, datë 26.03, datë 12.05, pas të cilit u bë edhe verifikim i punës së kryer për hapjen e segmentit rrogor Qafë Thore-Theth, 14.05, 19.05); Takim lidhur me masat për parandalimin e rënies së zjarreve, menaxhimin dhe përbalimin e situatës së zjarreve gjatë periudhës së verës (takim datë 11.05)

- Takim trajnues, lidhur me planin e masave dhe organizimin e grupeve në terren, për reagimin ndaj ndotjes detare (shkalla I dhe II), vlerësimi i derdhjes, si dhe impakti i ndotjes në shëndetin publik (takim datë 30.06)

- Mbi shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të përdorimit të burimeve ujore dhe dhënie autorizimi nga Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë janë organizuar e zhvilluar 5 takime (datë 19 Mars; 23 Prill; 01 Korrik; 12 Tetor dhe 18 Nëntor)

- Mbi shërbimin shëndetësor, përfshirë edhe marrjen e masave për parandalimin e përhapjes, menaxhimin dhe përbalimin e situatës së krijuar nga Sarscov2

- Mbi marrjen e masave për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në sistemin e arsimit parauniversitar (takim datë 14.09)

- Mbi marrjen e masave për sigurimin e ngrohjes në shkolla dhe zëvendësimin e sistemit të ngrohjes me gaz me sistem kaldajë, ose me dru zjarri me qëllim shmangien e rrezikut që paraqet për shëndetin dhe jetën e nxënësve, përdorimi i gazit

- Takim me drejtues të AShK Shkodër, lidhur me problemet e regjistrimit të tiujve të pronësisë dhe legalizimin e ndërtimeve informale

- Takime, në kuadër të implementimit të projektit “*Katastrofat nuk njohin kufinj2*” (5 takime me partnerët e përfshirë në projekt)

- Takim me përfaqësues të Bashkive të Qarkut Shkodër dhe përgjegjesve të zyrave të gjëndjes civile në Qark me datë 30.12.2021 “Mbi rëndësinë e përfshirjes së tyre në procesin e regjistrimit dhe saktësimin të adresave të banimit”.

- Takim me drejtues të bashkive, të Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtorisë Rajonale të IKMT, Administratës Zonave të Mbrojtura etj, lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore dhe marrjen e masave për menaxhimin e mbetjeve dhe krijimin e një mjedisi të pastër pa ndotje (24 Nentor)

- Takime periodike të Prefektit me drejtues të Bashkive dhe të Institucioneve Vendore që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e bashkisë si dhe drejtues e përfaqësues të institucioneve rajonal lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore sipas fushave të përgjegjësisë e kryerjen e detyrave të përbashkëta për realizimin e programit dhe objektivave të qeverisë, ofrimin dhe rritjen e nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve dhe përmirsimin e vazhdueshëm të nivelit të jetesës së tyre

#### **VII.4. Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve**

Ushtrimi i përgjegjësisë së Prefektit, për shqyrtimin e ankesave dhe zgjidhjen e konflikteve, është kryer duke zbatuar kërkesat e kodit të procedurave administrative (Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015)

Gjatë viti në Institucionin e Prefektit janë shqyrtuar dhe vlerësuar, duke kthyer përgjigje 62 kërkesa dhe ankesa të qytetarëve, nga të cilat 55 kërkesa dhe ankesa të ardhura direkt, ose nepermjet institucioneve të tjera qendrore, si dhe 7 kërkesa dhe ankesa të ardhura nepermjet portalit të bashkëqeverisjes (online), të cilat sipas problematikës paraqiten:



- Për çështjet e pronësisë dhe zënien e hapësirave publike 14;
- Për mjedisin e menaxhimin e mbetjeve 4;
- Për çështjet e dëmshpërblimit nga përmbytjet dhe termeti 9;
- Për probleme social ekonomike 1;
- Të tjera 27;
- Nga portali i bashkëqeverisjes 7

#### **VII.5. Veprimtaria e N/Prefektit**

Në përbërje të administratës së prefektit, mbështetur në nenin 22 të Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e qarkut*”, kanë zhvilluar veprimtarinë nënprefektët Malësi e Madhe dhe Pukë.

Nënprefekti ka ushtruar detyrat funksionale, përcaktuar në detyrat e administratës së Prefektit (miratuar me Urdhrin Nr. 50, datë 12.04.2017, të Kryeministrit) dhe në Rregulloren Organizative të Brendshme të Institucionit, Kështu;

Ka bashkëpunuar me institucionet qendrore në nivel vendor, duke kërkuar prej tyre marrjen e masave për realizimin e detyrave, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre,;

Në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të ketyre institucioneve me bashkitë, janë organizuar takime gjatë vitit, sipas problemeve të dala; përballimin e situatave të emergjencave të krijuar nga reshjet gjatë periudhës dimrit dhe nga zjarret gjatë periudhës verore; mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, menaxhimin e mbetjeve, etj.

Nga ana e nënprefektit janë marrë masat për zbatimin e urdhrave të nxjerra nga prefekti.

Pranë nënprefektëve kanë funksionuar zyrat e ankesave të qytetarëve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre;

Janë konfirmuar çertifikatat e lëshuar nga ana e punjonjësve të gjëndjes civile të bashkive dhe Nj.A pjesë përbërëse e bashkive, si dhe brenda kompetencave ligjore janë lëshuar dokumente të tjerë, sipas kërkesave të qytetarëve;

Për problemet e dala në bashkitë që mbulojnë është raportuar vazhdimisht gjatë vitit tek Prefekti.

#### **VIII. VEPRIMTARI TË TJERA TË PREFEKTIT**

a. Shqyrtimi i masave administrative plotësuese, për kundravajtjet administrative, të leje të drejtimit të shtetasve të huaj

Mbështetur në Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, Nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për Kundravajtjet Administrative*”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë Punëve të Brendshme Nr.687, datë 5.12.2013 “*Për mënyrën e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor*”, i ndryshuar, neni 19, nga ana e Prefektit është shqyrtuar dokumentacioni i sjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë në 21 raste, duke marrë vendimet përkatëse

b. Legalizimi i dokumentëve për përdorim jashtë vendit

Mbështetur në aktet ligjore e nënligjore dhe në zbatim të Urdhrit të Prefektit gjatë vitit është bërë legalizimi (vërtetimi) i 25,724 dokumentëve (Nga Sektori i Shërbimeve mbështetëse 16,269, nga N/Prefekti Malësi e Madhe 5,595 dhe N/Prefekti Pukë 3,860), të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore (Çertifikatë, Vërtetim), për përdorim jashtë vendit

c. Zbatimi i projektit “*Katastrofat nuk njohin kufij2*”

Institucioni i Prefektit (grupi i punës i ngarkua me Urdhër të Prefektit, në përbërje të të cilit ka qenë Sekretari i Përgjithshëm-në cilësinë e Koordinatorit të Projektit; Specialisti i Sektorit të Zhvillimit Urban, i cili ka patur edhe punën më të madhe në zbatimin e projektit; 2 Specialistët e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara-në cilësinë e financierit dhe juristit të projektit), si institucion përfitues, në kuadrin e projekteve me fondet e BE, gjatë vitit është angazhuar në zbatimin e projektit “*Katastrofat nuk njohin kufij 2*”

d. Dorëzimi i dokumentacionit të ish KVTP

Nga ana e grupit të punë (të krijuar nga Prefekti) është bërë vlerësimi, inventarizimi dhe fotokopjimi i dokumentacionit, sipas dosjeve të ish KVTP, ku për vitin janë dorëzuar pranë Drejtorinë Vendore të ASHK Shkodër 450 dosje

## **IX. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2022**

Në kuadrin e reformës së qeverisë në administratën publike, ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të administratës, duke qenë faktor i rëndësishëm për të siguruar menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, do të jetë nga drejtimet kryesore të punës, për arritjen e objektivave:

1. Realizimi i programit qeverisës në nivel qarku (*Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së Degëve Territoriale dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së tyre, në realizimin e detyrave dhe objektivave, duke kërkuar transparencë; Përgjegjshmëri; Komunikim dhe informim; Llogaridhënie; Ashpërsim të luftës ndaj fenomenit të korrupsionit*)

2. Përballimi i situatave emergjente të krijuara gjatë gjithë vitit nga kushtet atmosferike, infeksioni SARS COV2, apo nga faktor të tjerë (*Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente; Përmirësimi i sistemeve të identifikimit të rrezikut dhe fuqizimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm; Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive në nivel qarku e më gjërë dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit mbi zvogëlimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe të mbrojtjes civile; Fuqizimi i aspekteve të gatishmërisë, shërbimeve emergjente dhe kapaciteteve të rikuperimit; Nxitja e krijimit të mbrojtjes financiare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të mjaftueshme për përballimin e situatave emergjente*)

3. Parandalimi dhe goditja e individëve dhe grupeve kriminale, i fenomeneve që paraqesin rrezik për jetën dhe pronën, si dhe sigurimi i rendit publik (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë me strukturat e policisë së shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera ligjzbatuese*)

4. Përmirësimi i nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve, nepermjet ushtrimit të funksioneve brenda kompetencave dhe veprimtarisë (*Bashkëpunimin dhe koordinimin i punës me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ushtrimin e funksioneve të transferuara, si dhe*



*monitorimi i kryerjes së ketyre funksioneve dhe përdorimi i fondeve të dhëna nga qeveria për këtë qëllim)*

5. Pastrimi i territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, nga mbetjet dhe krijimi i një mjedisi të pastër (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile, shoqata mjedisore, etj.*)

6. Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve vendore e qendrore, organizatave e shoqatave të ndryshme, komunitetit, në marrjen e masave, për mbarëvajtjen e procesit, për zgjedhjet pjesore, për kryetar bashkie (bashkia Shkodër), 6 Mars 2022

**P R E F E K T I**

Majlinda ANGONI

## BAZA LIGJORE

Veprimtaria e Institucionit të Prefektit mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Ligjin Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”
- Ligjin Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 9367, date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 119/2014, date 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”
- Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligjin Nr. 9131, date 08.09.2003 “Per rregullat e etikes se administrates publike”
- Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligjin Nr.9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
- Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003 “Per arkivat”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshime
- Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në RSh”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, me ndryshime
- Ligjin Nr 162/2020 datë 23.12.2020 ”Për Prokurimin Publik”
- Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshime
- Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 112/2015, datë 15.10.2015 “Për inspektimin financiar publik”
- Ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, me ndryshime
- Ligjin Nr.9482, datë 06.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", me ndryshime

- Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”
- Ligjin Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 57/2020 “Për Pyjet”;
- Ligjin Nr.10 120, datë 23.4.2009, “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”;
- Ligjin nr. 5/2016 “Për shpalljen e Moratoriumit në pyje”;
- Ligjin Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”;
- Ligjin Nr. 10129 date 11.05.2009 “Per gjendjen civile”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 8951 datë 10.10.2002 “Për numrin personal të shtetasve”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 8952 datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqipëtar”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, me ndryshime;
- Ligjin nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”;
- Ligjin Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- Ligjin nr. ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”;
- Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në R. Sh”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, me ndryshime;
- Aktet nënligjore të dala, në dhe për zbatimin e ligjeve;
- Rregulloren organizative të brendshme të administratës së Institucionit